



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE**

Nr. 05/33 prot.

Tiranë më, 07.06.2024

V E N D I M

PËR SUBJEKTIN E VLERËSIMIT Z. ALTIN RAMAZAN CURRI

Nr. 31, datë 07.06.2024

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

**Erjana Pjetri
Ersa Karaj
Klevis Dhigoi**

**Kryesuese
Relatore
Anëtar**

Asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga anëtarja e Sekretariatit Teknik, znj. Lediana Azemaj, më datë 07.06.2024, ora 10:30, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

SUBJEKTIT TË VLËRËSIMIT: **Altin Ramazan Curri**, me funksion Drejtor i Drejtorisë së Hetimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

OBJEKTI: Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Ligji nr. 12/2018**, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

Rregullore Nr. 197, datë 28.02.2023 “Për hapat proceduralë të unifikuar”.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes Ersja Karaj, vlerësoi shpjegimet e subjektit të vlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit; pasi dëgjoi subjektin e vlerësimit z. Altin Curri, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e tij në detyrë; pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në të tre kriteret e vlerësimit, të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të Ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.
2. Sipas përcaktimeve të nenit 6, të Ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, shtetasi Altin Ramazan Curri është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit 05.04.2023, si Drejtor i Drejtorisë së Hetimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
3. Subjekti i vlerësimit, z. Altin Ramazan Curri, iu nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar më datë 05.04.2023, nga Trupat e Vlerësimit në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm Nr. 07, datë 17.01.2023, “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të Ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, i ndryshuar”.
4. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin Nr. ** datë 18.04.2023 u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit e përbërë nga: znj. Erjana Pjetri (Kryesuese), znj. Ersja Karaj (Relatore) dhe z. Klevis Dhigoi (Anëtar).
5. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar, si edhe në bazë të Rregullores nr.197, datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar”, me Vendimin Nr. ** prot., datë 18.04.2023, vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Altin Ramazan Curri.

6. Relatori i çështjes, znj. Ersja Karaj, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar datë 18.04.2023, ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, dhe i është bërë e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e Trupës së Vlerësimit.
7. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar nëpërmjet postës elektronike deklaratën për konfliktin e interesit në datën 19.04.2023, duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit.
8. Relatori i çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 25, të Ligjit Nr. 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
9. Në vijim të procesit për subjektin e vlerësimit z. Altin Curri, mbështetur në nenin 33/1, nenin 42 dhe nenin 46, të Ligjit Nr.12/2018 i ndryshuar, relatori i çështjes ka dërguar pranë institucioneve ndihmëse, si më poshtë vijon:
 - Formularin e deklaramit të pasurisë dhe dokumentacioni shoqërues, me shkresën Nr. ** Prot., datë 19.04.2023, pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI).
 - Formularin e Vlerësimit të Aftësive Profesionale me shkresë përcjellëse Nr. ** Prot., datë 19.04.2023, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
 - Formularin e Kontrollit të Figurës me shkresë përcjellëse Nr. ** Prot., datë 19.04.2023, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
10. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, Trupa e Vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
11. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve, bazuar në nenin 4 të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, ka për objekt:
 - Vlerësimin e pasurisë
 - Kontrollin e figurës
 - Vlerësimin e aftësive profesionale.
12. Trupa e Vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:
 - a. Ligjin nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar;
 - b. Ligjin nr. 128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”;
 - c. Ligjin nr. 40/2015, “Kodi i Procedurës Administrative”;

- d. Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”;
- e. Udhëzim i Ministrit të Brendshëm Nr. 07, datë 17.01.2023 “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të Ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, i ndryshuar”;
- f. Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe ILDKPKI Nr. 15, datë 27.01.2023, “Për miratimin e formularëve të deklarimit të pasurisë për vlerësimin kalimtar dhe periodik, si edhe mënyrën e plotësimit të tyre nga subjektet e vlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarimin e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar;
- g. Rregulloren nr. 197, datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar”.

13. Gjithashtu, Trupa e Vlerësimit ka verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet e rrethanat e nevojshme dhe konkretisht:

- ❖ *Deklaratën e Pasurisë;*
- ❖ *Deklaratën për Kontrollin e Figurës;*
- ❖ *Formularin e Vlerësimit Profesional;*
- ❖ *Dokumentacionin bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaratimet;*
- ❖ *Aktin e përfundimit të vlerësimit të pasurisë, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave;*
- ❖ *Raportin mbi vlerësimin e aftësive profesionale, nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore;*
- ❖ *Raportin mbi Kontrollin e Figurës, nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore;*
- ❖ *Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar;*
- ❖ *Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit;*
- ❖ *Bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.*

14. Trupa e Vlerësimit, më datë 22.05.2024, pasi dëgjoi relatorin dhe pasi krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Altin Curri me Vendimin Nr. **, datë 22.05.2024, vendosi:

- a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Altin Ramazan Curri;
- b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
 - *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;*
 - *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët; vlerësimin pasuror, kontrollin e figurës dhe atë profesional.*

- c. Të ftojë subjektin për t'u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Trupa e Vlerësimit, në përputhje me nenin 50, të Ligjit nr.12/2018, nenet 35-40 dhe 45-47, të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.

15. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pikat 12 dhe 14, të Ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, si dhe nenit 3, pika 11 dhe nenit 5, të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”.

II. SEANCA DËGJIMORE

16. Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit Altin Curri, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si dhe Kodin e Procedurave Administrative, në datë 31.05.2024 në ambientet e Ministrisë së Brendshme, salla e mbledhjeve, Tiranë.

17. Në këtë seancë subjekti i vlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, si dhe shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e vlerësimit të kryer duke kërkuar konfirmimin në detyrë.

18. Trupa e Vlerësimit zhvilloi seancën e dhënies së vendimit më datë 07.06.2024.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

19. Subjekti i vlerësimit z. Altin Ramazan Curri, ka qenë bashkëpunues dhe korrekt gjatë gjithë procesit të vlerësimit në përputhje me pikën 2, të nenit 48, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

20. Subjekti ka paraqitur që në fazën e dorëzimit të deklaratave dokumentacion shoqërues të vlerësuar nga ana e tij, si dhe gjatë fazës së hetimit administrativ, gjatë komunikimit dhe pyetjeve të drejtuara nga relatorja, është përgjigjur dhe ka përcjellë dokumentacion shoqërues/justifikues shtesë, me qëllim vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, sipas rastit dhe rrethanave të tjera të çështjes për sqarim, i kërkuar nga ana e relatores.

IV. PROCESI I VLERËSIMIT NGA TRUPA E VLERËSIMIT

A. VLERËSIMI I PASURISË

21. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, e veçanërisht në nenin 31 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarinin dhe kontrollin e pasurive, ligjshmërinë e burimit

të krijimit të tyre dhe përmbushjen e detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.

22. Në zbatim të nenit 32, pika 2, e ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit z. Altin Curri ka dorëzuar deklaratën e pasurisë më datë 10.03.2023. Formulari i Pasurisë ka Nr. Indeksi 25, viti 2023.
23. Procedurat e deklarimit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe 33 ndërsa vlerësimi i pasurisë nga Trupa e Vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
24. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruar dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruar, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në institucionet apo personat juridikë, publikë apo privatë.
25. Trupa e Vlerësimit hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar.
26. Gjithashtu, ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, shlyerjen e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.

27. Trupa e Vlerësimit për realizimin e procesit të vlerësimit të pasurisë administroi:

- Deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur;
- Raportin e hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI në zbatim të neneve 33/1 dhe 34, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar;
- Provat shkresore/dokumente të vëna në dispozicion nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar;
- Shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare;
- Dokumentacionin e paraqitur në deklaratimet e subjektit, si përgjigje të pyetjeve të dërguara nëpërmjet postës elektronike.

28. Hetimi administrativ i kryer nga Trupa e Vlerësimit konsistoi në:

- Verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
- Verifikimin e burimit/eve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruar si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;

- Evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
- Evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.

29. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja:

29.1 Altin Curri nuk ka qenë dhe nuk është subjekt deklarues në ILDKPKI.

29.2 ILDKPKI-ja, në përputhje me Ligjin Nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënpunësve publik”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në Ligjin Nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave”, i ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, ka dërguar një raport të hollësishëm, Nr. *** prot., datë 27.10.2023, bazuar në dokumentacionin e administruar, për subjektin e vlerësimit z. Altin Curri, ku është konstatuar:

- a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, me burime të ligjshme financiare;
- b) nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- c) nuk është kryer fshehje e pasurisë;
- d) nuk është kryer deklarim i rremë;
- e) subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

DEKLARIM I PASURIVE NGA SUBJEKTI I VLERËSIMIT, ALTIN RAMAZAN CURRI

1. **Tokë vreshtë, me sipërfaqe 450 m²**, adresa fshati Domen Kavajë, zk. ****. Kontratë shitblerje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 03.06.2005.

Burimi i krijimit: nga të ardhurat familjare të pagës.

Vlera: 600.000 lekë

Pjesa takuese: 100 %

1.1 Subjekti ka bashkëlidhur deklaratës së pasurisë kontratë shitblerje, datë 03.06.2005 dhe certifikatë për vërtetim pronësie, datë 20.06.2005.

HETIMI ADMINISTRATIV

1.2 Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruar, mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruar, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, u është kërkuar informacion Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, si dhe u është drejtuar vetë subjektit. Nga përgjigjet e administruara dhe të analizuar, rezultoi se:

1.3 Referuar kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 03.06.2005, pala shitëse G. K. i ka shitur palës blerëse Altin Curri, pasurinë me nr. **/****, të llojit vreshtë, me sipërfaqe

450 m², e ndodhur në fshatin Domen, Kavajë, në vlerën 600.000 lekë. Shuma është shlyer jashtë zyrës noteriale.

1.4 Sipas certifikatës për vërtetim pronësie (dhe hartës treguese bashkëlidhur), datë 20.06.2005, pasuria e llojit vreshtë, e ndodhur në Domen, Kavajë, me sipërfaqe 450 m², është në pronësi të Altin Currit.

1.5 **ASHK**, Drejtoria Vendore Kavajë, me shkresën nr. *** prot., datë 11.07.2023, konfirmon pasuri të regjistruara apo të tjetërsuara në emër të subjektit apo personave të lidhur.

1.6 **ASHK**, Drejtoria Vendore Kavajë, me shkresën nr. **/*** prot., datë 27.09.2023, konfirmon pasurinë e regjistruar në emër të Altin Curri, sipas kartelës së pasurisë bashkëlidhur.

1.7 Gjithashtu, **ASHK Online**, konfirmon pasurinë me nr. **/***, në emër të Altin Curri.

1.8 I pyetur në lidhje me ndonjë investim në këtë pasuri, me e-mailin e datës 27.09.2023, subjekti ka dhënë sqarime me shkrim, ku sqaron se, që nga momenti që i disponon dhe deri aktualisht nuk ka bërë asnjë lloj investimi të asnjë lloj natyre. Ka bashkëlidhur dokumentacion justifikues, konkretisht foto të printuara nga Google Earth të gjendjes aktuale të pasurisë së sipërcituar.

1.9 Bazuar në deklarimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar, në mënyrë të përmbledhur rezulton se:

Toka vreshtë në zotërim 100% të subjektit deklarues është përfituar me kontratë blerje të vitit 2005, me burim nga të ardhurat familjare (trajtuar më poshtë tek të ardhurat).

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ASHK.**

2. **Tokë arë, me sipërfaqe 350 m²**, adresa Kavajë me nr. pasurie */***, zk. 8551, me kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.10.2010.

Burimi i krijimit: të ardhura nga kontrata e porosisë (shitje apartamenti) me nr. ** rep., nr. *** kol., ku janë përfituar 50 % të kështit të parë (5,000 euro*125).

Vlera: 620.000 lekë

Pjesa në %: 100 %

2.1 Subjekti ka bashkëlidhur deklaratës së pasurisë dokumentacion justifikues.

HETIMI ADMINISTRATIV

2.2 Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara, mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si

dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, u është kërkuar informacion Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, si dhe u është drejtuar vetë subjektit. Nga përgjigjet e administruara dhe të analizuara, rezultoi se:

2.3 Referuar kontratës së shitblerjes nr. *** rep. dhe nr. ** kol., datë 25.10.2010, Altin Curri i ka blerë palës shitëse me palë shitëse E. L., pasurinë me nr. */***, të llojit arë, me sipërfaqe 350 m², e ndodhur në Kavajë, në vlerën 620.000 lekë. Shuma është shlyer jashtë zyrës noteriale.

2.4 Sipas certifikatës për vërtetim pronësie, datë 05.11.2010, konfirmohet pasuria e mësipërme. *Bashkëlidhur harta treguese.*

2.5 **ASHK, Drejtoria Vendore Kavajë**, me shkresën nr. *** prot., datë 11.07.2023, konfirmon pasuri të regjistruara apo të tjetërsuara në emër të subjektit apo personave të lidhur.

2.6 **ASHK, Drejtoria Vendore Kavajë**, me shkresën nr. *** prot., datë 27.09.2023, konfirmon këtë pasuri të regjistruar në emër të Altin Curri. *Bashkëlidhur kartela e pasurisë.*

2.7 **ASHK Online**, konfirmon pasurinë në emër të Altin Curri.

2.8 Me e-mailin e datës 27.09.2023, subjekti ka bashkëlidhur dokumentacion justifikues, si dhe sqarime me shkrim, në lidhje me token arë, me sipërfaqe 350 m², e ndodhur në Kavajë, ku sqaron se që nga momenti që i disponon dhe deri aktualisht, nuk ka bërë asnjë lloj investimi të asnjë lloj natyre. *Bashkëlidhur e-mailit: Foto të printuara nga Google Earth, të gjendjes aktuale të pasurisë së sipërcituar.*

2.9 Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar dhe ka bashkëlidhur dokumentacion ku konfirmohet se kanë shërbyer të ardhurat nga kësti i parë i shitjes së pasurisë së paluajtshme, sipas kontratës së porosisë nr. ** rep., nr. *** kol., datë 02.03.2009, në vitin 2009. *(trajtuar më poshtë)* Konkretisht, kësti i parë është përfituar nga subjekti në vitin 2008 dhe është në vlerën 5.000 euro.

2.10 Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar, rezulton se:

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ASHK.**

3. (a) **Truall me sipërfaqe 300 m²**, adresa fshati Okshtun Kavajë, zk. ****, **nr. pasurie 70/33**, me kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.10.2012. Mbi këtë truall ka qenë e hipotekuar një ndërtesë e vjetër me sipërfaqe 100 m² dhe në Kontratën e shitjes noteri ka shënuar vlerën referenciale prej 4.356.200 lekë, ku përfshihet ndërtesa dhe trualli prej 300 m². Kjo ndërtesë në fakt ishte vetëm një grumbuj rrënojash prej gurësh e balte të cilën e kam çregjistruar konform të gjitha rregullave ligjore në fuqi dhe aktualisht kam në pronësi vetëm truallin. Edhe pse është shënuar gabimisht vlera referenciale e truallit dhe ndërtesës, kjo pronë,

bashkë me sipërfaqen tokë arë prej 1.250 m², e poshtëshënuar, ka kushtuar 550.000 lekë, vërtetuar kjo dhe nga akt marrëveshja e datës 27.08.2012, në zyrën e avokatisë në prani të avokatit A. S., ku deklarohet çmimi faktik i paguar për këto prona. Kjo marrëveshje u lidh si nevojë e një pagese nga unë për pronarët e pronave në mënyrë që ata të kryenin veprimet përkatëse për nxjerrjen e certifikatës së pronësisë për këto prona që kishin shumë vite që i kishin braktisur dhe ti rivlerësonin me çmimet e larta të referencës sipas ligjit.

(b) Tokë arë me sipërfaqe 1250 m², adresa fshati Okshtun Kavajë zk. ****, **nr. pasurie 62/7**, me kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.10.2012, në të cilën është shënuar gabimisht vlera e referencës prej 291.250 lekë. Sqaroj se për sa më sipër se kjo tokë bashkë me truallin dhe ndërtesën është blerë në vlerën 550.000 lekë.

Burimi i krijimit: të ardhura nga kontrata e porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., ku janë përfituar 50 % të kështit të dytë (5.000 euro*125=625.000) prill 2009.

Vlera: 550.000 lekë.

Pjesa takuese: 100 %.

4. **(a) Truall me sipërfaqe 300 m²**, adresa fshati Okshtun Kavajë, zk. ****, **nr. pasurie 70/34**, në të cilën figuron ndërtesa 100 m². Mbi këtë truall ka qenë e hipotekuar një ndërtesë e vjetër me sipërfaqe 100 m² dhe në kontratën e shitjes noteri ka shënuar vlerën referenciale prej 4.356.200 lekë ku përfshihet ndërtesa dhe trualli prej 300 m². Kjo ndërtesë në fakt ishte vetëm një grumbuj rrënojash prej gurësh e balte, të cilën e kam çregjistruar konform të gjitha rregullave ligjore në fuqi dhe aktualisht kam në pronësi vetëm truallin. Edhe pse është shënuar gabimisht vlera referenciale e truallit dhe ndërtesës, kjo pronë bashkë me sipërfaqen tokë arë prej 1250 m² e poshtëshënuar, ka kushtuar 550.000 lekë, vërtetuar kjo dhe nga akt marrëveshja e datës 27.08.2012, në zyrën e avokatisë në prani të avokatit A. S., ku deklarohet çmimi faktik i paguar për këto prona. Kjo marrëveshje u lidh si nevojë e një pagese nga unë për pronarët e pronave, në mënyrë që ata të kryenin veprimet përkatëse për nxjerrjen e certifikatës së pronësisë për këto prona që kishin shumë vite që i kishin braktisur dhe ti rivlerësonin me çmimet e larta të referencës sipas ligjit.

(b) Tokë arë me sipërfaqe 1250 m², adresa fshati Okshtun, Kavajë, zk. ****, **nr. pasurie 62/8**, me kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.10.2012, në të cilën është shënuar gabimisht vlera e referencës prej 291.250 lekë. Sqaroj se për sa më sipër, kjo tokë bashkë me truallin dhe ndërtesën është blerë në vlerën 550.000 lekë.

Burimi i krijimit: të ardhura nga kontrata e porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., ku janë përfituar 50 % të kështit të dytë (5.000 euro *125 = 625.000 lekë) Prill 2009.

Vlera: 550.000 lekë.

Pjesa takuese: 100 %.

4.1 Subjekti ka bashkëlidhur deklaratën dokumentacion justifikues për pasuritë e deklaruar.

HETIMI ADMINISTRATIV

4.2 Trupa e Vlerësimit mori në shqyrtim deklarin e subjektit, dokumentacionin e përcjellë prej tij dhe institucioneve ligjzbatuese, si dhe korrespondencën e mbajtur me ILDKPKI-në dhe relatoren e çështjes, nga ku rezultoi se:

4.3 **ASHK, Drejtoria Vendore Kavajë**, me shkresën nr. *** prot., datë 11.07.2023, konfirmon pasuri të regjistruara apo të tjetërsuara në emër të subjektit apo personave të lidhur.

4.4 **ASHK, Drejtoria Vendore Kavajë**, me shkresën nr. *** prot., datë 27.09.2023 konfirmon pasuritë me nr. 70/33 dhe 70/34, të regjistruara në emër të Altin Curri. Bashkëlidhur kartelat për secilën pasuri, të ndodhura në Okshtun, Kavajë, në emër të Altin Curri dhe Hatije Daiu.

4.5 **ASHK Online**, konfirmon pasurinë me nr. 70/33, zk. ****, në emër të Altin Curri dhe Hatije Daiu, si dhe pasurinë me nr. 70/34, zk. ****, në emër të Altin Curri dhe Hatije Daiu, përshkrimi “Fshirë ndërtesa me Urdhrin 831, datë 15.10.2020”.

4.6 Referuar kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.10.2012, rezulton se Altin Curri i ka blerë palës shitëse Z. H., F. D., M. H., V. S., Z. S., A. H., I. M-H. dhe M. T., pasurinë me nr. 70/33, me adresë në Okshtun, Kavajë, e llojit truall, me sipërfaqe 300 m², në të cilën ndërtesa zë 100 m², në zk. ***, vol. **, faqe **, në vlerën 4.356.200 lekë, shumë e cila është paguar jashtë zyrës noteriale. Gjithashtu shitësit i shesin edhe pasurinë me nr. 62/7, me adresë në Okshtun, Kavajë, e llojit arë, me sipërfaqe 1250 m², në zk. ****, vol. **, fq. ***, në vlerën 291.250 lekë, shumë e cila është paguar jashtë zyrës noteriale.

4.7 Sipas certifikatave përkatëse për vërtetim pronësie datë 08.06.2012, pasuria me nr. 70/33, truall me sipërfaqe 300 m² dhe pasuria me nr. 62/7, vol. **, fq. ***, e llojit arë, me sipërfaqe 1.250 m², të ndodhura në Okshtun, Kavajë rezultojnë në emër të bashkëpronarëve sipas listës. (8 bashkëpronarë).

4.8 Referuar listës së bashkëpronarëve datë 08.06.2012, pasuria nr. 62/7, vol. **, fq. ***, ka rezultuar në emër të 8 (tetë) bashkëpronarëve dhe konkretisht: shtetasit Z. H., F. D., M. H., V. S., Z. S., A. H., I. M-H., M. T. Kjo listë është rrjedhojë e dëshmisë së trashëgimisë të së ndjerës F. H., vendim nr. ****, datë 14.05.2012.

4.9 Pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së pronës, datë 16.10.2012, certifikata për vërtetim pronësie, datë 07.11.2012, konfirmon pasurinë nr. 70/33, vol. **, faqe **, në emër të Altin Curri dhe Hatije Daiu.

4.10 Gjithashtu, certifikata për vërtetim pronësie, datë 07.11.2012, konfirmon se pasuria nr. 62/7, vol. **, fq. ***, e llojit arë, me sipërfaqe 1250 m², ndodhur në Okshtun, Kavajë, rezulton në emër të Altin Curri dhe Hatije Daiu.

4.11 Në kartelën e pasurisë bashkëlidhur certifikatës për vërtetim pronësie, datë 02.03.2020, rezulton se pasuria nr. 70/33, në emër të Altin Curri dhe Hatije Daiu, ka të përcaktuar edhe

ndërtesën 100 m², si dhe një shënim “Urdhër prishje ndërtese”. (Bashkëlidhur dhe harta trequese).

4.12 Referuar kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.10.2012, Altin Curri i ka blerë palës shitëse A.H, D.H dhe A. H., pasurinë me nr. 70/34, e llojit truall, me sipërfaqe 300 m², në të cilën ndërtesa zë 100 m², në zk. ****, vol. **, fq. **, në shumën 4.356.200 lekë, shumë e cila është paguar jashtë zyrës noteriale. Gjithashtu shitësit i shesin edhe pasurinë me nr. 62/8, e llojit arë, me sipërfaqe 1.250 m², në zk. ****, vol. **, fq. **, në shumën 291.250 lekë, shumë e cila është paguar jashtë zyrës noteriale.

4.13 Sipas certifikatave për vërtetim pronësie, datë 21.03.2012, A.H. është përfaqësues i familjes e cila ka pasur në pronësi pasurinë numër 70/34, dhe pasurinë nr. 62/8, ndodhur në Okshtun, Kavajë.

4.14 Pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së pasurisë, datë 17.10.2012, certifikata për vërtetim pronësie, datë 19.11.2012, konfirmon pasurinë nr. 70/34, në emër të Altin Curri dhe Hatije Daiu.

4.15 Gjithashtu, sipas certifikatës për vërtetim pronësie datë 19.11.2012, konfirmohet pasuria nr. 62/8, vol. **, fq. ***, në emër të Altin Curri dhe Hatije Daiu.

4.16 Përpara nënshkrimit të kontratave të shit-blerjeve datë 16 dhe 17 Tetor 2012, për të katërta këto pasuri, subjekti i vlerësimit z. Altin Curri ka nënshkruar si më poshtë vijon:

a. Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. ** kol., datë 27.03.2012, me palë deklaruese A.H. dhe Altin Curri. *Shtetasi A.H., si kryetar i familjes bujqësore, ka në pronësi pasuritë si vijon; Pasurinë me nr. 70/34, me adresë në Okshtun, e llojit truall, me sipërfaqe 300 m², në të cilin ndërtesa 100 m², dhe pasurinë nr. 62/8, me adresë në Okshtun, e llojit arë, me sipërfaqe 1.250 m². Shtetasi A.H. deklaron se ja ka shitur këto dy pasuri shtetasit Altin Curri, nga i cili ka marrë ditën e sotme 650.000 lekë, duke marrë përsipër bashkë me pjesëtarët e tjerë të familjes të nënshkruajë kontratën e shitblerjes. Bashkëlidhur certifikatat e pronësisë së pasurive të sipërcituara në emër të A.H.*

b. Akt-marrëveshje më datë 27.08.2012, me palën shitëse Z. H., F. D., M. H., V. S., Z. S., A. H., I. M-H. , M. T. Shitësit janë bashkëpronarë mbi një pasuri me nr. 70/33, vol. *, fq. **, e llojit truall me sipërfaqe 300 m², në Okshtun dhe një pasuri në të njëjtën adresë me sipërfaqe 62/8, me sipërfaqe 1.250 m², e llojit arë, të cilat kanë ndërmjet një sipërfaqe prej 150 m². Gjithashtu janë bashkëpronarë dhe në pasuritë me nr. 62/7, e llojit arë me sipërfaqe 1.250 m² dhe për pasurinë me nr. 70/33, e llojit truall me sipërfaqe 300 m², të cilat gjithashtu kanë një rrip në mes me gjatësi 20 m. Dhe se këtë sipërfaqe përveç sa kanë përfituar me ligjin 7501, e kanë dhe trashëgim nga babai i tyre S. H.. Për këto pasuri ata deklarojnë se ia kanë shitur Altin Currit, kundrejt çmimit 1.100.000 lekë, çmim ky i cili përfshin edhe vlerën e sipërfaqeve të sipërcituara, të cilat janë realizuar me kontratën e rregullt të shitjes, pasi janë të pajisur me certifikatë pronësie. Këto sipërfaqe, për shkak të procedurave të regjistrimit nuk janë pajisur

me certifikatë pronësie dhe për këtë arsye lidhet kjo akt marrëveshje. Pala blerëse i ka dorëzuar këtë shumë shitësve brenda çmimit të blerjes së ngastrave të sipërcituara.

4.17 Trupa e Vlerësimit, pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e përcjellë nga subjekti i vlerësimit pranë ILDKPKI-së dhe AMP-së, shpjegimet/sqarimet me shkrim të subjektit sipas proces-verbaleve datë 12.07.2023 dhe 20.10.2023 me ILDKPKI-në, si dhe korrespondencën e mbajtur me relatorin e çështjes nëpërmjet postës elektronike, vëren se:

4.18 Deklarata noteriale është e nënshkruar vetëm nga një pjesëtar (nga 8 tetë total) si palë shitëse, ku cilësohet se ka marrë 650.000 lekë më datë 27.03.2012 dhe nuk është siguruar pjesëmarrja e anëtarëve apo prokurat e përfaqësimit të pjesëtarëve të tjerë, si dhe nuk shprehet sesa është çmimi total i pasurive.

4.19 Akt-marrëveshja e datës 27.08.2012, ndërmjet 8 anëtarëve (shitësi) dhe palës blerëse është lidhur përpara avokatit dhe jo përpara një noteri.

4.20 Gjithashtu, kjo akt-marrëveshje është nënshkruar për të gjitha pasuritë së bashku (nr. 70/33 me sipërfaqe 300 m², nr. 62/7 me sipërfaqe 1250 m², nr. 70/34 me sipërfaqe 300 m², nr. 62/8, me sip.1250 m²), si pasuri në bllok, vetëm nga 8 pjesëtarë ku pranojnë shitjen kundrejt shumës 1.100.000 lekë.

4.21 Sipas certifikatave për vërtetim pronësie nr. ***** dhe nr. *****, këta 8 (tetë) pjesëtarët që kanë firmosur akt-marrëveshjen e datës 27.08.2012 janë bashkëpronarë vetëm të pasurive nr. 70/33 dhe nr.62/7.

4.22 Në të njëjtën kohë, pasuritë nr. 70/34 dhe nr. 62/8 janë në pronësi të 3 (tre) anëtarëve: A.H., D. H., A. H.. Edhe në certifikatat për vërtetim pronësie nr. 290106 dhe nr. 290108 mbi këto dy pasuri, cilësohet se z. A.H. është *përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi pasuritë*.

4.23 Në akt-marrëveshjen e datës 27.08.2012, duhej të ishin 8 (tetë) pjesëtarë që bien dakord për pasuritë nr. 70/33 dhe nr. 62/7 duke specifikuar shumën e marrë nga pala blerëse, sikurse dhe 3 (tre) anëtarë, të cilët bien dakord për pasuritë nr. 70/34 dhe nr. 62/8, duke specifikuar shumën e marrë nga z. Altin Curri.

4.24 Në përfundim të këtyre procedurave janë nënshkruar dy kontrata shitblerje, përkatësisht kontrata Nr. *** rep., datë 16.10.2012 dhe kontrata Nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.10.2012, me anë të së cilave të dy palët kanë krijuar marrëdhënie juridike përfundimtare mbi shitblerjen e këtyre pasurive. Të gjitha palët me vullnetin e tyre kanë deklaruar dhe nënshkruar në këto dy kontrata se:

- Për pasurinë nr. 70/33: “...ja shesin blerësit që e ka pranuar Altin Curri, kundrejt çmimit 4.356.200 lekë, shumë të cilën e ka marrë plotësisht nga blerësi jashtë kësaj zyre noterie”.
- Për pasurinë nr. 62/7: “...ja shesin blerësit që e ka pranuar Altin Curri, kundrejt çmimit 291.250 lekë, shumë të cilën e ka marrë plotësisht nga blerësi jashtë kësaj zyre noterie”.

- Për pasurinë nr. 70/34: “...ja shesin blerësit që e ka pranuar Altin Curri, kundrejt çmimit 4.356.200 lekë, shumë të cilën e ka marrë plotësisht nga blerësi jashtë kësaj zyre noterie”.
- Për pasurinë nr. 62/8: “...ja shesin blerësit që e ka pranuar Altin Curri, kundrejt çmimit 291.250 lekë, shumë të cilën e ka marrë plotësisht nga blerësi jashtë kësaj zyre noterie”.

4.25 Për sa më sipër, çmimi i blerjes, sipas kontratave të shitjes të nënshkruar nga palët më datë 16 dhe 17 Tetor 2012, për pasuritë në fjalë, është: 9.294.900 lekë dhe jo 1.100.000 lekë të deklaruar.

4.26 Ndërkohë, në deklaratën e pasurisë për vlerësimin kalimtar, dorëzuar më datë 10.03.2023, subjekti ka deklaruar se “..... sqaroj për sa më sipër se kjo tokë bashkë me truallin dhe ndërtesën (pra pasuritë nr. 70/34 dhe nr.62/8) është blerë në vlerën 550.000 lekë.”

4.27 Deklarim i njëjtë është bërë edhe për pasuritë nr. 70/33 dhe nr. 62/7, ku subjekti ka deklaruar se janë blerë në vlerën 550.000 lekë.

4.28 Në lidhje me këto gjetje dhe mospërputhje në vlerë monetare të çmimit të blerjes të këtyre pasurive, të evidentuara nga ana e Trupës së Vlerësimit, ashtu edhe nga ILDKPKI, subjekti ka dhënë shpjegime/sqarime me shkrim duke bashkëlidhur dokumentacion justifikues, si më poshtë vijon:

4.29 Me inventarin e datës 12.07.2023 subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues, si dhe sqarime me shkrim, në lidhje me pasuritë në fshatin Okshtun Kavajë, pra dy troje përkatësisht me nga 300 m² dhe dy ara me përkatësisht 1.250 m², si më poshtë:

*“Blerjet e tokave, truallit dhe ndërtesave përbëjnë një bllok, tek i cili nuk banonte askush nga pronarët, pasi ishin shpërngulur prej gati 20 vitesh në Durrës. Aktualisht godinat nuk figurojnë më në certifikatat e pronësisë, pasi për shkak të amortizimit dhe vjetërsisë ishin jashtë funksioni dhe të pabanueshme, ndoqi procedurat e çregjistrimit. Pronarët ishin të një trungu, gjithsej 11 pjesëtarë dhe ky bllok prone, në kohën që ranë dakord për t'i blerë në shumën prej 1.100.000 lekë, ishte i pa hipotekuar. Me datën 27.03.2012 kanë përpiluar, me njërin prej pronarëve, deklaratën noteriale nr. *** rep. dhe *** kol., për të dokumentuar shumën prej 650.000, që i dha paradhënie. Po në këtë datë, pra më 27.03.2012, pronarët kanë kryer rivlerësimin e pronës. Në vazhdim, në muajin Maj të vitit 2012 i ka dhënë në kesh pjesën tjetër prej 450.000 lekë, data nuk i kujtohet, por nuk e dokumentuan këtë sasi që i dha. Për sa i përket dy kontratave të shitblerjes datë 16.10.2012 dhe 17.10.2012, ku është vendosur vlера e blerjes (2 x 4.356.200 lekë) sqaron se kjo është vlера e rivlerësimit, i cili u bë pas aplikimit dhe pagesës së taksës për këtë. Me sugjerim të noterit është vendosur si çmim blerje, vlера e rivlerësimit. Në akt-marrëveshjen e datës 27.08.2012, në zyrën e avokatit citohet se këta pronarë të të njëjtit trung familjar, përveç se kanë përfituar tokë sipas ligjit 7501, këtë tokë e kanë dhe tokë të babait të tyre, por që nuk i është kompensuar. Nga e gjithë sipërfaqja si bllok, mes dy shtëpive dhe pas shtëpive, ka nga një rrip toke, i cili nuk është i hipotekuar, por brenda rrethimit. Nga ana e tij, për të shmangur një pretendim të mëvonshëm për pjesën e pa hipotekuar, pra këtë rrip toke, si tokë babe, përpiloi këtë deklaratë, ku ata pohojnë se edhe kjo tokë është pjesë e asaj që është shitur. Ky veprim u bë tek avokati pasi nuk mund të bëhej tek noteri, i cili nuk mund të bënte*

shitje për një pronë që nuk kishte dokumente, pra për këtë rrip toke. Gjithashtu, një arsye tjetër e përpilimit të kësaj akt-marrëveshje, është dhe fakti se do që ta privatizojë këtë rrip toke. Për këtë, njëri nga kushtet e përcaktuar në ligj, është se toka që do privatizohet, nuk duhet të ketë pretendime pronësie të trashëguar. Këtë ja kanë sugjeruar persona që kishin njohuri dhe informacion mbi këtë procedurë.

Në lidhje me citimin “...janë realizuar me kontratën rregullt të shitjes”, që bën avokati në këtë akt, subjekti sqaroi se duhet të jetë një lapsus nga avokati, të cilit nuk i ka kushtuar rëndësi, sepse në thelb qëllimi i përpilimit të këtij akti ishte fakti që palët mos kishin me pretendim për rripin e tokës.

Pas 2 muajve, me datën 16 dhe 17 Tetor 2012, kanë realizuar shit-blerjen tek noteri. Kjo u bë pas dy muajsh, për shkak të numrit të madh të pjesëtarëve prej 11 personash, të cilët duhej koordinuar për t’i mbledhur në të njëjtën ditë.”

4.30 Më datë 19.04.2024, subjekti i vlerësimit ka dërguar përgjigjet e tij në postën elektronike të Relatores duke sqaruar ndër të tjera se: “Kjo pronë për të gjitha cilësitë që mbart, sidomos dhe periudhën që është blerë por dhe tani, nuk mundet kurrë të ketë një vlerë reale në treg prej 9.294.900 lekë, fakt ky lehtësisht i verifikueshëm në terren. Fakti që shuma e pasqyruar në aktin noterial është ajo e rivlerësimit deri në presje dhjetore, tregon që kjo është vendosur ashtu për të pasqyruar çmimin e referencës. Nëse ai do të deklaronte para trupës që këtë pronë e ka blerë 9.294.900 lekë, kjo do të përbënte një deklaram të rremë, për këtë arsye ai ka deklaruar realitetin të pasqyruar dhe dokumentuar në çdo detaj.

Pasaktësia vlerës reale të blerjes me atë të pasqyruar në akt noterial, është vetëm për shkak diferencës që përbën çmimi i rivlerësimit me atë realin, që të dyja lehtësisht të verifikueshme. Kjo nuk ka sjelle asnjë efekt mbi detyrimet tatimore sepse ato janë paguar nga pronarët me taksen e rivlerësimit, me sa mbaj mend ka qenë 1% ose 2% e shumës së rivlerësuar.”

4.31 Më datë 30.04.2024, në vijim të korrespondencës me relatoren e çështjes, z. Curri ka dhënë shpjegime se “A.H. është bashkëpronar në të gjitha pronat 70/33;70/34;62/8 dhe 62/7 si dhe vëllai i madh i cili mori përsipër të bënte dakordësinë për të gjithë bashkëpronarët e tjerë dhe e bëri. A.H., 650.000 lekë i ka marrë në emër të të gjithë pjesëtarëve për këto prona të cilët do të kryenin veprimet në hipotekë për të kryer rivlerësimin kundrejt pagesës së përcaktuar. Diferenca e ngelur për t’u paguar nga ana ime është 450.000 të cilën unë ia dhash sërish A. H. në prani të të gjithë pjesëtarëve dhe për këtë të gjithë kanë qenë dakord. Për ndarjen e shumës totale 1.100.000 mes tyre unë nuk e di si e kanë ndarë, por di që mes tyre nuk ka patur asnjë lloj pretendimi, kjo e faktuar me nënshkrimet që dakordësuan shitjen. Prona në fjalë ishte e braktisur prej tyre për rreth 20 vjet dhe dy objektet që atëherë figuronin në certifikatë, njëra ishte grumbull gurësh dhe tjetra tërësisht e papërdorshme. Pra ajo që mund të themi se kishte vlerë, ishte vetëm toka. Pra ajo që dua të shpjegoj është fakti se 450.000 lekë nuk është çmimi për pronën 70/33 dhe 62/7, por diferenca e çmimit total 1.100.000 nga i cili është zbritur paradhënia prej 650.000 lekë. Aktmarrëveshja e përpiluar tek avokati, ishte iniciativë/kërkesë e imja dhe kishte për qëllim pjesën e rripit të tokës që ishte i pa hipotekuar, por që në të vërtetë ishte tokë babe e trashëguar nga të gjithë pjesëtarët. Për të shmangur çdo pretendim të mundshëm, më vonë unë dokumentova në këtë formë faktin sepse me noter kjo nuk bëhej. Pra gabimi që avokati ka bërë në përpilim duke përsëritur dy herë numrin e pronës

70/33 nuk cenon qëllimin. Në kontekst kuptohet qartë që avokati ka dashur të përfshijë të gjitha pronat në fjalë.”

4.32 Gjithashtu, subjekti ka vënë në dispozicion kartelat përkatëse të rivlerësimit, duke u shprehur se *përkojnë me presje dhjetore më çmimin që palët vendosën tek noteri më sugjerimin e tij. Pagesat janë bërë nga pronarët sipas përlllogaritjes së zyrës së hipotekës.*

4.33 Në lidhje me **një ndërtesë të vjetër me sipërfaqe 100 m²** të hipotekuar në truallin me numër pasurie **70/33**, subjekti ka dhënë shpjegime në deklaratën e pasurisë se ishte në fakt vetëm një grumbuj rrënojash prej gurësh e balte të cilën e ka çregjistruar konform të gjitha rregullave ligjore në fuqi.

4.34 Në lidhje me **një ndërtesë të vjetër me sipërfaqe 100 m²** të hipotekuar në truallin me numër pasurie **70/34**, subjekti ka dhënë shpjegime në deklaratën e pasurisë se kjo ndërtesë ka qenë tejet e amortizuar duke qenë e braktisur prej shumë vitesh nga pronarët e saj dhe për këtë arsye e ka çregjistruar konform të gjitha rregullave ligjore në fuqi dhe aktualisht ka në pronësi vetëm truallin.

4.35 **ASHK, Drejtoria Vendore Kavajë**, me shkresën datë 05.03.2020, informon shtetasen Hatije Daiu, se nuk mund ta pajisin me shërbimin e kërkuar për pasurinë nr. 70/34, vol. **, fq. 47, pasi në aktin e ekspertimit nuk është përcaktuar si një ndërtesë që nuk ekziston, por pasqyron një ndërtesë jo të banuar. Në lidhje me këtë pronë duhet të paraqesin vendimin e prishjes së objektit nga Bashkia Rrogozhinë, për të bërë të mundur përfundimin e shërbimit. *Bashkëlidhur praktika.*

4.36 **ASHK, Drejtoria Vendore Kavajë**, konfirmon se ndërtesa është fshirë nga certifikata për vërtetim pronësie, për pasurinë nr. 70/33, vol. **, fq. ***, e llojit truall, me sipërfaqe 300 m², ndodhur në Okshtun, Kavajë, në emër të Altin Curri dhe Hatije Daiu. Konkretisht, në kartelën e pasurisë bashkëlidhur certifikatës së pronësisë datë 19.10.2020, tek përshkrimi i veçantë ka shënimin *“Fshirë ndërtesa me urdhrin 831, datë 15.10.2020”*.

4.37 Me inventarin e datës 12.07.2023, subjekti ka dorëzuar dokumentacionin:

- Dërgim informacioni nga Bashkia Rrogozhinë, nr. *** prot., datë 14.02.2020, drejtuar ASHK, Drejtoria Vendore Kavajë, ku sqaron se në fshatin Okshtun, numër pasurie 70/33 dhe 70/34, pasuri në emër të Altin Curri dhe Hatije Curri, ku pasuria nr. 70/33 e llojit truall nga kjo ndërtesë 100 m², ndërtesa në fjalë nuk ekziston, është rrënuar dhe nga kjo kanë mbetur vetëm inerte të saj; ndërsa pasuria nr. 70/34 e llojit truall 300 m², nga ndërtesë 100 m², ndërtesa në fjalë ekziston, *por është e pabanueshme sipas akt konstatimit të datës 14.02.2020, mbajtur nga grupi i inspektimit*. Bashkëlidhur praktika. Foto të pronave në Okshtun, Kavajë.

4.38 Në lidhje me vlerën e pasurive të mësipërme subjekti ka sqaruar se vlera e vendosur në kontratë me vlerën e paguar realisht nga ana e tij, prej 1.100.000 lekë, kanë diferencë për shkak

se këto pasuri ndodhen në një zonë tërësisht të pazhvilluar nga ana urbanistike, e braktisur pothuajse tërësisht nga banorët të cilët edhe tokat e veta arë i kanë lënë djerrë. Gjithashtu në këto pasuri kanë qenë shumë pronarë, të cilët edhe për shkak të mosmarrëveshjes mes tyre donin t'i shisnin këto prona. Aktualisht ajo zonë vazhdon të jetë e braktisur dhe e pazhvilluar. Vlera e paguar nga ana e tij ishte pikërisht vlera reale e asaj pasurie, pavarësisht çmimit referencial, i cili është vendosur formalisht në kontratat e shitblerjes.

4.39 Në mbështetje të deklarimeve dhe argumenteve të tij, si në formularin e deklaratës së pasurisë, ashtu edhe në korrespondencën e mbajtur me ILDKPKI-në dhe Relatoren e Trupës së Vlerësimit, subjekti A. Curri, më datë 10.05.2024, ka dorëzuar pranë AMP-së sqarime dhe dokumentacion shtesë si vijon: “...Vlera e përcaktuar në aktet noteriale të shitjes pasqyron çmimin e rivlerësimit dhe jo vlerën reale prej 1.100.000 lekë që ka paguar, (e cila është dhe vlera e tregut atëherë por edhe sot), subjekti ka parë të arsyeshme që këtë fakt ta dokumentonte edhe me vetë pohimin e shitësve të këtyre pronave më një deklaratë noteriale.

Për arsye objektive, njëra nga pjesëtarët, F.D. ndodhej me familjen në Itali dhe e kishte të pamundur të ishte prezent për nënshkrimin e deklaratës. Për këtë fakt, nga komunikimi me familjarët e vet asaj iu vu në dispozicion deklarata që përpiluan familjarët e tjerë dhe u dakordësua ta konfirmonte me një deklaratë dore”, dokument të cilin subjekti e vuri në dispozicion të Trupës së Vlerësimit me e-mailin e datës 13.05.2024 dhe rezulton se shtetasja F.D. ka deklaruar se nëse do të ishte në Shqipëri do të nënshkruante Deklaratën Noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 09.05.2024, pasi dhe vullneti i saj është i njëjtë me atë të 7 pjesëtarëve të tjerë.

4.40 Nëpërmjet Deklaratës Noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 09.05.2024, deklaruesit A. H., Z. H., V. S., Z. S., I. M-H. , M. T. dhe M. H., nën përgjegjësinë e tyre personale dhe me vullnet të lirë, kanë deklaruar me përgjegjësinë e tyre të plotë personale në dijeni të pasojave që sjell një deklaram i rremë dhe i pavërtetë, se më datë 16.10.2024 kanë nënshkruar Kontratë Shitblerje pasurie e paluajtshme – akt me numër *** rep., nr. **** kol., datë 16.10.2012, në të cilin çmimi i shitblerjes së pasurive është përcaktuar në total 4.647.450 lekë. Ata deklarojnë se kanë marrë nga shtetasi Altin Curri vlerën monetare 450.000 lekë dhe ky është çmimi real i shitjes së pasurive për të mos i zhvlerësuar ato.

4.41 Bazuar në deklarinimin e subjektit, sqarimet dhe dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar, në mënyrë të përmbledhur rezulton se:

Dy tokat arë me sipërfaqe 1.250 m² secila, me nr. pasurie 62/7 dhe 62/8, si dhe dy trojet me sipërfaqe 300 m² dhe 100 m² ndërtesë secili, me numra pasurie 70/33 dhe 70/34 në Oshtun, Kavajë, në zotërim të subjektit dhe bashkëshortes së tij, janë përfutuar me kontrata blerje të vitit 2012, me burim nga shitje pasuri e paluajtshme sipas kontratës së porosisë nr. **** kol., dhe **** kol., datë 02.03.2009, (trajtuar më poshtë). Kësti i dytë sipas këtyre kontratave në vlerën 5.000 euro për secilën kontratë, është përfutuar nga subjekti në vitin 2009. Çmimi i deklaruar nga subjekti, i paguar për pasuritë e sipërcituara referuar akt-marrëveshjes së datës 27.08.2012, është 1.100.000 lekë, 550.000 lekë për secilën kontratë, ndërsa referuar kontratave të shitblerjes, datë 16.10.2012 dhe datë 17.10.2012, çmimi i secilës kontratë është 4.647.450 lekë,

në total 9.294.900 lekë. Ndërkohë, sipas akt-marrëveshjes së datës 27.08.2012, shitësit e pasurive nr. 7/33, 62/7, 70/34 dhe 62/8, deklarojnë se këto pasuri i janë shitur subjektit Altin Curri në vlerën totale 1.100.000 lekë. Gjithashtu, edhe sipas deklaratës noteriale datë 09.05.2024, për pasuritë nr. 7/33 dhe 62/7, shitësit deklarojnë se pavarësisht çmimit të cituar në kontratën e shitjes, ata realisht kanë marrë nga subjekti vlerën prej 450.000 lekë dhe ky është çmimi real i shitjes për ato pasuri.

- ✓ Rezulton mospërputhje ndërmjet çmimit të deklaruar nga subjekti dhe çmimit referuar kontratave të paraqitura, për blerjen e pasurive në ZK **** Oshtun, Kavajë, konkretisht; dy troje me sipërfaqe 300 m²/secili, nga ku ndërtesa me sipërfaqe 100 m² dhe arë me sipërfaqe 1.250 m²/secila (me nr. pasurie 70/33, 62/7, 70/34, 62/8).
- ✓ Subjekti ka dhënë shpjegime të hollësishme dhe ka bashkëlidhur dokumentacion justifikues në lidhje me vlerën e paguar nga ana e tij për pasuritë e deklaruara si më sipër dhe çmimin e vendosur në kontratat e shitblerjes.
- ✓ Burimi i krijimit të pasurive të sipërcituara, deklaruar nga kontrata të cilat rrjedhin nga ekzekutimi i akt-marrëveshjeve nr. **** dhe nr. ****, të datës 19.12.2005 dhe kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 19.12.2005, trajtuar më poshtë.

5. **Truall me sipërfaqe 1.230 m²**, i përbërë nga godinë banimi një kat përdhe me sipërfaqe 148 m² dhe një kat bodrum me sipërfaqe 148 m². Adresa Kavajë, me nr. pasurie ***, zk. 8552. Burimi: Kontratë shitblerje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.07.2014. Leje zhvillimore ndërtimi me nr. *** prot., datë 25.05.2015.

Burimi i krijimit:

- Të ardhura datë 09.11.2011 referuar kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. ** kol., datë 20.02.2017 (bashkëlidhur mandati bankar datë 09.11.2011), (1/2 e vlerës = 22.500 euro*140 lekë/euro= 3.150.000 lekë).
- Shitje apartamenti 1+1, datë 14.11.2011 nr. **** rep. dhe **** kol., (apartamenti 1+1 i blerë sipas kontratës noteriale me nr. *** rep., nr. ** kol.) në vlerën 3.382.166 lekë. Të ardhura nga kontrata e porosisë me nr. *** rep., nr. *** kol., ku janë përfituar 50 % të kështit të tretë (1/2 e kështit = 11.350 euro * 140 lekë = 1.589.900 lekë) Janar 2012.
- Të ardhura nga kontrata e porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., ku janë përfituar 50 % të kështit të tretë (1/2 e kështit = 11.350 euro * 140 lekë = 1.589.900 lekë) Janar 2012.

Vlera: Trualli 2.800.000 lekë, Godina 5.397.485 lekë. Totali 8.197.485 lekë.

Pjesa Takuese: 100 %.

5.1 Subjekti i vlerësimit ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacion justifikues:

- a. Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.07.2014, me palë shitëse Sh. K., D. K., H. K., A. K. dhe Xh. K., dhe blerës Altin Curri, për pasurinë me nr. ***, e llojit truall me sipërfaqe 1.230 m², në vlerën 2.800.000 lekë, shumë e cila sipas deklarimit të palëve është derdhur në llogarinë e noterit në BKT.
- b. Vërtetim nga dokumenti hipotekor, datë 21.05.2015, për pasurinë me nr. ***, e llojit truall me sipërfaqe 1.230 m², e ndodhur në Kavajë, në emër të Altin Curri dhe Hatije Daiu. Bashkëlidhur harta treguese.

- c. Vërtetim nga dokumenti hipotekor, datë 21.03.2018, për pasurinë me nr. ***, e llojit truall me sipërfaqe 1.230 m², e përbërë nga godinë banimi 1 kat, kati përdhe me sipërfaqe 148 m² dhe bodrum 148 m², e ndodhur në Kavajë, në emër të Altin Curri dhe Hatije Daiu. Pasuria ka shënimin “Regjistrim leje zhvillimore ndërtimi”, datë 25.05.2015. Bashkëlidhur harta treguese.
- d. Situacion përfundimtar objekti shtëpi 1 kat me bodrum, nga firma ***** shpk, datë 31.01.2017, me investitor Altin Curri. Vlera totale e punimeve është 5.397.485 lekë.

HETIMI ADMINISTRATIV

5.2 **ASHK**, Drejtoria Vendore Kavajë, me shkresën nr. *** prot., datë 11.07.2023 konfirmon pasuri të regjistruara apo të tjetërsuara në emër të subjektit apo personave të lidhur.

5.3 **ASHK**, Drejtoria Vendore Kavajë, me shkresën nr. *** prot., datë 27.09.2023 konfirmon pasurinë me nr. ***, zk. 8552, e regjistruar në emër të Altin Curri. Bashkëlidhur kartela e pasurisë, në emër të Altin Curri dhe Hatije Daiu.

5.4 **ASHK Online**, konfirmon pasurinë nr. ***, zk. 8552, në emër të Altin Curri dhe Hatije Daiu. Përshkrimi “*Banesë 1 kt + 1 kt bodrum, kati përdhe 148 m² dhe bodrum 148 m²*”.

5.5 **Abi Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, konfirmon në emër të Altin Curri, llogari në euro. Në këtë llogari janë konstatuar transferimet, si më poshtë:

- Në datën 27.10.2015 transferon për shoqërinë ***** shpk, vlerën 7.200 euro, me përshkrimin “*Lik faturë nr. 112, datë 27.10.2015, paradhënie për punimet e ndërtimit, shtëpi 1 kt + bodrum, sipas lejes ndërtimit*”.
- Në datën 13.11.2015 transferon për shoqërinë ***** shpk, vlerën 4.475 euro, me përshkrimin “*Lik fat. nr. 113, datë 10.09.2015*”.
- Në datën 09.12.2015 transferon për shoqërinë ***** shpk, vlerën 8.716 euro, me përshkrimin “*Lik. fat, nr. 114, datë 30.11,2015, punime sipas situacionit nr. 2*”.
- Në datën 23.12.2015 transferon për shoqërinë ***** shpk, vlerën 3.600 euro, me përshkrimin “*Lik. pjesor fat. nr. 116, datë 21.12.2015*”.

5.6 **OTP Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 05.05.2023, konfirmon në emër të Altin Curri ose Hatije Daiu, llogari në euro, ku konstatohet se Hatije Daiu:

- Në datën 02.11.2022, tërheq vlerën 35.000 euro.
- Në datën 30.11.2022 tërheq vlerën 5.000 euro.
- Në datën 13.02.2023 tërheq vlerën 5.000 euro.
- Në datën 23.02.2023 tërheq vlerën 2.000 euro.

5.7 Shuma e tërhequr për periudhën Shkurt 2022 – Shkurt 2023 është në vlerën 47.000 euro.

5.8 Me inventarin e datës 12.07.2023, subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues, si dhe

sqarime me shkrim, në lidhje me banesën prej 148 m², ku banon aktualisht, ku sqaron se fillimisht ka blerë truallin me sipërfaqe prej 1.230 m², sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep. dhe *** kol. Më pas në këtë truall ka ndërtuar banesën një-katëshe me sipërfaqe 148 m² + bodrumin, kjo sipas lejes zhvillimore nr. *** datë 25.05.2015. Kjo banesë është ndërtuar me 4 situacione, nga të cilat:

- Likuidimi i 2 situacioneve të para dhe likuidimi pjesërisht i situacionit të 3, është bërë me transfertë bankare. Konkretisht është likuiduar fatura nr. 112, datë 27.10.2015, si parapagim pjesor i situacionit të I-rë, në vlerën 7.200 euro.
- Likuidimi përfundimtar i situacionit të I-rë është bërë në vlerën 4.475 euro sipas faturës nr. 113, datë 10.9.2015.
- Situacioni II është likuiduar me anë të faturës nr. 114, datë 30.11.2015, në vlerën 8.716 euro.
- Situacioni i III është likuiduar pjesërisht nëpërmjet bankës, në vlerën 3.600 euro, me nr. fature 116, datë 21.12.2015.

5.9 Më konkretisht: Situacioni i I-rë, vlera 1.619.436, faturë nr. 112, datë 27.10.2015 dhe faturë nr. 113, datë 10.09.2015, situacioni i II-të vlera 1200.228, faturë nr 114, situacioni III-të, vlerë 1.466.538, faturë nr. 116, situacioni IV, vlerë 1.111.200, faturë nr. 120. Situacioni përfundimtar (nga 1-4) në vlerë totale 5.397.485 lekë.

5.10 Ndërtimi i kësaj banese ka filluar në Tetor 2015 dhe ka përfunduar në Qershor të vitit 2017, sipas akt kontrollit përfundimtar të kryer nga zyra e urbanistikës Bashkia Kavajë. Pagesat e situacioneve kundrejt ***** sh.p.k. janë bërë me bankë në vlerën prej 3.312.144 lekë dhe pjesa tjetër që ngelet është bërë në cash me këste të ulëta, të cilat nuk i disponon me mandate arkëtimi. Ky fakt është dokumentuar me deklaratën e datës 10.09.2019, të Firmës ***** shpk, nëpërmjet përfaqësuesit të saj ligjor.

5.11 Me inventarin e datës 12.07.2023, subjekti ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Leje zhvillimore ndërtimi nr. ***, datë 25.05.2015, nga Bashkia Kavajë, për banesë 1 kat + 1 kat bodrum.
- Faturë tatimore shitje, nr. 112, datë 27.10.2015, në vlerën 7.200 euro ose 1.000.800 lekë.
- Faturë tatimore shitje, nr. 113, datë 10.09.2015, vlera 618.636 lekë.
- Faturë tatimore shitje, nr. 114, datë 30.11.2015, punime sipas situacionit nr. 2, vlera 1.210.228 lekë.
- Faturë tatimore shitje, nr. 116, datë 21.12.2015, punime sipas situacionit nr. 3, vlera 1.466.538 lekë.
- Faturë tatimore shitje, nr. 120, datë 31.01.2017, punime sipas situacionit nr. 4, vlera 1.111.200 lekë.
- Situacioni përfundimtar nga shoqëria ***** shpk, për objektin e mësipërm, datë 31.01.2017, në vlerën totale 5.397.485 lekë.
- Fatura arkëtimi nga Altin Curri, në favor të Bashkisë Kavajë, datë 28.04.2015, pagesa për leje zhvillimi, në vlerën totale 29.142 lekë.

- Deklaratë mbikëqyrje e punimeve, shtëpi banimi 1 kat, nga shoqëria ***** shpk, me investitor Altin Curri, në vlerën totale 5.397.485 lekë, të cilat janë shlyer nga investitori.
- Akt kontrolli përfundimtar nga Bashkia Kavajë, datë 27.06.2017, për objektin 1 kat + 1 kat bodrum, në prani të investitorit Altin Curri, me sipërfaqe shesh ndërtimi 1.230 m² dhe ndërtim 148 m².
- Bashkëlidhur tabelat e situacioneve të punimeve.
- Foto të banesës një-katëshe në Kavajë.

5.12 Nga verifikimet e kryera, Trupa e Vlerësimit vëren një mos-akordim (paqartësi) në datë dhe veprime; konkretisht nëse i referohemi faturave, rezulton se fatura nr. 113 (10 Shtator 2015) është prerë përpara faturës së paradhënies nr. 112 (27 Tetor 2015); pra paradhënia është likuiduar më vonë dhe ndërkohë është zbritur nga fatura e Shtatorit.

- Fatura tatimore Nr. 1122, me numër serie 1***5, në datë 27.10.2015: Paradhënie për punimet e ndërtimit...
- Fatura tatimore Nr. 113, me numër serie 1***6, datë 10.09.2015, ka shënim: *zbritet paradhënia fatura nr.112 dt.27.10.2015.*

5.13 Me e-mailin e datës 30.04.2024, subjekti i vlerësimit ka dhënë sqarime me shkrim se, përsa i përket faturimit të situacioneve të shoqërisë ***** shpk, *më 27 Tetor të 2015, nëpërmjet Abi-bank, ka kaluar në llogari të ***** shpk shumë paradhënie (për ndërtimin e banesës) në vlerën 7200 euro= 1.000.800 leke. Në bazë të ligjit për TVSH, çdo paradhënie duhet të faturohet, pra subjekti është i detyruar ta faturojë, përkatësisht fatura Nr. 112, dt 27.10.2015 me vlerën e paradhënies. Fatura që e pason me nr. 113 dhe nr. serial 1***6 është fatura e situacionit të parë të punimeve dhe nuk është faturë e Shtatorit, gjë e cila vërtetohet qartë nga Nr. serial i faturës, që është numër pasardhës i numrit të faturës së datës 27.10.2015, respektivisht 1*****5. Në këtë rast duket qartë që muaji është një lapsus i personit që ka plotësuar faturën pasi nuk ka si të jetë faturë e muajit Shtator. Punimet e firmës kanë filluar pas paradhënies së paguar. Në faturën me Nr. 113, vlerës së plotë të situacionit të parë të punimeve, ju zbrit vlera e faturës paradhënie me të drejtë, se përndryshe vlera e paradhënies publikohej fiktivisht në të njëjtën vlerë. Kështu që u faturua për diferencë.*

5.14 Kërkesës së Relatores për të bashkëlidhur librat e shitjes së shoqërisë “*****” shpk që tregojnë këto veprime të kryera për ndërtimin e godinës, subjekti në përgjigjen e datës 30.04.2024, është shprehur se, “***** shpk e ka mbyllur aktivitetin e saj disa vite më parë dhe nuk mund të aksesohen librat e saj të shitjes”.

5.15 Në lidhje me shpenzimet për mobilimin dhe meremetimet e brendshme dhe të jashtme për shtëpinë në Kavajë dhe apartamentin në Qerret, të cilat kapin shumë rreth 60.000 euro, subjekti ka dërguar dokumentacion justifikues dhe sqarime me shkrim, me e-mailin e datës 17.07.2023 dhe më datë 27.09.2023. Konkretisht për shtëpinë në Kavajë janë kryer punime të jashtme, të cilat përfshijnë një verandë druri, kangjella të verandës dhe të dritareve, lyerje e jashtme dhe dekorim me gurë dekorativ, në nivelin 1 metër përreth shtëpisë. Të gjitha këto punime janë kryer nga individë artizanalë, të cilët nuk disponojnë numër NIPT. Sqaron se ka

blerë herë pas here materialin që i kanë kërkuar punëtorët dhe ai ka kryer punimet. Për të provuar këtë ka depozituar foto të shtëpisë në Kavajë, para dhe pas këtyre punimeve. Gjithashtu në shtëpinë në Kavajë, ka mobilimin, si dhe vendosjen e një sobë\kaldajë e cila funksionon si sistem ngrohje në të gjithë ambientin e shtëpisë.

Pavarësisht se nuk mund të bëjë një ndarje të detajuar të shpenzimeve për secilën banesë, pasi nuk ka mbajtur një evidencë, sqaron se në shtëpinë në Kavajë mund të ketë shpenzuar rreth 35.000 euro ndërsa në apartamentin në Qerret rreth 25.000 euro.

5.16 Në proces verbalin e datës 20.10.2023, subjekti ka sqaruar se nga vlera totale 60.000 euro, të shpenzuara në apartamentin në Qerret dhe shtëpinë në Kavajë, 47.000 euro nga këto janë tërhequr në OTP Bank, për periudhën Nëntor 2022 - Shkurt 2023, ndërsa shuma prej 13.000 euro është tërhequr nga llogaria pas datës së dorëzimit të deklaratës së pasurisë, krahas tërheqjeve të tjera të kryera në këtë llogari për nevoja të ndryshme. Nga llogaria rezulton se për shtëpinë në Kavajë, nga shuma prej 47.000 euro e tërhequr, janë investuar deri datën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, 22.000 euro dhe pjesa tjetër prej 13.000 euro është tërhequr dhe investuar pas dorëzimit të deklaratës. Për sa i përket mobilimit dhe pajisjeve elektroshtëpiake për shtëpinë në Kavajë, për periudhën nga viti 2017, kur ka përfunduar ndërtimi, deri në vitin 2022, ato kanë qenë shumë modeste, kryesisht mobilje të përdorura, që mesa mban mend, mund të kenë kushtuar rreth 700.000 lekë, kjo për arsye se donin të bënin një investim cilësor, investim i cili është siç e ka shpjeguar më lart, nga fundi i vitit 2022 e në vazhdim. Nuk ka ruajtur fatura në lidhje me shpenzimet e kryera për këto dy pasuri.

5.17 Në lidhje me banimin e tij, për periudhën 2000 - 2004, subjekti ka sqaruar se ka banuar në shtëpinë e prindërve të tij, të cilët nuk kanë pranuar kontributin e tij financiar për shpenzimet e jetesës, pasi deri në vitin 2004 ka pasur si objektiv kursimin e të ardhurave të tij nga paga për blerjen e një apartamenti, për të jetuar më vete. Gjithashtu e njëjta situatë ka qenë edhe me bashkëshorten e tij, në familjen e saj. Për periudhën nga viti 2004 deri në fund të vitit 2011 ka banuar tek apartamenti i blerë në vitin 2004. Sqaron se ky apartament është blerë i mobiluar, me orendi të përdorura nga pronari i mëparshëm dhe nuk ka qenë nevoja që të kryente investime të tjera në këtë apartament. Burimi i këtij apartamenti ka qenë nga të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes nga paga, si dhe nga paga martesore. Pasi shiti këtë apartament ka banuar deri në vitin 2017, bashkë me familjen e tij, tek banesa e prindërve të tij dhe prindërve të bashkëshortes, duke lëvizur herë pas here, pasi prindërit e bashkëshortes lëviznin në Itali për periudha relativisht të gjata dhe kjo i mundësonte një hapësirë më komode jetese. Më pas ka banuar tek banesa në Kavajë deri aktualisht.

5.18 Bashkëlidhur subjekti ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Nxjerrje llogarie për llogarinë në euro në OTP Bank, në emër të Altin Curri dhe Hatije Daiu, për periudhën 13.02.2023 — 30.06.2023.
- Për periudhën 10.03.2023 deri 30.06.2023, bashkëshortja ka tërhequr vlerën totale nga llogaria prej 20.145 euro.

5.19 Bazuar në deklarimin e subjektit, sqarimet dhe dokumentacionin e paraqitur, si dhe në

korrespondencën e administruar, në mënyrë të përmbledhur rezulton se:

- Trualli me sipërfaqe 1.230 m², blerë në vitin 2014, në vlerën 2.800.000 lekë dhe godina e banimit me sipërfaqe 148 m² dhe bodrum 148 m², ndërtuar në periudhën 2015 — 2017, në vlerën 5.397.000 lekë, kanë si burim të ardhura nga shitje e pasurive të paluajtshme, konkretisht shitja e tre apartamenteve në Qerret nga shtetasi B. S., shtetasve R. S., E. M. dhe P. B., në vlerat sipas kontratave 42.700 Euro, 42.700 Euro dhe 45.000 Euro, (përfituar ½ e vlerave sipas kësteve të përcaktuar në kontrata). Gjithashtu të ardhura nga shitja e apartamentit parafabrikat, në vlerën 3.382.166 lekë, në vitin 2011.
- Për periudhën 2000-2004, subjekti ka sqaruar se ai dhe bashkëshortja e tij kanë jetuar me prindërit e tyre deri në momentin e blerjes së apartamentit në vitin 2004, në vlerën 2.000.000 lekë, duke mos pasur shpenzime konsumi nga ana e tyre.
- Subjekti sqaroi se nga tërheqja në OTP Bank, të shumës 47.000 Euro (me burim të ardhurat nga shitja e pasurive të paluajtshme në Qerret, Kavajë, në vitin 2022), janë përdorur 22000 Euro për mobilimin dhe punimet e jashtme, deri në datën e dorëzimit të deklarates. Pjesa tjetër prej 13.000 Euro i përket tërheqjes pas datës së dorëzimit të deklarates vetting. Gjithashtu, ka sqaruar se ka kryer shpenzime për blerje mobilie provizore nga viti 2017 deri në vitin 2022, në shumën rreth 700.000 lekë.

- ✓ ASHK konfirmon regjistrimin e pasurisë truall + ndërtesë, në pronësi të Altin Curri dhe Hatije Daiu.
- ✓ Evidentohen pagesat e kryera nga llogaria në ABI Bank. për ndërtimin e shtëpisë, si dhe tërheqjet në OTP Bank, përdorur për mobilim.
- ✓ Shpenzime mobilimi dhe punime të jashtme për shtëpinë në Kavajë deri në datën e dorëzimit të deklarates së pasurisë, deklarohen në vlerën totale rreth 22.000 euro dhe 700.000 lekë.
- ✓ Subjekti nuk ka paraqitur fatura në lidhje me shpenzimet e kryera për këto dy pasuri.
- ✓ Burimi i krijimit të blerjes së pasurisë, punimeve të kryera dhe shpenzimeve të mobilimit, deklaruar nga kontrata të cilat rrjedhin nga ekzekutimi i aktmarrëveshjeve nr. ***/**/ dhe nr. ***/**/, datë 19.12.2005 dhe kontratës së sipërmarrjes nr. ***/**/, datë 19.12.2005, trajtuar më poshtë.

6. **Autoveturë Daimlerchrysler** (Mercedes Benz) tipi C220 , targa AA ****, viti 2001.
Burimi i krijimit: Kontratë shitblerje nr. **** rep., nr. *** kol., datë 22.6.2012.
Burimi, kursime nga të ardhurat familjare dhe të ardhura datë 9.11.2011, referuar kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr.*** kol., datë 20.02.2017 (bashkëlidhur mandati bankar datë 09.11.2011) (1/2 e vlerës 22.500 euro * 140 lekë/euro= 3.150.000 lekë).
Vlera: 500.000 lekë.
Pjesa takuese: 100%.

- 6.1 Subjekti ka bashkëlidhur deklarates kontratë shitblerje nr. **** rep., nr. *** kol., datë 22.06.2012.

HETIMI ADMINISTRATIV

6.2 **DPSHTRR** me shkresën nr. 30/27 prot., datë 11.05.2023, nuk e konfirmon automjetin e mësipërm në emër të subjektit apo personave të lidhur.

6.3 Referuar Kontratës së shitblerjes nr. **** rep., nr. *** kol., datë 22.06.2012, si dhe praktikës së përcjellë nga subjekti i vlerësimit, rezulton se Altin Curri i ka blerë palës shitëse, A. H. , automjetin tip Daimlerchrysler, C220 CDI, të vitit 2001, në vlerën 500.000 lekë. Likuidimi është kryer jashtë zyrës noteriale.

6.4 Trupa e Vlerësimit, nga kontrolli dhe verifikimi i kryer, konstaton se për burimin e krijimit të automjetit me targa AA****A kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e pasurive të paluajtshme, konkretisht: *Përfituar ¹/2 e vlerës sipas mandatpagesës së datës 09.11.2011, nga Societe Generale Albania, në vlerën 22.500 euro. (Trajtuar më poshtë).*

- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti.
- ✓ DPSHTRR, nuk e konfirmon automjetin e mësipërm në emër të subjektit anë personave të lidhur.
- ✓ Burimi i krijimit të pasurisë, deklaruar nga kontrata të cilat rrjedhin nga ekzekutimi i akt-marrëveshjeve nr. ***/*** dhe nr. ***/***, të datës 19.12.2005 dhe kontratës së sipërmarrjes nr. ***/***, datë 19.12.2005, trajtuar tek të ardhurat dhe të dhënat konfidenciale të subjektit të vlerësimit.

7. Autoveturë Daimlerchrysler (Mercedes Benz) tipi ***, targa AA ****YY, viti 2004 (1.000 euro * 122.1=122.100 lekë).

Burimi: të ardhura nga kursimet familjare.

Vlera: 122.100 lekë.

Zotëron: 100%.

7.1 Subjekti ka bashkëlidhur deklaratës:

- Certifikata e pronësisë së mjetit rrugor dhe leja e qarkullimit.
- Dokumentacion në gjuhën Gjermane, datë 21.10.2019.
- Deklaratë doganore, datë 25.10.2019.

HETIMI ADMINISTRATIV

7.1 **DPSHTRR** me shkresën nr. *** prot., datë 11.5.2023, konfirmon në emër të Altin Curri, mjetin me targë AA *** YY, tip Mercedes A 170, viti 2004, blerë sipas dokumentacionit bashkëlidhur në gjuhën Gjermane, e përkthyer zyrtarisht në gjuhën Shqipe, datë 31.10.2019. Bashkëlidhur praktika.

7.2 Referuar certifikatës së pronësisë së mjetit rrugor, datë 31.10.2019 dhe lejes së qarkullimit, rezulton se automjeti me targë AA ****YY, është në emër të Altin Curri.

7.3 Sipas dokumentacionit në gjuhën Gjermane, datë 21.10.2019 dhe deklaratës doganore datë 25.10.2024, rezulton se Altin Curri ka marrë automjetin tip Mercedes, viti 2004, nga eksportuesi A. H. Vlera e mjetit është 1.000 euro dhe paguar dogana 47.305 lekë.

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR.**

8. **Apartament në Qeret Kavajë, me sipërfaqe 69.36 m²**, blerë me kontratë shitblerje pasurie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.10.2022, me vlerë 2.299.284 lekë.

Burimi i krijimit: të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme, kontratë nr. **** rep., nr. *** kol., datë 22.03.2022.

Vlera 2.299.284 lekë.

Zotëron: 100%.

8.1 Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitje pasuri e paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.10.2022. Bashkëlidhur praktika e pronarëve të mëparshëm.
- Kartela e pasurisë dhe certifikata e regjistrimit të pronës.

HETIMI ADMINISTRATIV

8.2 **ASHK** me e-mailin e datës 25.09.2023, ka bashkëlidhur kthim përgjigje nga ASHK, Drejtoria Vendore Kavajë, ku informon se pasuria me nr. ****+1-6, është e regjistruar në emër të Altin Curri dhe Hatije Daiu.

8.3 **ASHK Drejtoria Vendore Kavajë**, me shkresën nr. *** prot., datë 27.09.2023, konfirmon pasurinë me nr. ****+1-6, e regjistruar në emër të Altin Curri. Bashkëlidhur kartela e pasurisë, për pasurinë me nr. ****+1-6, e llojit apartament, me sipërfaqe 69.36 m², e ndodhur në Qerret, Kavajë, në emër të Altin Curri dhe Hatije Daiu.

8.4 **ASHK Online** konfirmon pasurinë nr. ****+1-6, në emër të Altin Curri dhe Hatije Daiu.

8.5 **OTP Bank** me shkresën nr.*** prot., datë 05.05.2023, konfirmon në emër të Altin Curri ose Hatije Daiu, llogari në euro, ku konstatohet se në datën 31.10.2022, transferohet vlera 19.535 euro, në favor të G. B., me përshkrimin “Kalim në llogari të noteres për blerje sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.10.2022, me shitës S. dhe G. D..

- Konfirmon në emër të Altin Curri ose Hatije Daiu, llogari në euro, ku konstatohet se Hatije Daiu, në datën 02.11.2022, tërheq vlerën 35.000 euro dhe në datën 30.11.2022 tërheq vlerën 5.000 euro. Gjithashtu në datën 13.2.2023 tërheq vlerën 5.000 euro dhe 23.02.2023 vlerën 2.000 euro.

8.6 Trupa e Vlerësimit mori në shqyrtim dokumentacionin e përcjellë nga subjekti, nga ku rezulton se:

- Referuar kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. **** rep., nr. **** kol., datë 18.10.2022, Altin Curri ka blerë nga pala shitëse G. dhe S. D., pasurinë e llojit apartament, me sipërfaqe 69.36 m², me numër pasurie ****+1-6, e ndodhur në Qerret, Kavajë, në vlerën 2.299.284 lekë, të cilat paguhen në llogarinë e noterit tek OTP Bank. Bashkëlidhur praktika e pronarëve të mëparshëm.
- Gjithashtu, kartela e pasurisë dhe certifikata e regjistrimit të pronës, konfirmojnë pasurinë në emër të Altin Curri dhe Hatije Daiu, regjistruar në datën 11.11.2022.

8.7 Në lidhje me vlerën e kësaj pasurie, me inventarin e datës 12.07.2023, subjekti ka dorëzuar shpjegime me shkrim ku sqaron se përse i përket apartamentit të blerë në Qerret, Kavajë, me sipërfaqe 69.36 m², në vlerën 2.299.284 lekë dhe diferencës që përbën ky çmim krahasuar me vlerën e apartamenteve që ka shitur më datë 22.03.2022, ka të bëjë, në këtë rast, kryesisht vendndodhja, pasi apartamenti që ka blerë është larg detit dhe përpara tij ka ndërtesa të era, ndërsa apartamentet që ka shitur ishin shumë pranë detit dhe çdo apartament kishte fushëpamje nga deti. Gjithashtu, ky apartament, për shkak se në të, pothuajse, nuk ishte banuar për disa vite, ishte i amortizuar, gjë për të cilën u desh të bënte meremetime të brendshme. Në lidhje me konstatimin e OTP Bank si më sipër, sqaron se shumat prej 35.000 euro, 5.000 euro, 5.000 euro, 2.000 euro, kanë shërbyer për meremetime dhe mobilim për apartamentin 2+1 në Qerret, prej 69.39 m², i cili ishte i amortizuar, gjithashtu ato kanë shërbyer dhe për rregullimin e jashtëm të banesës në Kavajë, si dhe për mobilim dhe pajisje elektroshtëpiake (trajtuar më sipër).

8.8 Me e-mailin e datës 17.07.2023 subjekti ka dërguar dokumentacion justifikues dhe sqarime me shkrim, në lidhje me shpenzimet për mobilimin dhe meremetimet e brendshme dhe të jashtme për shtëpinë në Kavajë dhe apartamentin në Qerret....Këto punime konsistojnë në rregullimin nga e para, tërësisht, të tualetit, shembje të gjithë dyshemesë prishje të disa mureve të brendshme dhe riorganizim i ambienteve të brendshme, shtrim pllakash në të gjithë shtëpinë, suvatim, fino dhe rrjetë në të gjithë muret e brendshme, pllaka të reja, instalime hidraulike dhe elektrike tërësisht të reja, lysterje, dyer druri të brendshme, dritare, grila, tenda dielli, mobilim, elektroshtëpiake etj. Edhe këto punime i ka kryer me individë të rastësishëm, të cilëve i ka vënë herë pas here në dispozicion, materialet që i kanë kërkuar, ata kanë kryer punimet dhe i ka paguar në dorë.

8.9 Me e-mailin e datës 18.07.2023 subjekti ka dërguar foto të apartamentit në Qerret, Kavajë.

8.10 Me e-mailin e datës 27.09.2023 subjekti ka dhënë shpjegime në lidhje me shumën prej 60.000 euro të shpenzuara në apartamentin në Qerret, Kavajë dhe shtëpinë në Kavajë, ku sqaron se pavarësisht se nuk mund të bëjë një ndarje të detajuar të shpenzimeve për secilën, pasi nuk ka mbajtur një evidencë, deklaron se mund të ketë shpenzuar rreth 25.000 euro në apartamentin e ndodhur në Qerret.

8.11. Nga sa më sipër, Trupa e Vlerësimit konstaton se ka një diferencë ndërmjet vlerës së blerjes së apartamentit, krahasuar me çmimin e apartamenteve që subjekti ka shitur më datë 22.03.2022, ashtu sikurse ka një diferencë në krahasim me çmimin e tregut/ referencës për atë Bashki.

8.12 Referuar Vendimit nr. 168, datë 27.03.2019 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 132, datë 07.03.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriteve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, rezulton se *çmimi mesatar referues i shitblerjes së ndërtesave që përdoren për qëllim banimi*, për Bashkinë e Kavajës, në vitin 2019 ishte 51.000 lekë/m². Referuar çmimit të referencës, apartamenti i blerë do të kushtonte 3.537.360 lekë, ndërkohë që në vitin 2022 ky apartament ka kushtuar 2.299.284 lekë (33.150 lekë/m²)

8.13 Gjithashtu, nëse i referohemi apartamenteve të shitura nga subjekti i vlerësimit, rezulton se çmimi tregut për të njëjtën periudhë ka qenë më i lartë.

8.14 I pyetur nga Relatorja mbi këtë diferencë të çmimit, si dhe nëse ka ndikuar marrëdhënia e subjektit me palën shitëse z. G. D. në këtë çmim, pasi bashkëshortja e subjektit ka nënshkruar një kontratë huaje më datë 26.01.2023, duke i ka dhënë ortakëve të shoqërisë “*****” sh.p.k (G. D., G. P. dhe M.H.) shumën prej 60.000 euro. (Huaja trajtuar më poshtë); me e-mailin e datës 07.05.2024 ka dhënë sqarime si më poshtë vijon:

- *Vendndodhja e tyre është e ndryshme, në kuptimin e ndryshme në raport me detin. Apartamentet që shiti, përveç se secili prej tyre kishte pamje nga deti, vetë objekti ishte shumë pranë detit dhe me hapësirë të konsiderueshme të rërës publike dhe mundësi parkimi pa pagesë. Pra diferenca kryesore është pikërisht vendndodhja në raport me detin. Gjithashtu vetë objekti ku ndodheshin apartamentet që shiti subjekti ishte shumë i mirëmbajtur. Në apartamentin që bleu, përpara objektit ku ndodhet ky apartament, ka ndërtime të tjera.*
- *Përveç sa sipër, apartamenti që bleu ishte përdorur shumë pak për disa vite dhe kjo kishte sjellë amortizim sidomos në lagështirën e suvave të brendshme të cilat iu desh ti meremetonte, suva, pllaka dhe instalime.*
- *Shitësi G. D. është shok fëmijërie i subjektit dhe kanë marrëdhënie familjare. G. D. nuk ka fituar kur i bëri shitjen, pra e ka marrë me të njëjtin çmim që ai e kishte blerë.*

8.15 Bazuar në deklarin e subjektit sqarimet dhe dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPK dhe Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezulton se:

- Apartamenti në Qerret, Kavajë, me sipërfaqe 69.36 m², në emër të subjektit dhe bashkëshortes, ka si burim të ardhura nga shitje e pasurive të paluajtshme në Qerret, sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.03.2022, kaluar nëpërmjet OTP Bank. Subjekti

ka dhënë sqarimi mbi vlerën e blerjes, investimin e kryer në këtë apartament, si dhe burimin financiar.

- ✓ **ASHK konfirmon pasurinë e regjistruar në emër të subjektit dhe bashkëshortes.**
- ✓ **Subjekti ka sqaruar se ka kryer shpenzime për mobilim dhe meremetim për apartamentin me sipërfaqe 69.36 m², në Qerret, në vlerën totale rreth 25.000 euro.**
- ✓ **Burimi i krijimit të blerjes së pasurisë, shpenzimeve të meremetimit dhe mobilimit, është deklaruar nga kontrata të cilat rrjedhin nga ekzekutimi i akt-marrëveshjeve nr. ***/**/ dhe nr. ***/**/ të datë 19.12.2005 dhe kontratës së sipërmarrjes nr. ***/**/, datë 19.12.2005, trajtuar tek të ardhurat e subjektit dhe të dhënat konfidenciale.**

9. **Llogari bankare në OTP Bank**, me gjendje në datë 08.03.2023.

Vera: 508.311 euro,

Burimi i krijimit: të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme, kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.03.2022.

Pjesa takuese: 100 %.

9.1 Subjekti ka bashkëlidhur deklaratës shkresë nga OTP Bank, për llogarinë në euro në emër të Altin Curri ose Hatije Daiu.

HETIMI ADMINISTRATIV

9.2 **OTP Bank** me shkresën nr. *** prot., datë 05.05.2023, konfirmon në emër të Altin Curri ose Hatije Daiu, llogari në euro, me gjendje në datë 10.03.2023, në vlerën 508.311 euro. Konstatohet se në datën 08.08.2022, kreditohet vlera 796.000 euro, me përshkrimin “Kalim shume sipas kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.03.2022 dhe shtojcë kontrate nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.07.2022 me shitës Altin Curri, Hatije Daiu”.

9.3 Me e-mailin e datës 17.07.2023, subjekti ka dërguar dokumentacion justifikues, si dhe sqarimet me shkrim në lidhje me shtojcën e kontratës se datës 11.07.2022, e cila sqaron se bëhet fjalë për një shtyrje të afatit të atëhershëm të pagesës.

9.4 Subjekti ka bashkëlidhur email-it dokumentacioni si me poshtë:

- Shtesë kontrate nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.07.2022, amendim i kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.03.2022, me palë shoqëria B***** H*****, Altin dhe Hatije Daiu, Ndryshimi konsiston në faktin që në përshkrimin e kartelës secila pasuri rezulton e cituar “Truallit shtet”. Aktualisht pjesa takuese e truallit është blerë dhe në këtë mënyrë detyrimi ndaj shtetit është likuiduar. Gjithashtu ndryshojnë afatin e likuidimit si vijon: Çmimi i shitjes i përcaktuar në kontratën e datës 22.03.2022, në vlerën 796.000 euro, nga të cilat 60.000 euro janë paguar dhe ndodhen në llogarinë e noterit, dhe pjesa e mbetur do të paguhet nëpërmjet kredisë bankare në OTP Bank, brenda datës 10.08.2022. Në rast se nuk zbatohet ky parashikim, kontrata do të konsiderohet e zgjidhur.

9.5 Konstatohet se:

- ✓ Burimi i llogarisë bankare në OTP rezulton nga shitja e pasurive të paluajtshme në vlerën totale prej 796.000 euro, sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.3.2022. (Trajtuar tek të ardhurat).
- ✓ Konfirmohet deklarimi me përgjigjen e OTP Bank.
- ✓ Burimi i krijimit të depozitës, deklaruar nga kontrata të cilat rrjedhin nga ekzekutimi i akt-marrëveshjeve nr. ***/*** dhe nr. ***/***, datë 19.12.2005 dhe kontratës së sipërmarrjes nr. ***/***, datë 19.12.2005, **trajtuar më poshtë.**

10. **Llogari bankare në Raiffeisen Bank**, me gjendje në datë 08.03.2023.

Vlera: 111.484 lekë.

Zotëron 100 %

HETIMI ADMINSTRATIV

10.1 **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, konfirmon në emër të Altin Curri, llogari page në lekë, me gjendje në datën 10.03.2023, në vlerën 111.484 lekë, ku evidentohen kreditime nga pagat nga viti 2005.

- ✓ Llogaria bankare është krijuar qatë periudhës 2005 - 2023, me të ardhurat nga paga.
- ✓ Konfirmohet deklarimi me përgjigjen e Raiffeisen Bank.

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- a. Komandant poste Rapdisht, Komisariati i Policisë Dibër, me gradën Nëntoger, nga data 01.07.2000 deri në datë 15.11.2001, shuma 275.638 lekë.
- b. Inspektor i Zyrës Rajonale Kundër Trafikeve Të Paligjshme në Drejtorinë e Policisë Dibër, nga data 16.11.2001 deri në datë 21.08.2003, shuma 464.054 lekë.
- c. Oficer i Policisë Gjyqësore në Komisaratin e Policisë Dibër, nga data 21.08.2003 deri në datë 16.08.2004, shuma 381.006 lekë.
- d. Oficer i Policisë Gjyqësore në Drejtorinë e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Rendit, nga data 16.08.2004 deri në datë 02.11.2009, shuma 3.874.002 lekë.
- e. Specialist në Drejtorinë e Hetimit dhe Testit të Integritetit në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, nga data 02.11.2009 deri në datë 11.12.2009, shuma 73.162 lekë.
- f. Reformë, lirim nga detyra me kërkesën time, nga data 11.12.2009 deri në datë 01.07.2010, shuma 419.612 lekë.
- g. Specialist në Sektorin e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm Vlorë, nga data 01.07.2010 deri në datë 10.09.2010, shuma 212.733 lekë.
- h. Shef Sektori në Sektorin e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm Vlorë, nga data 10.09.2010 deri në datë 01.12.2010, shuma 212.733 lekë.
- i. Shef Sektori në Sektorin e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm Elbasan, nga data 01.12.2010 deri në datë 12.11.2012, shuma 1.582.927 lekë.

- j. Shef Sektori në Sektorin e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm Durrës, nga data 12.11.2012 deri në datë 01.04.2014, shuma 1.183.413 lekë.
- k. Specialist në Sektorin e Drejtim Hetimit në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, nga data 01.04.2014 deri më datë 29.5.2018, shuma 4.960.430 lekë.
- l. Shef në Sektorin e Sigurimit të Personelit dhe Monitorimit të Brendshëm pranë Drejtorisë së Analizës nga data 29.05.2018 deri më 01.11.2018, shuma 481.663 lekë.
- m. Drejtor i Drejtorisë së Hetimit nga 01.11.2018 deri aktualisht, shuma 5.761.007 lekë.
- n. Shitje banesës parafabrikat 1+1 apartament, me nr. pasurie ***+1-5, zk. ****, sipas kontratës së shitblerjes me nr. **** rep., nr. **** kol., datë 14.11.2011, shuma 3.382.166 lekë.
- o. Shitje e apartamentit me nr. pasurie ***+1-1, me adresë në Qerret, Kavajë, sipas kontratës së porosisë për ndërtim e dorëzim apartamenti me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 02.03.2009. Në përmbushje të akt marrëveshjes me deklaram noterial me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.12.2005, kam përfituar 50 % të vlerës së shitjes, e gjitha në 3 këste. **Vlera 21.350 euro.**
- p. Shitje apartamenti me nr. pasurie ***+1-7, me adresë në Qerret, Kavajë, sipas kontratës së porosisë për ndërtim e dorëzim apartamenti me nr. *** rep., nr. **** kol., datë 02.03.2009. Në përmbushje të akt marrëveshjes me deklaram noterial, me nr. **** rep., nr. *** kol., datë 19.12.2005, kam përfituar 50 % të vlerës së shitjes, e gjitha në 3 këste. **Vlera 21.350 euro.**
- q. Këmbim të dy apartamenteve, të cilat në përmbushje të akt marrëveshjes me deklaram noterial, të datës 19.12.2005, nr. **** rep., nr. *** kol., shtetasi B. S. më detyrohej. Me akt marrëveshjen nr. **** rep., nr. *** kol., datë 23.04.2018, këto apartamente janë këmbyer me shumën 50.000 euro, nga të cilat kam marrë vetëm 15.000 euro (pagesë me 3 këste, Tetor 2017, Dhjetor 2017 dhe Mars 2018 me nga 5.000 euro secili). **Vlera 15.000 euro.**
- r. Shitje e pasurive të paluajtshme me rezervë pa kalim pronësie me kontratë Shitje nr. *** rep., nr. ****, datë 22.03.2022. **Vlera 796.000 euro.**

11. Subjekti i vlerësimit ka bashkëlidhur dokumentacion justifikues i cili është marrë në shqyrtim gjatë hetimit administrativ të kryer.

HETIMI ADMINISTRATIV

12. Në lidhje me **të ardhurat nga punësimi**, Trupa e vlerësimit mori në shqyrtim dokumentacionin dhe përgjigjet e institucioneve përkatëse, nga ku rezulton se:

12.1 Referuar vërtetimit për pagën e vlerësueshme, nga Drejtoria Vendore e Policisë Dibër, konfirmohet se Altin Curri, për periudhën 01.07.2000 — 16.08.2004, ka përfituar pagë neto në vlerën 1.120.698 lekë.

12.2 Referuar vërtetimit nga Ministria e Brendshme, datë 25.04.2018, vërtetohet se Altin Curri, për periudhën 16 Gusht 2004 - 31 Dhjetor 2005, ka përfituar të ardhura neto nga paga në vlerën 661.853 lekë.

12.3 **Raiffeisen Bank** me shkresën nr. ** prot., datë 08.05.2023, konfirmon në emër të Altin Curri, llogari page në lekë, ku konfirmohen kreditimet nga paga, shpërblime, dieta dhe veshje, për periudhën 05.05.2005 — 02.03.2023, në vlerën totale rreth 17.905.000 lekë. *(Në vitin 2005 janë llogaritur vetëm dieta dhe shpërblime, në vlerën 68.600 lekë).*

12.4 Raiffeisen Bank, më datë 03.07.2023, ka përcjellë vërtetim për llogarinë e Altin Curri, e cila ka të pasqyruar në formë tabele kreditimet dhe debitimet në llogarinë në lekë, për periudhën 2005 – 2023.

12.5 **ISSH** me shkresën nr. ** prot., datë 10.05.2023, konfirmon pagat bruto/neto të Altin Curri, për periudhën Janar 2012 — Mars 2023, në subjektet (Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat dhe Agjencia e Mbikëqyrjes Policore).

12.6 Gjithashtu, në proces-verbali ne datës 20.10.2023, në sqarimet e tij, subjekti thekson, se për periudhën nga viti 2000 dhe me sa mban mend deri në vitin 2003, ka përfutur edhe taksën e solidaritetit, siç e kanë përfutur të gjithë punonjësit e policisë së shtetit, për të cilat nuk disponon dokumentacion përkatës, pasi ka kaluar kohë e gjatë. Gjithashtu për këtë periudhë ka përfutur edhe shpërblime, si dhe orë suplementare, për të cilat gjithashtu nuk disponon dokumentacion justifikues. Taksa e solidaritetit ka qenë, me sa mban mend, në vlerën rreth 9.000 lekë në muaj neto, ndërsa për shpërblimet dhe orët suplementare, nuk përcakton dot një vlerë të përafërt, pasi varej nga dinamika e punës dhe rezultatet e herë- pas-hershme.

13. **Në lidhje me shitjen e banesës parafabrikat 1+1 apartament, shuma 3.382.166 lekë**, subjekti ka përcjellë dokumentacion dhe sqarime, konkretisht:

13.1 Kontratë datë 09.02.2004, me pale shitëse B., F., A., E. H. dhe blerës Altin Curri, për apartament me sip. 58 m², me numër pasurie ****+1-5, e ndodhur në Kavajë, në vlerën 2.000.000 leke, nga të cilat 1.000.000 lekë janë likuiduar në këtë zyrë noteriale dhe diferenca do paguhet brenda datës 31.07.2004. Bashkëlidhur praktika.

13.2 Deklaratë noteriale datë 23.07.2004, ku palët deklarojnë se në datë 09.02.2004 kanë lidhur një kontratë shitblerje apartamenti kundrejt shumës 2.000.000 lekë, nga te cilat 1.000.000 lekë i likuiduan në momentin e nënshkrimit të kontratës dhe diferenca u likuidua sot në këtë zyrë noteriale.

13.3 Sipas Kontratës së shitblerjes datë 14.11.2011, Altin Curri dhe Hatije Curri i kanë shitur palës blerëse J.R. këtë apartament në vlerën 3.382.166 lekë, vlerë e cila është shlyer jashtë zyrës noteriale.

14. **Në lidhje me të ardhurat nga shitja e apartamenteve në Qerret, Kavajë, sipas kontratës së porosisë për ndërtim e dorëzim apartamenti datë 02.03.2009, Trupa e Vlerësimit fillimisht mori në shqyrtim dokumentacionin e plotë të Objektivit të ndërtuar në Qerret Kavajë, si më poshtë vijon:**

14.1 Vendim i Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, nr. 135, datë 27.08.2004, ku është vendosur miratimi i kërkesës së subjektit ***** shpk dhe subjektit B. S., për kërkesës së subjektit ***** shpk dhe subjektit B. S., për ndërtimin e strukturave turistike në parcelën e ndodhur në Golem, Kavajë, me sipërfaqe sheshi 4.960 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 1.720 m², me 5 kate me garazhe + nënçati. Subjektit i jepet 18 muaj kohë për plotësimin e dokumentacionit për marrjen e lejes së ndërtimit. Garancitë dhe stimujt që jep titulli “Person i Stimuluar”, hyjnë në fuqi me nënshkrimin e marrëveshjes së zhvillimit.

14.2 Urdhër i Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, nr. 325, datë 06.09.2004, për shpalljen e Vendimit të Këshillit të Zhvillimit të Turizmit, nr. 135, datë 27.08.2004, për miratimin e veprimtarisë turistike për subjektin ***** shpk dhe B. S.

14.3 Akt-marrëveshje datë 19.12.2005, me palë B. S., shoqëria ***** shpk dhe shoqëria ***** shpk. Objekti i kësaj marrëveshje është heqja dorë e shoqërisë ***** shpk, nga titulli “Person i stimuluar” dhe nga e drejta për të investuar në kompleksin e miratuar, sipas Vendimit nr. 135, datë 27.08.2004, Transferimin e titullit “Person i Stimuluar” shoqërisë ***** shpk, si dhe të drejtën për të investuar në kompleksin e miratuar me vendimet e sipërcituara. Zëvendësimin në lejen e ndërtimit të shoqërisë ***** shpk me shoqërinë ***** shpk.

14.4 Akt marrëveshje datë 19.12.2005, me palë B. S. dhe Altin Curri, ku specifikohet se B. S. dhe ***** shpk, është shpallur “person i stimuluar” për të realizuar ndërtimin e një kompleksi ndërtimi me sipërfaqe totale prej 4.960 m², me vendodhje në Golem, Kavajë. Në këtë investim pavarësisht se në këto akte deklarohet vetëm zoti B. S., në realitet është investim i përbashkët i B. S. dhe Altin Curri. Për efekt të këtyre marrëdhënieve të vendosura, do të quhen bashkë-investitorë, të cilët pranojnë të mbushin këto detyrime:

- Lejojnë dhe autorizojnë z. B. S., që të nënshkruajë kontrata sipërmarrje dhe n/sipërmarrje me shoqërinë ***** shpk.
- I njohin të drejtën dhe kompetencën për të nënshkruar akt-marrëveshje në bazë të së cilës z. B. S. të largohet nga ky investim, si dhe të pranojë zëvendësimin si “person i stimuluar” me shoqërinë ***** shpk.
- Kontratë sipërmarrje datë 19.12.2005, me palë B. S. porositësi dhe shoqëria ***** shpk sipërmarrësi, me objekt ndërtimin e një kompleksi godinash polifunkionale, sipas lejes së ndërtimit, Vendim të Këshillit të Zhvillimit të Turizmit. Kalimin e personit të stimuluar nga pala e parë tek pala e dytë. Në këmbim të tyre porositësi përfiton sipërfaqe banimi në masën 25 %, nga i gjithë ndërtimi.
- Pavarësisht se kontrata është nënshkruar vetëm nga z. B. S., palët pranojnë dhe njohin si të ligjshme këtë kontratë të nënshkruar ndërmjet tij dhe shoqërisë ***** shpk, në bazë të së cilës marrin pjesë takuese 25 %, si dhe kushtet e tjera që janë përcaktuar. Pranojnë bashkarisht, që nga kjo sipërfaqe z. Altin Curri do të përfitojë ½ e 25 % nga ndërtimet që do të bëhen, sipas lejes së ndërtimit 4 kat + papafingo. B. S. do të përfitojë 1/2 e 25 % nga ndërtimet që do të bëhen, sipas lejes së ndërtimit 4 kat + papafingo.

14.5 Deklaratë noteriale datë 11.06.2009, me palë deklaruese B. S., i cili deklaron se është investitor në objektin e ndodhur në Golem, Kavajë, se bashku me shoqërinë ***** shpk.

- Deklaron se kane ndarë investimin ne masën 75 % shoqëria ***** shpk dhe 25 % B. S.

15. **Për sa i përket shitjes së apartamenteve nga B. S., ku subjekti ka përfituar 50% të të ardhurave nga këto shitje, Trupa e Vlerësimit mori në shqyrtim dokumentacionin si vijon:**

15.1 Kontratë porosie datë 02.03.2009, me palë **R. S.**, shoqëria ***** shpk dhe B. S., me objekt investimin, për ndërtimin e një apartamenti banimi të përfunduar, **për apartament nr. 1, sipërfaqe 61 m², me numër pasurie *****+1-1**, Kavajë, ndërtuar në objektin e miratuar me Vendimin nr. 135, citohet se ky apartament është pjesë takuese e B. S.

15.2 Kontratë porosie., datë 02.03.2009, me palë **E. M.**, shoqëria ***** shpk dhe B. S., me objekt investimin, për ndërtimin e një apartamenti banimi të përfunduar, **për apartament nr. 7, i emërtuar A-2**, Kavajë, citohet se ky apartament është pjesë takuese e B. S.

15.3 Kontratë shitblerje datë 20.2.2017, me palë shitëse B. S. dhe blerës **P. B.**, me objekt shitjen e një apartamenti me sipërfaqe 55 m², ndodhur në Qerret, Kavajë, me numër pasurie *****+1-13, në vlerën 45.000 euro, shumë e likuiduar plotësisht.

15.4 Mandat pagese nga Societe Generale Albania, datë 09.11.2011, me palë transferues Paolo Bacca dhe përfitues B. S., të vlerës 45.000 euro, me përshkrimin “Pagesa e kështit të parë për blerje apartamenti A-3, adresa Qerret, Golem.

16. Në lidhje me **objektin në Qerret**, subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues, si dhe sqarime me shkrim, ku sqaron se janë shitur 3 apartamente nga pjesa 25% që i përkiste subjektit dhe B. S., si më poshtë:

1) Apartamenti me nr. pasurie ***+1-1, i cili është shitur sipas Kontratës së Porosisë datë 02.03.2009, ku blerësi R. S. ka likuiduar plotësisht vlerën e apartamentit. Vlera totale prej 42.700 euro është likuiduar në tre këste. Në kujtesën e tij ato janë likuiduar; kësti i parë prej 10.000 euro është likuiduar në Tetor 2008, kësti i dytë prej 10.000 euro është likuiduar më 30.04.2009 dhe kësti i tretë prej 22.700 euro është likuiduar në Janar të vitit 2012. Nga të tre këstet, ka përfituar 50% të vlerës në secilin prej tyre, cash, nga B. S., kjo në përmbushje dhe sipas marrëveshjes me deklaram noterial, datë 19.12.2005, pohuar nga B. S. dhe në deklaratën noteriale datë 04.09.2019. Të gjitha vlerat janë likuiduar në cash nga ana e shtetasit kosovar R. S.

2) Apartamenti me nr. pasurie ***+1-7, i cili është shitur sipas kontratës së porosisë datë 02.03.2009, blerësi E. M. ka likuiduar plotësisht vlerën e apartamentit. Vlera totale prej 42.700 euro është likuiduar në tre këste, ku subjekti ka përfituar 50% të vlerës në secilin prej tyre, cash, nga B. S., kjo në përmbushje dhe sipas marrëveshjes me deklaram noterial, datë 19.12.2005, pohuar nga B. S. dhe në deklaratën noteriale datë 04.09.2019.

Shënim: Të dy shtetasit kosovarë E. M. dhe R.S., janë miq me njëri- tjetrin dhe me sa di dhe ortakë në të njëjtin biznes në Kosovë. Këtë shpjegim e jep për të kuptuar pse shitjet janë bërë në të njëjtën datë dhe të njëjtën formë.

- 3) Apartamenti me nr. pasurie ***+1-13, formalizuar shitja sipas kontratës së shitblerjes datë 20.02.2017. Ky apartament me vlerë 45.000 euro, është likuiduar i gjithi me datën 09.11.2011, me anë të një transaksioni bankar nga shtetasi P. B. tek B. S.. Dokumenti bankar i xhirimit të kësaj shume, është bashkëngjitur kontratës. Nga kjo vlerë, ka përfituar 50% cash, sipas marrëveshjes me deklaram noterial, datë 19.12.2005, pohuar nga B. S. dhe në deklaratën noteriale të datës 04.09.2019.

- ✓ **Sic përshkruhet më lart, të tre këto apartamente, në të cilat ka përfituar 1/2 e vlerës së shitjes, janë pjesë e 25%, që ata kanë përfituar sipas marrëveshjes me firmën ndërtuese.**
- ✓ **Këto apartamente i kanë shitur para se subjekti Altin Curri dhe B. S. të bënin ndarjen nominale në natyrë të objektit.**

17. Në lidhje me këmbimin e dy apartamenteve, të cilat në përmbushje të akt-marrëveshjes me deklaram noterial, të datës 19.12.2005, shtetasi B. S. i detyrohej subjektit, me akt-marrëveshjen e datës 23.04.2018, këto apartamente janë këmbyer me shumën 50.000 euro, nga të cilat ka marrë vetëm 15.000 euro (pagesë me 3 këste), Trupa e Vlerësimit mori në shqyrtim dokumentacionin justifikues të përcjellë nga subjekti, konkretisht:

17.1 Akt marrëveshje datë 23.04.2018, me palë B. S. dhe Altin Curri, të cilët kanë lidhur një akt-marrëveshje datë 19.12.2005, ku pranojnë se palët kanë qenë bashkë-investitorë dhe përcaktojnë pjesët e tyre takuese në masën 1/2 të 25 %, në kompleksin e ndërtimit në Golem Kavajë. Shtetasi B. S., në përmbushje të akt-marrëveshjes, i detyrohet shtetasit Altin Curri edhe dy apartamente, si dhe % e një bodrumi. Në marrëveshje midis tyre, palët kanë rënë dakord që nga ana e B. S. të mos bëhet dorëzimi në natyrë i 2 (dy) apartamenteve, por të bëhet likuidimi në vlerë monetare në shumën 50.000 euro, nga të cilat 15.000 euro janë paguar jashtë zyrës noteriale, ndërsa shuma prej 35.000 euro do të likuidohet për një periudhë të pacaktuar. Për 1/2 e bodrumit, palët kanë rënë dakord që në momentin që do të bëhet regjistrimi do të jenë bashkëpronarë të tij, në pjesë të barabartë.

17.2 Gjithashtu, në sqarimet e tij me shkrim, subjekti është shprehur se marrëveshja e datës 23.04.2018, ishte plotësim i marrëveshjes së parë të datës 29.04.2017. Sipas përllogaritjeve në terren, përveç apartamenteve që kaluan me marrëveshjen e parë, pjesë e 12.5% ishin dhe 2 apartamente + 50% e bodrumit. Për këto dy apartamente, ata nuk e kishin vendosur nëse do ti mbante B. S. kundrejt pagesës për to, apo do ja kalonte në emrin e tij, siç ishte përllogaritja. Pasi vendosën që ti mbante B. S., kundrejt çmimit prej 50.000 euro, e formalizuan marrëveshjen duke shtuar aty dhe çështjen e bodrumit dhe ndarjen e tij mes tyre. Konkretisht apartamentet kanë nr. pasurie ***+1-11 dhe nr. ***+1-12. Nga shuma prej 50.000 euro që i detyrohej B.S., ai i ka likuiduar, në periudhën Tetor 2017 - Mars 2018, kesh në dorë 15.000 euro dhe pjesa tjetër prej 35.000 euro vazhdon të jetë e pa likuiduar, pohuar kjo nga B. S. dhe në deklaratën noteriale me nr. *** rep. dhe *** kol, datë 04.09.2019.

18. Në lidhje me **të ardhurat nga shitja e pasurive të paluajtshme me rezervë pa kalim pronësie me kontratë shitje datë 22.03.2022, në vlerën 796.000 euro**, Trupa e Vlerësimit kreu verifikimet dhe analizimin e dokumentacionit të përcjellë, sqarimet dhe korrespondencën me subjektin e vlerësimit; konkretisht si vijon:

18.1 Kontratë dhurimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.04.2017, me palë dhuruese B. S. dhe pranues Altin Curri, me objekt dhurimin e një apartamenti me sipërfaqe 55 m², me nr. *****+1-14**, ndodhur në Qerret, Kavajë.

18.2 Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 06.05.2017, për pasurinë me nr. *****+1-14**, e llojit apartament me sipërfaqe 55 m², ndodhur në Qerret, Kavajë, në emër të Altin Curri. Bashkëlidhur kartela e pasurisë dhe harta treguese.

18.3 Kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.04.2017, me palë dhuruese B. S. dhe pranues Altin Curri, me objekt dhurimin e një apartamenti me sipërfaqe 53 m², me nr. *****+1-16**, ndodhur në Qerret, Kavajë.

18.4 Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 06.05.2017, për pasurinë me nr. *****+1-16**, e llojit apartament me sipërfaqe 53 m², e ndodhur në Qerret, Kavajë, në emër të Altin Curri. Bashkëlidhur kartela e pasurisë dhe harta treguese.

18.5 Kontratë dhurimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.04.2017, me palë dhuruese B. S. dhe pranues Altin Curri, me objekt dhurimin e një njësie me sipërfaqe 150 m², me nr. *****+1-NI**, e ndodhur në Qerret, Kavajë.

18.6 Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 05.05.2017, për pasurinë me nr. *****+1-NI**, e llojit njësi me sipërfaqe 150 m², ndodhur në Qerret, Kavajë, në emër të Altin Curri. Bashkëlidhur kartela e pasurisë dhe harta treguese.

18.7 Kontratë dhurimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.04.2017, me palë dhuruese B. S. dhe pranues Altin Curri, me objekt dhurimin e një apartamenti me sipërfaqe 51 m², me nr. *****+1-18**, e ndodhur në Qerret, Kavajë.

18.8 Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 06.05.2017, për pasurinë me nr. *****+1-18**, e llojit apartament me Sipërfaqe 51 m², ndodhur në Qerret, Kavajë, në emër të Altin Curri. Bashkëlidhur kartela e pasurisë dhe harta treguese.

18.9 Kontratë dhurimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.04.2017, me palë dhuruese B. S. dhe pranues Altin Curri, me objekt dhurimin e një apartamenti me sipërfaqe 49 m², me nr. *****+1-20**, e ndodhur në Qerret, Kavajë.

18.10 Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 06.05.2017, për pasurinë menr. *****+1-20**, e llojit apartament me sipërfaqe 49 m², e ndodhur në Qerret, Kavajë, në emër të Altin Curri

Bashkëlidhur kartela e pasurisë dhe harta treguese.

18.11 Kontratë dhurimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.04.2017, me palë dhuruese B. S. dhe pranues Altin Curri, me objekt dhurimin e një apartamenti me sipërfaqe 50 m², me nr. ***+1-17, ndodhur në Qerret, Kavajë.

18.12 Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 06.05.2017, për pasurinë me nr. ***+1-17, e llojit apartament me sipërfaqe 50 m², ndodhur në Qerret, Kavajë, në emër të Altin Curri. Bashkëlidhur kartela e pasurisë dhe harta treguese.

18.13 Kontratë dhurimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.04.2017, me palë dhuruese Bledar Sinella dhe pranues Altin Curri, me objekt dhurimin e një apartamenti me sipërfaqe 49 m², me nr. ***+1-15, ndodhur në Qerret, Kavajë.

18.14 Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 06.05.2017, për pasurinë me nr. ***+1-15, e llojit apartament me sipërfaqe 49 m², ndodhur në Qerret, Kavajë, në emër të Altin Curri. Bashkëlidhur kartela e pasurisë dhe harta treguese.

18.15 Kontratë Shitje me rezervë, datë 22.03.2022, me palë shitëse Altin Curri dhe Hatije Daiu dhe palë blerëse shoqëria “B***** H*****” shpk, për pasuritë e ndodhura në Qerret, Kavajë, si më poshtë:

1. Njësi me sipërfaqe 150 m², me numër pasurie ***+1-NI, në vlerën 431.250 euro.
2. Apartament me sipërfaqe 53 m², me numër pasurie ***+1-16, në vlerën 46.693 euro.
3. Apartament me sipërfaqe 49 m², me numër pasurie ***+1-20, në vlerën 138.000 euro.
4. Apartament me sipërfaqe 49 m², me numër pasurie ***+1-15, në vlerën 43.169 euro.
5. Apartament me sipërfaqe 51 m², me numër pasurie ***+1-18, në vlerën 44.931 euro.
6. Apartament me sipërfaqe 50 m², me numër pasurie ***+1-17, në vlerën 44.050 euro.
7. Apartament me sipërfaqe 55 m², me numër pasurie ***+1-14, në vlerën 48.455 euro.

18.16 Çmimi i shitjes së pasurive të sipërcituara është në vlerën totale prej 796.000 euro, nga të cilat 60.000 euro do të paguhet nga blerësi pas nënshkrimit të kësaj kontrate dhe pjesa e mbetur do të paguhet nëpërmjet kredisë bankare marrë pranë OTP Bank brenda datës 01.06.2022. Vlera prej 60.000 euro do të kalojë në llogarinë e noterit dhe do të qëndrojë në këtë llogari deri në momentin që do të bëhet pagesa e plotë e çmimit të shitjes nga blerësi. Blerësi merr përsipër që të paraqesë kontratën pranë OTP Bank, me qëllim miratimin e kredisë me të cilën do mundësohet pagimi i shumës totale të shitjes. Blerësi do të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me tatimin për kalimin e pronësisë, shpenzimet noteriale, tarifatat për veprimet lidhur me regjistrimin kalimit të titullit të pronësive, bllokimet, etj. Bashkëlidhur praktika.

18.17 **OTP Bank**, konfirmon në emër të Altin Curri ose Hatije Daiu, llogari në euro, ku konstatohet se në datën 08.08.2022, kreditohet vlera 796.000 euro, me përshkrimin “Kalim shume sipas kontratës së shitjes.

18.18 Subjekti ka dhënë sqarime të hollësishme pranë ILDKPKI-së dhe Trupës së Vlerësimit, ku në mënyrë të përmbledhur shprehet se, “Këto pasuri të paluajtshme, kanë si burim ligjin nr. 7665, datë 21.01.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin” dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 789, datë 26.11.2003 “Për funksionimin dhe organizimin e brendshëm të Këshillit të Zhvillimit të Turizmit”, konkretisht unë dhe shtetasi B. S., kemi aplikuar në Ministrinë e Turizmit për të marrë titullin “person i stimuluar” sipas këtij ligji. Aplikimin e ka bërë z. B. S. i autorizuar dhe në emrin tim, për të ndjekur dhe procedurat në vazhdim. Me Vendimin e Këshillit të Zhvillimit të Turizmit, nr. 135, datë 27.08.2004 dhe Urdhrin nr. 325, datë 06.09.2004, u miratua titulli “person i stimuluar” për **** shpk dhe B. S.. Në vijim subjekti **** shpk, tërhiqet nga ky investim duke u zëvendësuar me subjektin **** shpk, ky fakt u formalizua me akt marrëveshjen datë 19.12.2005. Gjithashtu u formalizua dhe pjesa takuese mes meje Altin Currit dhe B. S., me akt marrëveshjen me deklaram noterial, datë 19.12.2005. Subjekti **** shpk vijoi me ndërtimin e apartamenteve.

18.19 Subjekti ka bashkëlidhur dokumentacion, konkretisht:

18.20 Kontratë hipoteke nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.07.2022, me palë hipotekues Altin Curri, hipotekues i ardhshëm B***** H***** shpk, dhe përfitues Banka OTP Albania sha. Hipotekuesi ka në pronësi pasuritë me nr. ****+1-14, ****+1-15, ****+1-16, ****+1-17, ****+1-18, ****+1-20, ****+1-N1, pasuri të cilat i hipotekon në favor të shoqërisë B***** H***** shpk, deri në likuidimin e plotë të çmimit të shitjes së kontratës shitjes me rezerve nr. *** rep, nr. *** kol, datë 22.03.2022. Pasuritë hipotekohen në favor të përfituesit për të garantuar kthimin e kredisë së marrë nga shoqëria B***** H***** shpk, për kreditimin e vlerës 1.500.000 euro. Me regjistrimin në ASHK, Dega Kavajë, të kontratës nr. *** rep, nr. *** kol, datë 22.03.2022 dhe kalimin në pronësi të hipotekuesve të ardhshëm, palët bien dakord që të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kjo kontratë hipoteke ti kalojnë hipotekuesve të ardhshëm. Bashkëlidhur praktika.

18.21 Akt marrëveshje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.04.2018 (trajtuar më sipër).

18.22 Kthim përgjigje nga shoqëria **** shpk., drejtuar Altin Curri, ku sqarohet se parcela ku është zhvilluar ndërtimi në Qerret, Kavajë është tokë shtet dhe i gjithë investimi është kryer nga shoqëria **** shpk, ndërsa shtetasi B. S. nuk ka kryer asnjë investim në ndërtimin e këtij kompleksi.

18.23 Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.04.2017, me palë deklaruese B. S. dhe Altin Curri, të cilët deklarojnë se në vitin 2004 kanë marrë vendim të investojnë për ndërtimin e një fshati turistik në Golem, Kavajë. Ministria e Rregullimit të Turizmit, ka miratuar “person i stimuluar” shtetasin B. S. dhe shoqëria **** shpk. Investimi më pas është kryer nga shoqëria **** shpk dhe me këtë deklaratë kanë vendosur të ndajnë pjesët takuese të Altin Currit, të cilat do të kalojnë në pronësi të tij: Pasuritë me nr. ****+1-14, ****+1-15, ****+1-16, ****+1-17, ****+1-18, ****+1-20, ****+1-N1. **Veprimet juridike për kalimin e pronësisë janë me Kontratë Dhurimi. Shtetasi B. S. ka shlyer të gjitha detyrimet tatimore për këto pasuri.**

18.24 Kontratë për caktimin e pjesëve në natyrë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 03.12.2016, me palë B. S. dhe shoqëria **** shpk, me objekt ndarja në natyrë e pjesëve takuese si person i stimuluar, në bazë të kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.12.2005. Për truallin e vënë në dispozicion, “person i stimuluar” B. S., shesh ndërtimi i ndodhur në fshatin Qerret, Kavajë, miratuar me Vendimin nr. 135, datë 27.08.2004 të Këshillit të Zhvillimit të Turizmit, shpallur me Urdhrin nr. 325/2004, të Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, me qëllim për të ndërtuar 5 struktura turisitke. Leja e ndërtimit dhe vendimi i KRRT, Komuna Golem, janë të vitit 2005. Shtetasi B. S. ka përfituar dhe ka marrë në dorëzim, në total 20 apartamente (nga të cilat 2 apartamente kati nën çati me verandë), me sipërfaqe totale 1.480 m² dhe 2 njësi, me sipërfaqe totale 445 m². Bashkëlidhur praktika.

18.25 Kontratë sipërmarrje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.12.2005, me palë B. S. porositësi dhe shoqëria **** shpk sipërmarrësi, me objekt ndërtimin nga pala e te, të një kompleksi godinash polifunksionale, sipas lejes së ndërtimit, Vendim nr. 135, datë 27.08.2004, të Këshillit të Zhvillimit të Turizmit. Kalim e personit të stimuluar nga pala e parë, tek pala e dytë. Në këmbim të tyre porositësi përfiton sipërfaqe banimi në masën 25 %, nga i gjithë ndërtimi.

18.26 Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.06.2009, me palë deklaruese B. S., i cili deklaron se është investitor në objektin e ndodhur në Golem, Kavajë, se bashku me shoqërinë **** shpk. Deklaron se kanë ndarë investimin në masën 75 % shoqëria **** shpk dhe 25 % B. S..

18.27 Kthim përgjigje nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit, datë 19.02.2020, drejtuar Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, në lidhje me dokumentacionin për Vendimin nr. 135, datë 27.08.2004, me palë shoqëria **** shpk dhe B. S., me objekt të ndodhur në Golem Kavajë.

19. Në lidhje **me bodrumin në këtë objekt**, referuar dokumentacionit, vihet re se ka mospërputhje midis lejes së ndërtimit formularit A4 dhe planimetrive të miratuara po nga KRT e Kavajës. Subjekti ka sqaruar se *“në leje nuk deklarohet ndërtesë + bodrum, ndërsa në planimetrinë e miratuar po nga KRT, është parashikuar ndërtesë + bodrum (garazhe). Firma e ndërtimit ka realizuar ndërtimin sipas këtij dokumenti. Për shkak të kësaj mospërputhjeje, zyra e kadastrës në atë kohë, nuk pranoi të kryente regjistrimin.”*

20. Me këtë fakt, pra, që bodrumi nuk ishte hipotekuar, subjekti ka deklaruar se është njohur në vitin 2017, kur kanë bërë aktet e kalimit të pronësisë nga pjesa takuese nga B. S. tek subjekti. Siç duket qartë në të gjithë pjesën tjetër të dokumentacionit të miratuar, që janë Vendimi i Këshillit të Zhvillimit të Territorit në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit nr.135, datë 27.08.2004, Urdhri nr. 325, dt. 06.09.2004, i Ministrit Rregullimit të Territorit, objektet parashikohen me kat nëntokë, bodrum.

21. Në lidhje me **vlerën e apartamentit me sipërfaqe 49 m², me numër pasurie ***-20,**

shitur në vlerën 138.000 euro, në proces verbalin e datës 20.10.2023, sikurse dhe gjatë korrespondencës me e-mail me relatoren e çështjes, subjekti sqaron se ky apartament është shitur në këtë vlerë, pasi është papafingo (nënçati), në katin e fundit të objektit, duke pasur një verandë të madhe rreth 172 m², me pamje tërësisht nga deti. Kjo ka qenë arsyeja e shitjes së këtij apartamenti në këtë vlerë.

22. Trupa e Vlerësimit, pasi mori kreu verifikimet dhe kontrollin e dokumentacionit të përcjellë, si dhe korrespondencën me subjektin e vlerësimit, konstaton se:

- ✓ Të ardhurat e subjektit nga paga, shpërblime, dieta, veshje, për periudhën Korrik 2000 - Mars 2023, rezultojnë në vlerën totale rreth 19.687.000 lekë.
- ✓ Të ardhura nga taksa e solidaritetit. referuar sqarimeve të subjektit, llogariten në vlerën totale rreth 378.000 lekë, për periudhën Korrik 2000 - Dhjetor 2003, për të cilat nuk disponon dokumentacion justifikues përkatës.
- ✓ Të ardhura nga shitje pasurive të paluajtshme, si më poshtë:
 - a. Të ardhura neto nga shitja e pasurisë me nr. ***+1-1, me sipërfaqe 61 m². në vlerën totale 42.700 euro, nga të cilat subjekti ka përfituar ½ pjesë, vlerën 21.350 euro e ndarë: 5.000 euro në Tetor 2008; 5.000 euro në Prill 2009 dhe vlera 11.350 euro në Janar 2012.
 - b. Të ardhura neto nga shitja e pasurisë me nr. ***+1-7. me sipërfaqe 61 m²: në vlerën totale 42.700 euro; nga të cilat subjekti ka përfituar 1/2 pjesë, vlerën 21.350 euro e ndarë: 5.000 euro në Tetor 2008, 5.000 euro në Prill 2009 dhe vlera 11.350 euro në Janar 2012. Të ardhura neto nga shitja e pasurisë me nr. ***+1-13, me sipërfaqe 61 m², në vlerën totale 45.000 euro, nga të cilat subjekti ka përfituar 1/2 pjesë, vlerën 22.500 euro, përfituar në Nëntor 2011.
 - c. Të ardhura neto nga shitja e pasurisë me nr. ***+1-5. me sipërfaqe 58 m², në vlerën rreth 1.382.000 lekë. Pasuri e blerë në vitin 2004 në vlerën 2.000.000 lekë dhe shitur në vitin 2011 në vlerën 3.382.166 lekë.
 - d. Të ardhura neto nga shitja e 7 (shtatë) pasurive, sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.03.2022, në vlerën totale 796.000 euro, përfituar në muajin Gusht 2022, me transaksion bankar.
 - e. Të ardhura nga shitja e dy apartamenteve me nr. pasurie ***+1-11 dhe ***+m2, tek B. S., në vlerën 50.000 euro nga të cilat paguar 15.000 euro në dorë për periudhën Tetor 2017 — Mars 2018 dhe ka detyrim 35.000 euro. (Sipas sqarimeve të subjektit dhe deklaratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 04.09.2019 nga B. S.).
 - f. Të ardhurat nga shitja e pasurive të paluajtshme, të përfituara në bazë të marrëveshjeve me shtetasin B. S., në objektin e ndërtuar në Qerret, Kavajë. janë në shumën totale 876.200 Euro, nga të cilat 796.000 Euro nga shitja e 7 pasurive, në vitin 2022, shuma 65.200 Euro nga shitja e 3 pasurive në periudhën 2008 - 2012 (1/2 pjesë takuese), si dhe 15.000 Euro nga likuidimi pjesor për shitjen e 2 pasurive në periudhën 2017—2018.
- ✓ Nga totali prej 876.200 Euro, rezulton se 796.000 Euro janë të ardhura nga pasuritë e përfituara me kontratë dhurimi dhe shitur me transaksion bankar. Pjesa tjetër është

përfitur nga kalimi i shumës totale prej 80.200 Euro cash nga shitja të tre pasurive nga B. S. (pjesa takuese), sipas aktmarrëveshjeve.

- ✓ Gjithashtu, për pasuritë e përfituara sipas aktmarrëveshjes së sipërcituar, subjekti ka sqaruar se shtetasi B. S. i ka detyrim vlerën 35.000 euro për shitjen e dy apartamenteve në Qerret. Kavajë. në vlerën totale 50.000 Euro. për të cilat ka marrë vetëm 15.000 Euro. (Subjekti ka deklaruar shumën e marrë nga vlera totale që duhej të merrte nga shitja e dy apartamenteve dhe jo detyrimin e mbetur për t'u marrë nga ai).
- ✓ Të ardhurat e deklaruara nga kontrata të cilat rrjedhin nga ekzekutimi i aktmarrëveshjeve nr. ***/*** dhe nr. ***/***, datë 19.12.2005 dhe kontratës së sipërmarrjes nr. ***/***, datë 19.12.2005, janë trajtuar më tej edhe tek të dhënat konfidenciale.
- ✓ Të ardhura neto nga pasuria (parafabrikat) me nr. ***+1-5. me sipërfaqe 58 m². Në vlerën rreth 1.382.000 lekë (Blerë 2.000.000 lekë në vitin 2004, shitur në vlerën 3.382.166 lekë në vitin 2011).

SHPENZIMET E DEKLARUESHME

I. Shpenzime të vitit të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur — Periudha 01.01.2022 - 31.12.2022.

23. Subjekti ka deklaruar si vijon:

- i. Shpenzime telefonie viti i fundit (unë, bashkëshortja dhe fëmijët) 24.000 lekë.
- ii. Shpenzime interneti 18.000 lekë.
- iii. Shpenzime energji elektrike viti 2022 bashkëlidhur përmbledhjen e OSHE, shuma 57.318 lekë.

23.1 FSHU, me shkresën nr. *** prot., datë 18.05.2023, konfirmon në emër të Altin Curri, një abonent në instancën Kavajë, Lagjia nr. 2. Bashkëlidhur tabela e pagesave të kryera për periudhën Nëntor 2021 — Nëntor 2022, të cilat janë në vlerën totale 64.714 lekë.

23.2 Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës sha., me shkresën nr. *** prot., datë 19.05.2023, konfirmon se në emër të Altin Curri, figuron një kontratë, në adresën Okshtun, Rrogozhinë. Pagesat e kryera për periudhën Janar — Dhjetor 2022, janë në vlerën 1.440 lekë.

23.3 Vodafone Albania sha, me shkresën nr. **, ka bashkëlidhur CD, ku konfirmon në emër të Altin Curri, numrin 355*** (Institucioni Drejtoria e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm). Pagesa për vitin 2022 rezulton në vlerën totale 6.000 lekë.

23.4 One Albania sha, me shkresën nr. *** prot., datë 21.07.2023, konfirmon në emër të Altin curri, numrat 35*****0, 355***5 dhe fiks ****. Totali i pagesave për periudhën 01.01.2022 — 31.12.2022, është në vlerën 23.460 lekë. Hatije Daiu rezulton me numrin 355*****. Totali i pagesave për periudhën 01.01.2022 — 31.12.2022, është në vlerën 4.600 lekë.

23.5 Me e-mailin e datës 17.07.2023, subjekti ka dërguar sqarimet me shkrim, në lidhje me dokumentacionin për librezat e dritave dhe ujit, sipas deklarimit të bërë. Në lidhje me librezën e dritave sqaron se nuk ka detyrime, ndërsa për ujin, që në vitin 2015 kur ka filluar të ndërtojë shtëpinë në Kavajë, ka hapur pus dhe atë përdor dhe aktualisht.

✓ **Shpenzimet e deklaruarra për ujë, drita, telefon, internet, gjatë periudhës së sipërcituar. me kontrata në emër të subjektit dhe bashkëshortes, rezultojnë në total rreth 100.000 lekë.**

II. Shpenzime për udhëtimet private, personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 viteve të fundit (kalendarike), duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përballuara. Periudha 01.01.2020 — 31.12.2022.

24. Udhëtim familjar 3 ditore në Stamboll shtator 2022, shuma 1.500 euro.

24.1 Me e-mailin e datës 17.07.2023, subjekti ka dërguar sqarimet me shkrim në lidhje me udhëtimin familjar 3 ditore në Stamboll dhe sqaron se në lidhje me vlerën prej 1.500 euro, nuk ka ruajtur ndonjë dokumentacion, por mban mend që këtë udhëtim e kanë kryer me kompaninë Zenith Travel.

24.2 Me e-mailin e datës 27.09.2023, subjekti ka bashkëlidhur dokumentacion justifikues, si dhe sqarime me shkrim, ku sqaron se ka një udhëtim në Athinë, me Titullarin e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore për nevoja pune dhe funksioni në Agjencinë homologe në Athinë. Ndërsa udhëtimet ditore në Maqedoni dhe Kosovë nuk i ka përmendur në formular, sepse i ka konsideruar të parëndësishme, por vë në dispozicion printimin e sistemit TIMS në të cilin ka akses, për të pasur të qartë lëvizjet e tij.

24.3 Subjekti ka bashkëlidhur:

- a. Printimin nga Sistemi Tims, për të dhënat mbi hyrjet dhe daljet nga territori shqiptar, për periudhën 01.01.2020-31.12.2022, për shtetasit: Altin Curri, Hatije Daiu, Ajla Curri, Erua Curri dhe Sirina Curri.
- b. Urdhër nr. *** prot., datë 20.10.2021, nga SHÇBA (AMP), për dërgim me shërbim jashtë vendit, ku Drejtori i Përgjithshëm ka urdhëruar dërgimin me shërbim jashtë vendit, për të marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga ana e Xhandarmërisë Turke, në fushën e përdorimit të teknologjisë nga strukturat e inteligjencës. Grupi i parë, data e nisjes 01.11.2021 dhe kthimi 12.11.2021, ku do të marrin pjesë punonjësit (ndër të tjerë evidentohet edhe subjekti Altin Curri).

24.4 Me e-mailin e datës 28.09.2023, subjekti ka dërguar sqarimet me shkrim në lidhje me udhëtimet, sipas konfirmimit të TIMS dhe sqaron se për sa i përket udhëtimeve ditore, nuk i ka përmendur sepse ka kuptuar që qëllimi ka qenë për udhëtimet për pushime që relativisht zgjasin të paktën disa ditë. Nuk i ka konsideruar të tilla daljet 1 ditore me familjen.

25. Në lidhje me të dhënat e sistemit TIMS që konfirmon dalje në datë 25.12.2022, nga pika kufitare Qafë Thanë, me familjen, bashkëshorten dhe 3 vajzat, sqaron se kanë fjetur atë natë në Shkup dhe të nesërmen janë kthyer nga pika kufitare Morinë, në datë 26.12.2022, duke ndjekur aksin rrugor Shkup - Prizren. Shpenzimet në tërësi për këtë qëndrim 1 ditë kanë qenë rreth 250 euro, ku përfshihen; fjetje dhe ushqim. Nuk ka ruajtur fatura. Udhëtimet e tjera në Kosovë kanë qenë ditore, pra ka shkuar dhe është kthyer brenda ditës, udhëtime këto për shkak të funksionit e për nevoja pune, por dhe për një drekë me familjen në Prizren.

26. Në lidhje me udhëtimin në Stamboll, në datë 01.11.2021 dhe kthim në datë 12.11.2021, bëhet fjalë për një trajnim në Ankara —Turqi, me shpenzime të institucionit.

27. Përsa i përket datave 15.05.2022 dhe 12.09.2020, ku ka udhëtuar me familjen deri në Prizren, nëpërmjet pikës kufitare Morinë, hyrje — dalje brenda ditës, kanë dorëzuar dokumentet e mjetit dhe identifikimit në sportel duke ndjekur procedurën, si në hyrje ashtu dhe në dalje. Regjistrimi ose jo është veprim i punonjësit në sportelin e pikës kufitare, si nga pala kosovare ashtu dhe ajo shqiptare. Nga informacioni që ka për shkak të funksionit, në rastet e fluksit në pikën kufitare Morinë, mjetet/personat kalojnë vetëm me kontrollin fizik të dokumentacionit pa bërë regjistrim në sistem dhe pa vulë tashmë, sepse kjo do ti vononte shumë qytetarët. Kjo e përcaktuar dhe në ligjin nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar”, në nenin 17 “Lehtësimi i verifikimeve kufitare”, pika 5.

28. Në lidhje me udhëtimin bërë gjatë periudhës 14.12.2018 - 23.12.2018, me e-mailin e datës 10.04.2024, subjekti sqaroi se ka udhëtuar “...në Arabinë Saudite, me bashkëshorten Hatije Daiu, me qëllim kryerjen e një riti fetar “UMRA”, vizitë në vendet e shenjta Mekë dhe Medine. Nuk ka pasur shpenzime pasi ky udhëtim është mbuluar nga shtetasi E.Rr., i cili gjithashtu ishte me ta dhe me bashkëshorten e tij.

- ✓ **Subjekti ka dhënë sqarime në lidhje me udhëtimet e konstatuara nga sistemi TIMS për të dhe familjarët e tij.**
- ✓ **Shpenzimet për udhëtimet private, personale dhe të personave të lidhur gjatë periudhës së sipërcituar janë deklaruar në total rreth 1.750 euro.**

III. Shpenzime për arsimin e fëmijëve, madhorë apo të mitur, apo të personave të lidhur, duke deklaruar fillimin, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vjetore, si dhe kohëzgjatje e studimeve, sipas periudhës së përcaktuar në nenin 32, të Ligjit të vlerësimit - Periudha nga data e fillimit të punës në institucionin e Policisë së Shtetit. Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë.

29. Shpenzime në arsimin privat për vajzën Ajla Curri, nga viti 2011 deri 2013, në shkollën jopublike “Dituria” Kavajë. Shkolla është mbyllur dhe nuk ka siguruar dot dokumentacion. Shuma 126.000 lekë.

29.1 Shpenzime në arsimin privat për vajzën Ajla Curri, viti shkollor 2013 — 2014, në shkollën jo-publike “Visare” Kavajë, vërtetim nr. 07, datë 17.04.2018, shuma 45.000 lekë.

29.2 Shpenzime në arsimin privat për vajzën Ajla Curri, nga viti 2014 deri 2018, në shkollën jopublike “Hafiz Ali Podgorica”, vërtetim datë 13.04.2018, më pas kaloi në arsim publik, shuma 180.000 lekë.

29.3 Shpenzime në arsimin privat për vajzën Erua Curri, nga viti 2015 deri 2018, në shkollën jopublike “Hafiz Ali Podgorica”, vërtetimi datë 13.04.2018 (bëri dhe një vit në këtë shkollë më pas kaloi në arsim shtetëror), shuma 180.000 lekë.

29.4 Shpenzime arsimit privat Altin Curri, nga viti 2007 deri në vitin 2010, në Fakultetin e Drejtësisë “Kristal”, mandatat e pagesës numër 4730, datë 01.12.2007, numër 687, datë 30.01.2009 dhe numër 3071, datë 06.06.2010, shuma 4.500 euro.

29.5 Bashkëlidhur deklaratës:

- a. Mandat arkëtimi nga Universiteti Kristal, muaji Qershor 2010, ku konstatohet arkëtimi i shumës 1.500 euro, nga Altin Curri.
- b. Mandat arkëtimi nga Universiteti Kristal, datë 30.01.2009, ku konstatohet arkëtimi i shumës 1.500 euro, nga Altin Curri.
- c. Mandat arkëtimi nga Universiteti Kristal, datë 01.12.2007, ku konstatohet arkëtimi i shumës 1.500 euro, nga Altin Curri.
- d. Vërtetim nga Shkolla 9 vjeçare “Hafiz Ali Podgorica”, datë 13.04.2018, ku vërteton se Ajla Curri, për periudhën 2014 — 2018, ka kryer pagesa vjetore në masën 45.000 lekë, dhe në total 180.000 lekë.
- e. Vërtetim nga Shkolla 9 vjeçare “Visare”, Kavajë, datë 17.04.2018, që vërteton se Ajla Curri, për vitin shkollor 2013 — 2014, ka depozituar shumën 45.000 lekë, nga i ati Altin Curri.
- f. Vërtetim nga Shkolla 9 vjeçare “Hafiz Ali Podgorica”, datë 13.04.2018, që vërteton se Erua Curri, për periudhën 2015 - 2018, ka kryer pagesa vjetore në masën 45.000 lekë dhe në total 135.000 lekë.
- g. Tabelë pagesash të kryera nga Altin Curri, për periudhën Janar 2022 — Janar 2023, në vlerën totale 60.929 lekë.

26.6 Me e-mailin e datës 18.07.2023, subjekti ka sqaruar, se pasi është interesuar nuk mund të sigurojë dot dokumentacion për shkollën e vajzës tek “Dituria”, pasi kjo shkollë ka falimentuar. Shuma që ka paguar ka qenë rreth 7.000 lekë në muaj.

✓ **Shpenzimet e deklaruara për arsimimin e subjektit dhe fëmijëve gjatë periudhës deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë, rezultojnë në total rreth 531.000 lekë + 4.500 euro konvertuar rreth 1.044.000 lekë.**

30. Në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, subjekti ka deklaruar:

*Në lidhje me kontratën e shitjes së pasurive të paluajtshme me rezervë, nr. rep ***, nr. kol. ***, datë 22.03.2022, sqaroj si më poshtë:*

Janë shitur nga ana ime pasuritë e mëposhtme:

1. *Njësi shërbimi me sipërfaqe 150 m², Qerret Kavajë, me nr. pasurie ****+1 -N1, zk. 3101.*
2. *Apartament me sipërfaqe 55 m², Qerret Kavajë, me nr. pasurie ****+1-14, zk. 3101.*
3. *Apartament me sipërfaqe 49 m², Qerret Kavajë, me nr. pasurie ****+1-15, zk. 3101.*
4. *Apartament me sipërfaqe 53 m², Qerret Kavajë, me nr. pasurie ****+1-16, zk. 3101.*
5. *Apartament me sipërfaqe 50 m², Qerret Kavajë, me nr. pasurie ****+1-17, zk. 3101.*
6. *Apartament me sipërfaqe 51 m², Qerret Kavajë, me nr. pasurie ****+1-18, zk. 3101.*
7. *Apartament me sipërfaqe 49 m², Qerret Kavajë, me nr. pasurie ****+1-20, zk. 3101*

*Pasuritë e paluajtshme të përmendura më lart, kanë si burim ligjin nr. 7665, datë 21.01.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin” dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 789, datë 26.11.2003 “Për funksionimin dhe organizimin e brendshëm të Këshillit të Zhvillimit të Turizmit”, konkretisht unë dhe shtetasi B. S., kemi aplikuar në Ministrinë e Turizmit për të marrë titullin “person i stimuluar” sipas këtij ligji. Aplikimin e ka bërë z. B. S. i autorizuar dhe në emrin tim, për të ndjekur dhe procedurat në vazhdim. Me Vendimin e Këshillit të Zhvillimit të Turizmit, nr. 135, datë 27.08.2004 dhe Urdhrin nr. 325, datë 06.09.2004, u miratua titulli “person i stimuluar” për **** shpk dhe B. S.. Në vijim subjekti **** shpk, tërhiqet nga ky investim duke u zëvendësuar me subjektin **** shpk, ky fakt u formalizua me akt marrëveshjen nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.12.2005. Gjithashtu u formalizua dhe pjesa takuese mes meje Altin Currit dhe B. S., me akt marrëveshjen me deklarim noterial, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.12.2005. Subjekti **** shpk vijoi me ndërtimin e apartamenteve. Në fazën kur apartamentet ishin në ndërtim e sipër, janë kryer dhe shitjet e 3 apartamenteve që ishin pjesë takuese e jona, dokumentuar përkatësisht me kontratën e porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 02.03.2009, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 02.03.2009, nr. *** rep., nr. ** kol., datë 20.02.2011. Nga këto shitje Altin Curri ka përfutur 50% të shumës. Në vitin 2017, konkretisht me aktet noteriale, kontrata dhurimi (gjithsej 7) duke bërë ndarjen në terren të pjesës takuese, formalizimi i kësaj ndarje u krye me dhurim për të formalizuar këtë marrëveshje të vitit 2004.*

Aktet noteriale kontrata dhurimi (gjithsej 7), janë si më poshtë:

1. *Me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.04.2017.*
2. *Me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.04.2017.*
3. *Kontratë dhurimi me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.04.2017.*
4. *Me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.04.2017.*
5. *Me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.04.2017.*
6. *Me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.04.2017.*
7. *Kontratë dhurimi me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.04.2017.*

*Gjithashtu për 2 apartamente që ishin pjesë takuese e imja, unë vendosa që në këmbim të shumë prej 50.000 euro, t'ja shes B.S.. Kjo marrëveshje është dokumentuar me akt marrëveshjen nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.04.2018.*

30.1 Subjekti ka bashkëlidhur deklaratës:

- a. Vendim i Këshillit të Zhvillimit të Turizmit, nr. 135, datë 27.08.2004, Urdhër nr. 325, datë 06.09.2004.
- b. Akt marrëveshje me deklaram noterial me nr. 4584 rep., nr. 997 kol., datë 19.12.2005.
- c. Akt marrëveshje me deklaram noterial me nr. 4586 rep., nr. 999 kol., datë 19.12.2005.
- d. Aktet noteriale kontrata dhurimi, gjithsej 7 (shtatë), të datës 29.04.2017.
- e. Akt marrëveshje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.04.2018.

HETIMI ADMINSTRATIV

30.2 Kontrata e shitjes së pasurive të paluajtshme me rezervë, nr. rep. ***, nr. kol. ***, datë 22.03.2022, është trajtuar pjesërisht edhe më sipër në rubrikën e të ardhurave të subjektit të vlerësimit.

30.3 **ASHK, Drejtoria Vendore e Zonave të Stimuluara**, me shkresën nr. *** prot., datë 19.06.2023, konfirmon shtetasin Altin Curri, si vetë deklarues nëpërmjet vetë deklaramit nr. *** prot., datë 08.10.2010. Bashkëlidhur dokumentacioni si më poshtë:

30.4 Kërkesë për kalimin e të drejtës së pronësisë mbi truallin e njësisë së ndërtuar, datë 08.10.2010, person i stimuluar B. S. dhe **** shpk, strukturë turistike në pas. 45/1, sipërfaqja e përgjithshme e njësisë së ndërtuar 8.625 m².

30.5 Vendim i ASHK, Drejtoria Vendore e Zonave të Stimuluara nr. 709, datë 09.05.2022, për miratimin e kalimit të pronësisë mbi truallin funksional / të lirë brenda zonës së stimuluar. Në bazë të nenit 49, të ligjit nr. 20/2020 dhe në zbatim të VKM, nr. 1189, datë 24.12.2020, u mor në shqyrtim kërkesa nr. 1225, datë 08.10.2010, e personit të stimuluar **** & B. S., me subjekt të interesuar Altin Curri, për kalimin në pronësi të njësisë ndërtimore / truallin e lirë brenda zonës së stimuluar **** & B. S.. Referuar planit të rilevimit, hartuar nga ASHK, Drejtoria Vendore e Zonave të Stimuluara, në datë 10.02.2022, për zonën e stimuluar “**** & B. S.”, dhe statusit juridik përcjellë me shkresën nr. 462, datë 28.01.2022, nga Drejtoria Vendore e ASHK Kavajë, njësia e ndërtuar rezulton e regjistruar. Për këtë praktike administrohet kartelë e pasurisë, lëshuar më datë 23.12.2021, zk. ***, numër ****+1-15, vol. **, fq. **, me adresë në Qerret, Kavajë, lloji i pasurisë apartament, në pronësi të Altin Curri. Subjekti ka shlyer detyrimin financiar për kalimin e pronësisë, për sipërfaqen e truallit funksional takues 29.01 m². Në përfundim është vendosur kalimi i pronësisë mbi pasurinë truall funksional takues me numër 14/85, në zonën e stimuluar **** & B. S., zk. ***, me sipërfaqe

takuese sipas genplanit 29.01 m² dhe vlerë 66.839 lekë, shlyer nga subjekti i interesuar. Bashkëlidhur praktika.

30.6 Planimetri apartamenti (AP. 15), me pronar Altin Curri, me sipërfaqe totale 54 m², në objektin me sipërfaqe totale 2.978 m², nga ASHK, Drejtoria Vendore, Zonat e Stimuluara. Bashkëlidhur praktika.

30.7 Vendim i ASHK, Drejtoria Vendore e Zonave të Stimuluara nr. 714, datë 09.05.2022, për miratimin e kalimit të pronësisë mbi truallin funksional / të lirë brenda zonës së stimuluar. Për këtë praktikë administrohet kartelë e pasurisë, lëshuar më datë 23.12.2021, zk. ****, numër ***+1-20, vol. **, fq. **, me adresë në Qerret, Kavajë, lloji i pasurisë apartament, në pronësi të Altin Curri. Subjekti ka shlyer detyrimin financiar për kalimin e pronësisë, për sipërfaqen e truallit funksional takues 31.70 m². Në përfundim është vendosur kalimi i pronësisë mbi pasurinë truall funksional takues me numër *** në zonën e stimuluar **** & B. S., zk. ***, me sipërfaqe takuese sipas genplanit 31.70 m² dhe vlerë 73.037 lekë, shlyer nga subjekti i interesuar. Bashkëlidhur praktika.

30.8 Planimetri apartamenti (AP. 20), me pronar Altin Curri, me sipërfaqe totale 59 m², në objektin me sipërfaqe totale 2.978 m², nga ASHK, Drejtoria Vendore, Zonat e Stimuluara. Bashkëlidhur praktika.

30.9 Vendim i ASHK, Drejtoria Vendore e Zonave të Stimuluara nr. 711, datë 09.05.2022, për miratimin e kalimit të pronësisë mbi truallin funksional / të lirë brenda zonës së stimuluar. Për këtë praktikë administrohet kartelë e pasurisë, lëshuar më datë 23.12.2021, zk. ***, numër ***+1-17, vol. ***, fq. **, me adresë në Qerret, Kavajë, lloji i pasurisë apartament, në pronësi të Altin Curri. Subjekti ka shlyer detyrimin financiar për kalimin e pronësisë për sipërfaqen e truallit funksional takues 29.55 m². Në përfundim është vendosur kalimi i pronësisë mbi pasurinë truall funksional takues me numër 14/85, në zonën e stimuluar **** & B. S., zk. 3101, me sipërfaqe takuese sipas genplanit 29.55 m² dhe vlerë 68.083 lekë, shlyer nga subjekti i interesuar. Bashkëlidhur praktika.

30.10 Planimetri apartamenti (AP. 17), me pronar Altin Curri, me sipërfaqe totale 55 m², në objektin me sipërfaqe totale 2.978 m², nga ASHK, Drejtoria Vendore, Zonat e Stimuluara. Bashkëlidhur praktika.

30.11 Vendim i ASHK, Drejtoria Vendore e Zonave të Stimuluara nr. 712, datë 09.05.2022, për miratimin e kalimit të pronësisë mbi truallin funksional/ të lirë brenda zonës së stimuluar. Për këtë praktike administrohet kartelë e pasurisë, lëshuar më datë 23.12.2021, zk 3101, numër ***+1-18, vol. 24, fq. 11, me adresë në Qerret, Kavajë, lloji i pasurisë apartament, në pronësi të Altin Curri. Subjekti ka shlyer detyrimin financiar për kalimin e pronësisë, për sipërfaqen e truallit funksional takues 29.55 m². Në përfundim është vendosur kalimi i pronësisë mbi pasurinë truall funksional takues me numër 14/85, në zonën e stimuluar **** & B. S., zk. 3101, me sipërfaqe takuese sipas genplanit 29.55 m² dhe vlerë 68.083 lekë, shlyer nga subjekti i interesuar. Bashkëlidhur praktika.

30.12 Planimetri apartamenti (AP. 18), me pronar Altin Curri, me sipërfaqe totale 55 m², në objektin me sipërfaqe totale 2.978 m², nga ASHK, Drejtoria Vendore, Zonat e Stimuluara. Bashkëlidhur praktika.

30.13 Vendim i ASHK, Drejtoria Vendore e Zonave të Stimuluara nr. 694, datë 09.05.2022, për miratimin e kalimit të pronësisë mbi truallin funksional / të lirë brenda zonës së stimuluar. Për këtë praktikë administrohet kartelë e pasurisë, lëshuar më datë 23.12.2021, zk. 3101, numër ****+1-N1, vol. **, fq. ***, me adresë në Qerret, Kavajë, lloji i pasurisë njësi, në pronësi të Altin Curri. Subjekti ka shlyer detyrimin financiar për kalimin e pronësisë, për sipërfaqen e truallit funksional takues 90.26 m². Në përfundim është vendosur kalimi i pronësisë mbi pasurinë truall funksional takues me numër ***, në zonën e stimuluar **** & B. S., zk. ***, me sipërfaqe takuese sipas genplanit 90.26 m² dhe vlerë 207.959 lekë, shlyer nga subjekti i interesuar. Bashkëlidhur praktika.

30.14 Planimetri shërbimi (N1), me pronar Altin Curri, me sipërfaqe totale 168 m², në objektin me sipërfaqe totale 2.978 m², nga ASHK, Drejtoria Vendore, Zonat e Stimuluara. Bashkëlidhur praktika.

30.15 Vendim i ASHK, Drejtoria Vendore e Zonave të Stimuluara nr. 710, datë 09.05.2022, për miratimin e kalimit të pronësisë mbi truallin funksional / të lirë brenda zonës së stimuluar. Për këtë praktikë administrohet kartelë e pasurisë, lëshuar më datë 23.12.2021, zk. ***, numër ****+1-16, vol. **, fq. **, me adresë në Qerret, Kavajë, lloji i pasurisë apartament, në pronësi të Altin Curri. Subjekti ka shlyer detyrimin financiar për kalimin e pronësisë, për sipërfaqen e truallit funksional takues 31.70 m². Në përfundim është vendosur kalimi i pronësisë mbi pasurinë truall funksional takues me numër ***, në zonën e stimuluar **** & B. S., zk. 3101, me sipërfaqe takuese sipas genplanit 31.07 m² dhe vlerë 73.037 lekë, shlyer nga subjekti i interesuar. Bashkëlidhur praktika.

30.16 Planimetri apartamenti (AP. 16), me pronar Altin Curri, me sipërfaqe totale 59 m², në objektin me sipërfaqe totale 2.978 m², nga ASHK, Drejtoria Vendore, Zonat e Stimuluara. Bashkëlidhur praktika.

30.17 Vendim i ASHK, Drejtoria Vendore e Zonave të Stimuluara nr. 708, datë 09.05.2022, për miratimin e kalimit të pronësisë mbi truallin funksional / të lirë brenda zonës së stimuluar. Për këtë praktikë administrohet kartelë e pasurisë, lëshuar më datë 23.12.2021, zk. ***, numër ****+1-14, vol. **, fq. **, me adresë në Qerret, Kavajë, lloji i pasurisë apartament, në pronësi të Altin Curri. Subjekti ka shlyer detyrimin financiar për kalimin e pronësisë, për sipërfaqen e truallit funksional takues 32.77 m². Në përfundim është vendosur kalimi i pronësisë mbi pasurinë truall funksional takues me numër ***, në zonën e stimuluar **** & B. S., zk. ***, me sipërfaqe takuese sipas genplanit 32.77 m² dhe vlerë 75.502 lekë, shlyer nga subjekti i interesuar. Bashkëlidhur praktika.

30.18 Planimetri apartamenti (AP. 14), me pronar Altin Curri, me sipërfaqe totale 61 m², në objektin me sipërfaqe totale 2.978 m², nga ASHK, Drejtoria Vendore, Zonat e Stimuluara. Bashkëlidhur praktika.

30.19 Me inventarin e datës 12.07.2023 subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues, si dhe sqarime me shkrim, ku sqaron se në vitet 1992 - 1993, prindërit e tij dhe të shokut të tij B. S., në sezonin veror, u vendosën në Qerret në një zonë të pa banuar, aty ku sot ndodhet kompleksi turistik. Këtu kanë ndenjur për çdo sezon veror deri në vitin 2004. Kjo praktikë, atë kohë ndiqej nga shumë familje Kavajase përgjatë gjithë vijës bregdetare Qerret-Mali i Robit-Golem. Në këtë kohë firma ndërtuese dhe investuese “***** shpk” paraqiti interes për të ndërtuar një fshat turistik, por më parë bëri një marrëveshje verbale me ta, që të largoheshin nga ata dhe ai të vijonte me marrjen e lejes dhe ndërtimin. Duke u konsultuar me një studio avokatie, u gjet zgjidhje ligjore e pranueshme nga të dy palët, referuar praktikave që aplikonte shoqëria ***** në raste të tjera të ngjashme, konkretisht, të paraqiteshin pranë Ministrisë së Turizmit si bashkë-investitor me kompaninë *****, në raportet 2526 me 75 %, nga të cilat 25 % do ishte midis subjektit dhe z. B. S.. Në këtë rast kontributi i tyre do të ishte “të hiqnin rrethimin me rrjetë teli dhe çadrat dhe të largoheshin nga zona ku do bëhej ndërtimi. Sqaron se nuk kanë derdhur asnjë shumë financiare në këtë proces, përveç disa detyrimeve simbolike në përgatitjen e dokumentacionit fillestar, si vërtetime, plan rievimi etj. Subjekti dhe B. S., ranë dakord që procedurat e aplikimit do t’i kryente B. S. dhe pasi të merrej statusi “person i stimuluar”, do të formalizonin marrëveshjen me akt noterial, siç dhe e kanë kryer më pas. Në vijim, u bë e mundur marrja e lejes së zhvillimit për ndërtimin e fshatit turistik, me Vendim të Këshillit të Zhvillimit të Territorit në Ministrinë e Rregullimit të Turizmit, nr. 135, datë 27.08.2004, miratuar “person të stimuluar” B. S. dhe shoqërinë ***** shpk, si shoqëri ndërtuese, shpallur me Urdhrin nr. 325, datë 06.09.2004, të Ministrit të Rregullimit të Territorit. Të gjitha pagesat deri në këtë kohë janë paguar nga firma “*****”. Më pas firma “*****”, pasi doli leja, nuk filloi punë për zbatimin e lejes, u tërhoq nga investimi, pasi nuk e shikonte me interes ndërtimin, sipas saj, për shkak rrezikut të lartë të erozionit (deti kishte përparuar dhe merrte tokë në mënyrë të vazhdueshme). Me mirëkuptim u ra dakord që për të gjithë shumën e investimeve që kishte bërë, duke përfshirë tarifën e lejes, shpenzimet për hartimin e projektit, “*****” shpk, nuk ka kërkuar kundër shpërblim. Gjithashtu i dha të drejtën, që të gjenin një investitor tjetër. Sipas kësaj marrëveshje, është nënshkruar aktmarrëveshja nr. ***/***, datë 19.12.2005, në bazë të së cilës është larguar “*****” shpk dhe është deklaruar shoqëria “*****” shpk, shoqëri e cila ka marrë përsipër të investojë 75 % të investimit, për ndërtimin e fshatit turistik; ndërsa subjekti dhe B. S. do mbeteshin sërish me 25%. Shuma e investimit që detyroheshin këta si palë është specifikuar në këtë kontratë, që do të quheshin të shlyera me pagesat që ishin bërë nga “*****” më parë dhe ku përfshiheshin “taksat për të fituar titullin person i stimuluar, studimet urbane, taksa për marrjen e lejes zhvillimit, pagesën e projekt-idesë dhe projekt zbatimin, etj. Subjekti sqaron se nuk është i deklaruar në leje si z. B. S., sepse ranë dakord në fillim që B.S. do merrej me procedurat, pasi ai nuk kishte kohen në dispozicion dhe këtë më pas, e legalizuan me deklaratën noteriale. Mbi bazën e këtyre dokumenteve, është bërë e mundur të merret leja e zhvillimit. Në këtë periudhë, ligji për stimulimin e fshatrave turistike u shfuqizua. Në vazhdim, është bërë kontrata e pjesëtimit vullnetar, formalizuar me deklaratën noteriale nr. *** rep., dhe nr. *** kol., duke veçuar 25 % nga 75 %. Meqë ishin

shlyer të gjitha detyrimet tatimore, u realizua procesi i pajisjes me certifikata pronësie. Fakti është që nuk është shmangur asnjë detyrim ndaj shtetit, sistemit të taksave dhe tatimeve, si dhe nuk është kryer asnjë shkelje e ligjit për urbanistikën. Edhe shitjet që janë bërë për llogarinë e tij, nga z. B. S., më parë janë liruar nga taksat. Thekson se e gjithë sipërfaqja, prej 4.960 m², aktualisht vazhdon të jetë pronë shtetërore, përfshi këtu dhe truallin mbi të cilin janë ndërtuar objektet. Sipas detyrimeve që do të dalin nga ligji i ri, banorët e objekteve do të paguajnë për privatizimin e truallit mbi të cilin ndodhet objekti, sipas tarifave që do të përcaktojnë shteti dhe përpjesëtimin mes tyre. Baza ligjore mbi të cilën ata (të përfaqësuar si palë nga B. S.) kanë aplikuar është ligji nr. 7665, datë 21.01.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin” (me ndryshime) dhe VKM nr. 789, datë 26.11.2003 “Për funksionimin dhe organizimin e brendshëm të Këshillit të Zhvillimit të Turizmit”. Nga dokumentacioni aplikimit të B. S. dhe ***** shpk, për shpalljen si person i stimuluar, ka mundur të gjej dokumentet që janë; projekti arkitektonik dhe raport mbi kushtet gjeologo-inxhinierie të sheshit të ndërtimit, porositur këto nga ***** shpk. Praktika e plotë e aplikimit është depozituar në atë kohë në Ministrinë e Turizmit. Në lidhje me dokumentacionin e aplikimit ka mundur të sigurojë përgjigjen e Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit, me nr. Prot. ***, datë 19.02.2020, në të cilin listohen dokumentet të cilat kanë vlerën e ruajtjes.

30.20 Gjithashtu, nëpërmjet email-it të datës 18.04.2025, subjekti ka dhënë sqarime se cilat ishin arsyet që “*****” sh.p.k bëri marrëveshje vetëm me dy persona, duke i pranuar si bashkë investitorë me 0 (zero) kontribut financiar, por duke i dhënë fitime 25% dhe duke marrë në konsideratë faktin se z. Curri dhe z. B. S. ishin në të njëjtat kushte si familjet e tjera Kavajase që shfrytëzonin gjatë sezoneve verore një zonë turistike të pabanuar, (truall shtet), si më poshtë vijon:

*“Kjo praktikë, atë kohë ndiqej nga shumë familje Kavajase përgjatë gjithë vijës bregdetare Qerret- Mali i Robit- Golem”. E gjithë kjo vijë bregdetare ishte truall shtet në atë kohë dhe zhvillimi i saj është bërë në të njëjtën mënyrë si në rastin tonë. Pra shoqëri të ndryshme ndërtuese, kanë ndjekur të njëjtat procedura me personat e tjerë që shfrytëzonin në atë kohë hapësirat për plazh si ne. Nuk e di nëse ***** shpk ka dhe raste të tjera në këtë zonë por ndërtimet në të gjithë këtë zonë janë kryer në këtë mënyrë. Baza ligjore që normon këtë procedurë është “ligji nr. 7665 datë 21.01.1993 “ Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi Turizmin” (me ndryshime) dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 789 datë 26.11.2003 “Për funksionimin dhe organizimin e brendshëm të Këshillit të Zhvillimit të Turizmit”. Interesi që shoqëritë ndërtuese ofronin këtë zgjidhje, mendoj se është fakti që ky ligj i siguron këtyre shoqërive lehtësira të konsiderueshme sidomos në tarifën doganore, në dijeninë time ulje 50% të mallrave/materialeve që shërbenin për zhvillimin e zonës. Qëllimi i ligjit ka qenë pikërisht zhvillimi këtyre zonave që në atë kohë ishin pothuajse moçal dhe me shumë pak vlera.”*

30.21 Në lidhje me arsyen pse shoqëria “*****”, u tërhoq nga investimi kundrejt asnjë kundërshpërblimi dhe kushti, subjekti shpjegoi se, “...shoqëria “*****” nuk ka diskutuar apo kërkuar asnjë kusht apo kundërshpërblim tek ne sepse ajo nuk po tërhoq për shkakun tonë. Të dy shoqëritë “*****” dhe “*****” kanë rënë dakord dhe kanë bërë përllogaritjet me njëra-tjetrën, detaje të cilat nuk i di dhe nuk na kanë interesuar. Për ne nuk kishte asnjë ndryshim kush do të kryente zhvillimin e ndërtimit për sa kohë që kushtet e marrëveshjes nuk ndryshonin.”

30.22 Në lidhje me procedurën e ndjekur në momentin që shoqëria “*****” u tërhoq nga investimi, (do të paguhej dhe qiraja e tokës, pasi personat që ndërtonin fshatrat turistik, stimuloheshin nga shteti duke jua dhënë tokën me qira simbolike për 35 vjet, pagesë të cilën e mori përsipër firma “*****”), nëpërmjet e-mailit të datës 18.04.2024, subjekti i vlerësimit shprehet se në dijeninë e tij, nuk është bërë pagesë për qiranë e tokës, pasi kjo procedurë u pezullua për arsyen se po përgatitej një draft ligj ku parashikohej privatizimi i saj, kënddrejtë tarifave që do të përcaktoheshin. Me sa di ky ligj është miratuar. Në lidhje me dokumentacionin që pasqyron këtë procedurë subjekti ka bërë kërkimet përkatëse dhe ky dokumentacion nuk ruhej në arkiv. Subjekti ka mundur të sigurojë përgjigjen e Arkivit Qendror Teknik i Ndërtimit me Nr. prot. *** datë 19.02.2020, në të cilën listohen dokumentet të cilat kanë vlerën e ruajtjes.

30.23 Bazuar në deklarimin e subjektit, sqarimet dhe dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar, në përfundim të hetimit të kryer rezulton se:

- ✓ Subjekti ka kryer shpenzime për kalimin e pronësisë mbi truallin funksional takues të pasurive të mësipërme në vitin 2022, në vlerën totale rreth 633.000 lekë, sipas përqijies së ASHK, Drejtoria Vendore e Zonave të Stimuluara.
- ✓ Aktmarrëveshja nr. ***/*** dhe kontrata e sipërmarrjes nr. ***/*** të dt. 19.12.2005 ndërmjet shtetasit B. S. dhe shoqërisë “*****” shpk për ndërtimin e objektit në Golem Kavajë, me përfitim të 25% të si ndërtimore si dhe aktmarrëveshja nr. *** e po kësaj date ndërmjet B. S. dhe Altin Curri për ndarjen e këtij raporti me nga 1/2 pjesë takuese, i përkasin periudhës para vitit 2008.
- ✓ Veprimet juridike për kalimin e pronësisë janë kryer me Kontrata Dhurimi.
- ✓ Pasuritë e përfituara nga këto marrëveshje/kontrata dhe/apo të ardhurat e gjeneruara nga shitja e tyre e kanë burimin fillestar në aktet juridike të vitit 2005, rrjedhimisht për to është i aplikueshëm neni 32, pika 1.1 e ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

31. **Kontratë sipërmarrje për prenotim apartamenti 1+1** me sipërfaqe 65.41 m², në rrugën ish Fusha e Aviacionit dhe rruga e Dafinave, Tiranë, si dhe garazh vend parkimi në katin - 2. Për këtë apartament është paguar kësti i parë prej 25.000 euro nëpërmjet bankës Credins. **Vlera:** 70.400 euro.

Burimi i krijimit: shitje e pasurive të paluajtshme me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.03.2022. Kontratë me nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë 07.10.2022.

31.1 Subjekti ka bashkëlidhur deklaratës kontratë sipërmarrje për prenotim apartamenti, nr. *** rep., nr. ** kol., datë 07.10.2022. Bashkëlidhur praktika.

HETIMI ADMINISTRATIV

31.2 Me e-mailin e datës 17.07.2024, subjekti ka dërguar kontratë sipërmarrje për prenotim apartamenti, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 07.10.2022, me palë sipërmarrëse shoqëria “Garffs-Construction” shpk dhe porosites Altin Curri, me Objekt shitjen e një apartamenti dhe një vendparkimi në godinën që do të ndërtohet nga pala sipërmarrëse, me adresë në rrugën “Ish

Fusha e Aviacionit” dhe rruga e “Dafinave”, Tiranë, me sipërfaqe totale 65.41 m², në vlerën 70.400 euro, vlerë e cila do të likuidohet në numrin e llogarisë së shoqërisë. Kësti i parë në vlerën 25.000 euro do të likuidohet me trasnsferte bankare deri në datën 30.10.2022, kësti i dytë në vlerën 25.000 euro deri në datën 30.04.2023 dhe kësti i tretë në vlerën 20.400 euro, deri në datën 30.11.2023.

31.3 ASHK Tiranë - DV Tirana Rurale, DV Tiranë Rurale 2, DV Tirana Veri, DV Tirana Jug, me shkresat nr. *** prot., datë 03.08.2023 dhe 18.09.2023, datë 07.07.2023, datë 03.07.2023 dhe datë 26.06.2023, nuk konfirmojnë pasuri në emër të subjektit Altin Curri dhe personave të lidhur.

31.4 Credins Bank me shkresën nr. *** prot., datë 30.05.2023, konfirmon në emër të Hatije Daiu, llogari në euro, ku konstatohet se në datën 17.10.2022 kreditohet vlera 25.000 euro nga Hatije Daiu, e cila në datën 27.10.2022 transferohet me përshkrimin “Pagesë për të tretë, Garffs-Construction shpk, kalim sipas kontratës së sipërmarrjes datë 07.10.2022, rep. ***, kol. ***, për Altin Curri”.

31.5 OTP Bank me shkresën nr. *** prot., datë 05.05.2023, konfirmon në emër të Altin Curri dhe Hatije Daiu, Llogari në euro, ku konstatohet se Hatije Daiu, në datën 27.10.2022, tërheq vlerën 25.000 euro.

31.6 Me inventarin e datës 12.7.2023 subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues dhe sqarime me shkirm në lidhje me apartamentin e prenotuar, ku sqaron sa i përket pagesës së pjesës së mbetur të pagesës prej 45.400 euro për prenotimin apartamenti, shlyerja e saj ka vijuar sipas kushteve të paracaktuara në kontratë. Kanë likuiduar këstin e dytë prej 25.000 euro në Prill të 2023 nëpërmjet Credins Bank. Shuma prej 45.400 euro nuk është futur te lista e detyrimeve, pasi nuk e kanë konsideruar si borxh, duke qenë se nuk kishte ardhur data e pagesës sipas kontratës dhe të gjitha pagesat janë në fakt parapagesa, pasi nuk e disponojnë apartamentin në fjalë, duke qenë akoma në fazë ndërtimi. Në lidhje me konstatimin e OTP Bank, sqaron se vlera prej 25.000 euro e tërhequr nga OTP Bank, më datë 27.10.2022 është përdorur për likuidimin e kështit të parë të kontratës për prenotim apartamenti 1+1, nëpërmjet Credins Bank.

31.7 Me inventarin e datës 12.07.2023 subjekti ka dorëzuar mandat pagese nga Credins Bank, datë 20.04.2023, në vlerën 25.000 euro, nga Hatije Daiu, në favor të Garffs-Construction shpk, me përshkrimin “Kalim sipas kontratës së sipërmarrjes datë 07.10.2022, rep. ***, kol. ***, për Altin Curri”.

31.8 Bazuar në deklarin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar, në mënyrë të përmbledhur rezulton se;

✓ **Subjekti ka dhënë sqarime në lidhje me detyrimin financiar ndaj firmës “GarffsConstruction” shpk, në vlerën e mbetur prej 45.000 euro, deri në datën 10.03.2023, data e dorëzimit të deklaratës.**

- ✓ **Burimi i krijimit të pasurisë, deklaruar nga kontrata të cilat rrjedhin nga ekzekutimi i akt-marrëveshjeve nr. ***/*** dhe nr. ***/***, të datë 19.12.2005 dhe kontratës së sipërmarrjes nr. ***/***, datë 19.12.2005, trajtuar më sipër.**

31.9 **Kontratë sipërmarrje për prenotim apartamenti 2+1**, me sipërfaqe 116.73 m², në rrugën “Filip Jano”, Tiranë, si dhe garazh vend parkimi, në katin -2.

Vlera: 135.000 euro. Për këtë apartament është e gjithë vlera prej 135.000 euro, nëpërmjet bankës OTP.

Burimi i krijimit: Shitje e pasurive të paluajtshme me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.03.2022. Kontratë me nr. ** rep. dhe nr. ** kol., datë 13.01.2023.

31.20 Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë sipërmarrje për prenotim apartamenti, nr. ** rep., nr. ** kol., datë 13.01.2023, me palë sipërmarrëse shoqëria “Elbavo” shpk dhe prenotues Altin Curri, me objekt prenotimin dhe ndërtimin e një apartamenti me sipërfaqe 116.73 m², me nr. **, shkalla **, si dhe një parkim me sipërfaqe 13.5 m², me nr. **, në katin ** të objektit, të ndodhur në rrugën Jordan Misja, Tiranë. Çmimi për porosinë dhe prenotimin e apartamentit është 116.730 euro dhe i parkimit në vlerën 18.270 euro, me një çmim total prej 135.000 euro. Ky çmim do të paguhet nga porositësi me këste, nëpërmjet bankës BKT, në momentin e nënshkrimit të këtij akti noterial. Bashkëlidhur praktika.
- Mandatpagesë nga OTP Bank, datë 16.01.2023, ku konfirmohet transferimi nga Altin Curri dhe Hatije Daiu, i vlerës 135.000 euro, në favor të shoqërisë “Elbavo” shpk, me përshkrimin “Trf. për blerjep/p sipas kontratës nr. ** rep., nr. *** kol., datë 13.1.2023, shitës Elbavo shpk”.

HETIMI ADMINISTRATIV

31.21 **ASHK Tiranë-DV Tirana Rurale 1, DV Tiranë Rurale 2, DV Tirana Veri, DV Tirana Jug**, me shkresat nr. *** prot., datë 03.08.2023 dhe 18.09.2023, datë 07.07.2023, datë 03.07.2023 dhe datë 26.06.2023, nuk konfirmojnë pasuri në emër të subjektit Altin Curri dhe personave të lidhur.

31.22 Referuar dokumentacionit të përcjellë nga subjekti, rezulton se është nënshkruar një kontratë sipërmarrje për prenotim apartamenti, nr. ** rep., nr. ** kol., datë 13.01.2023, me palë sipërmarrëse shoqëria “Elbavo” shpk dhe prenotues Altin Curri, me objekt prenotimin dhe ndërtimin e një apartamenti me sipërfaqe 116.73 m², me nr. **, shkalla **, si dhe një parkim me sipërfaqe 13.5 m², me nr. **, në katin ** të objektit, të ndodhur në rrugën Jordan Misja, Tiranë. Çmimi për porosinë dhe prenotimin e apartamentit është 116.730 euro dhe i parkimit në vlerën 18.270 euro, me një çmim total prej 135.000 euro. Ky çmim do të paguhet nga porositësi me këste, nëpërmjet bankës BKT, në momentin e nënshkrimit të këtij akti noterial. Bashkëlidhur praktika.

31.23 OTP Bank, me shkresën nr. ** prot., datë 05.05.2023, konfirmon në emër të Altin Curri dhe Hatije Daiu, llogari në euro, ku konstatohet se në datën 16.01.2023, transferohet vlera 135.000 euro, në favor të shoqërisë Elbavo shpk.

31.24 Bazuar në deklarimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar, në mënyrë të përmbledhur rezulton se;

- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përqijjen e OTP Bank.
- ✓ Burimi i krijimit të pasurisë, deklaruar nga kontrata të cilat rrjedhin nga ekzekutimi i akt- marrëveshjeve nr. ***/*** dhe nr. ***/***, të datë 19.12.2005 dhe kontratës së sipërmarrjes nr. ***/***. datë 19.12.2005, trajtuar më sipër.

DEKLARIMI I BASHKËSHORTES - HATIJË DAIU

DEKLARIMI I PASURIVE

32. **Llogari bankare e pagës** në Credins Bank, gjendje 20.440 lekë, më datë 08.03.2023.

32.1 **Credins Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 30.05.2023, konfirmon në emër të Hatije Daiu, llogari në lekë, me gjendje në datën 10.03.2023, në vlerën 20.440 lekë.

- ✓ Konfirmohet deklarimi me përqijjen e Credins Bank.

33. **Llogari bankare në euro** në Credins Bank, gjendje 44 euro, më datë 08.03.2023.

33.1 **Credins Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 30.05.2023, konfirmon në emër të Hatije Daiu, llogari në euro, me gjendje ne datën 10.03.2023, në vlerën 44 euro.

- ✓ Konfirmohet deklarimi me përqijjen e Credins Bank.

34. DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- 1) Në muajin Korrik të vitit 2004, me rastin e martesës dhe krijimit të familjes së re, si pajë martese, prindërit e mi më kanë dhuruar shumën prej 1.000.000 lekë, deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 04.09.2019.
- 2) Financiere në shoqërinë *** shpk, nga data 01.03.2003 deri në datën 31.05.2005. Paguar me pagë 30.000 lekë në muaj, por deklarimi në siguracione është bërë me pagë minimale nga ana e shoqërisë, neto, shuma 810.000 lekë.
- 3) Leje lindje nga data 01.06.2005 deri në datën 19.05.2006, shuma 80.966 lekë.
- 4) Financiere në shoqërinë *** shpk, nga data 02.05.2006 deri në datën 31.12.2007. Paguar me pagë 30.000 lekë në muaj, por deklarimi në figuracione është bërë me pagë minimale nga ana e shoqërisë, neto shuma 600.000 lekë.

- 5) Financiere në shoqërinë “****” shpk, nga data 01.01.2008 deri në datën 20.07.2009. Paguar me pagë 30.000 lekë në muaj, por deklarimi në siguracione është bërë me pagë minimale nga ana e shoqërisë, shuma 570.000 lekë.
- 6) Leje lindje nga data 20.07.2009 deri në datën 12.07.2010, shuma 201.611 lekë.
- 7) Pagesë papunësie nga data 12.07.2010 deri në datën 11.07.2011, shuma 78.397 lekë.
- 8) Magaziniere në shoqërinë “Senka” shpk, nga data 01.01.2013 deri në datën 31.05.2013, shuma 87.740 lekë.
- 9) Leje lindje nga data 14.05.2013 deri në datën 12.03.2013, shuma 144.643 lekë.
- 10) Specialiste finance e nivelit të lartë në Bashkinë Kavajë, nga data 24.09.2015 deri në qershor 2020, paga bruto, shuma 3.433.455 lekë.
- 11) Shefe finance Posta Kavajë për periudhën Qershor 2020 — Tetor 2020, paga bruto 235.799 lekë.
- 12) Specialiste auditi në ujësjellës kanalizime Kavajë, Tetor 2020 — Nëntor 2022, paga bruto, shuma 1.375.272 lekë.

34.1 Bashkëlidhur deklaratës:

34.2 Vërtetim për bazën e vlerësueshme, për shtetasen Hatije Daiu, me punëdhënës ***** shpk, ku konfirmohen pagat bruto për periudhën Mars 2003 — Korrik 2009, në vlerën totale 1.145.572 lekë.

34.3 Shkresë nga ISSH, Agjencia Kavajë, datë 18.04.2018, ku bën me dije se shtetasja Hatije Daiu, ka përfutur të ardhura nga leja e lindjes për periudhën 01.06.2005 — 19.05.2006, në shumën 80.966 lekë. Gjithashtu konfirmon se ka përfutur të ardhura nga leja e lindjes për periudhën 20.07.2009 — 12.07.2010, në shumën 201.611 lekë.

34.4 Vërtetim për bazën e vlerësueshme nga ISSH, datë 12.07.2010, që vërteton pagat neto të Hatije Daiu, për periudhën Korrik 2010 — Korrik 2011, nga Zyra Vendore e Punësimit Kavajë, në vlerën 78.397 lekë.

34.5 Vërtetim nga ISSH, Agjencia Lushnje, datë 17.04.2018, që vërteton se Hatije Daiu është trajtuar me leje lindje për periudhën 12.03.2013 — 27.02.2014, në shumën 144.643 lekë.

34.6 Vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës, datë 08.03.2023, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të shtetasës Hatije Daiu, për periudhën Janar — Nëntor 2022, pranë subjektit Ujësjellës Kanalizime Kavajë.

34.7 Vërtetim për bazën e vlerësuar nga ISSH, datë 08.03.2023, për pagat bruto të shtetasës Hatije Daiu, për periudhën Janar 2013 — Janar 2022.

34.8 Vërtetim për bazën e vlerësuar nga DRSSH Fier, datë 17.04.2018, për pagat bruto të shtetasës Hatije Daiu, për periudhën janar 2013 — janar 2018.

34.9 Vërtetim për bazën e vlerësueshme nga ISSH, që vërteton pagat neto të Hatije Daiu, për periudhën shtator 2015 — mars 2018, nga Bashkia Kavajë.

34.10 Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 04.09.2019, me palë deklaruese T. Daiu dhe Hatije Daiu. Shtetasja T. Daiu deklaroi se në muajin Korrik 2004, i ka dhuruar vajzës Hatije Daiu shumën prej 1.000.000 lekë, me rastin e martesës. Këtë shumë ajo deklaroi se e ka siguruar nga puna e bashkëshortit të saj të ndjerë F. Daiu, si profesionist i lirë, elektrikist, dhe nga të ardhurat dhe kursimet e djalit të saj, i cili prej vitit 1994 është emigrant në Itali. Shtetasja Hatije Daiu deklaroi se shumën e mësipërme e ka përdorur për blerjen e një apartamenti.

34.11 **Credins Bank** me shkresën nr. *** prot., datë 30.05.2023, konfirmon në emër të Hatije Daiu, llogari në lekë, ku konfirmohen kreditimet nga ISSH, dhe paga nga Bashkia Kavajë, Posta Shqiptare dhe Ujësjellës Kanalizime Kavajë, për periudhën 21.05.2013 - 02.12.2022, në vlerën totale rreth 4.401.000 lekë.

34.12 **ISSH** me shkresën nr. *** prot., datë 10.05.2023, konfirmon pagat bruto/neto të Hatije Daiu, për periudhën Janar 2013 - Janar 2022, në subjektet (S***, Bashkia Kavajë, Posta Shqiptare dhe Ujësjellës Kanalizime Kavajë sha).

34.13 Me inventarin e datës 12.07.2023, subjekti ka dorëzuar sqarime me shkrim në lidhje me shumën prej 1.000.000 lekë, të cilën familja e bashkëshortes ia dhuroi vajzës si pagë martesore në vitin 2004, përveç deklaratës noteriale datë 04.09.2019, ka bashkëlidhur dhe dokumentacionin justifikues të të ardhurave të vëllait të saj P. Daiu në Itali. Përveç remitancave që P. Daiu ka dërguar në familjen e tij, prindërit e bashkëshortes kanë patur edhe të ardhura të veta, nga ushtrimi i zanatit të lirë si elektrikist, të babait.

34.14 Me inventarin e datës 12.07.2023 dhe me e-mailin e datës 17.07.2023, subjekti ka dorëzuar dokumentacion si më poshtë:

- Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 04.09.2019, me palë deklaruese T. Daiu dhe Hatije Daiu. (trajtuar më lart).
- Kartë identiteti Italiane, në emër të P. Daiu
- Dokumentacion për të ardhurat (në gjuhën italiane, pjesërisht i paqartë), të shtetasit P. Daiu, për vitin 2000.
- Dokumentacion për të ardhurat (në gjuhën italiane, pjesërisht i paqartë), të shtetasit P. Daiu, për vitin 2002.
- Dokumentacion për të ardhurat (në gjuhën italiane, pjesërisht i paqartë), të shtetasit P. Daiu, për vitin 2003.
- Librezë pune e shtetasit R. Daiu, për periudhën 1964 — 2012.
- Deklaratë e thjeshtë nga P. Daiu, datë 17.07.2023, i cili deklaroi se nga viti 1996, ka emigruar në Itali dhe ka kontribuar për familjen e tij, në ndihmë të prindërve dhe dy motrave në Shqipëri. Në Korrik të vitit 2004, ai dhe prindërit e tij vendosën që për pagë martesore t'i jepnin motrës, shumën prej 1.000.000 lekë, të cilën ajo e përdori për blerje

apartamenti 1+1.

- Dokumentacion për të ardhurat (në gjuhën Italiane), të shtetasit P. Daiu, për vitin 2001, vlera bruto 26.307 euro.
- Dokumentacion për të ardhurat (në gjuhën Italiane), të shtetasit P. Daiu, për vitin 2002, vlera bruto 13.716 euro.
- Dokumentacion për të ardhurat (në gjuhën Italiane), të shtetasit P. Daiu, për vitin 2003, vlera bruto 14.410 euro.
- Certifikatë familjare (në gjuhën Italiane), datë 14.02.2019, e shtetasve E. K., P. D., L. D, A. D., E. D. dhe T. D.
- Statement nga Banka Monte Dei Paschi di Siena, (në gjuhën italiane), për llogari të P. Daiu, datë 31.12.2002, për periudhën 30.09.2002 — 27.12.2002.
- Certifikatë martesë datë 15.09.2005, e shtetasve P. Daiu dhe E. K., Dokumentacion për të ardhurat (në gjuhën italiane), për të ardhurat e P. Daiu, për muajin mars 2001 në vlerën neto 1.693 euro dhe muajin prill 2001, në vlerën 1.702 euro.
- Ekstrakt për kontributet e sigurimeve (në gjuhën italiane), të shtetasit P. Daiu, për periudhën 1996 — 2015. Të ardhurat bruto nga paga për periudhën 1996 — 2004, rezultojnë në vlerën totale rreth 120.538 euro.
- Deklaratë nga P. Daiu, datë 01.02.2021, i cili deklaron se në vitin 1994 ka shkuar si emigrant në Itali dhe në vitin 1996 u bë i mundur punësimi me dokumentacion të rregullt, dhe vazhdimisht ka kontribuar për familjen e tij. Kontributin financiar e sillte herë pas here që vinte në Shqipëri. Me rastin e martesës së motrës Hatije Daiu, bashkë me prindërit vendosën që ti jepnin vlerën 1.000.000 lekë, sa ishte dhe kësti i dytë i shtëpisë ku do të fillonin jetën martesore. Nuk mund ta ndajë dot sa ka qenë kontributi i tij konkret dhe i prindërve pasi kursimet ishin të përbashkëta.

34.15 **Në përfundim të hetimit të kryer rezulton se:**

- ✓ **Të ardhurat e bashkëshortes Hatije Daiu, nga paga dhe leje lindje, për periudhën mars 2003 - mars 2023, rezultojnë 1.145.572 lekë bruto + 4.762.000 lekë neto, në total neto rreth 5.678.000 lekë.**
- ✓ **Bashkëshortja ka përfituar në formë dhurate nga familjarët vlerën 1.000.000 lekë, me rastin e martesës në vitin 2004, me burim të ardhurat familjare të babait të saj dhe vëllait emigrant në Itali, për të cilin ka dorëzuar dokumentacionin justifikues përkatës, si më sipër.**

35. Në rubrikën “të dhëna konfidenciale”, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar:

Dhënie hua shoqërisë “*****” shpk, me vlerë 60.000 euro, me afat 1 vjeçar.

Burimi i krijimit: shitje e pasurive të paluajtshme me rezervë pa kalim pronësie me kontratë Shitje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.3.2022. Kontratë huaje nr. *** rep., nr. ** kol., datë 26.01.2023.

HETIMI ADMINISTRATIV

Trupa e Vlerësimit mori në shqyrtim dokumentacionin bashkëlidhur deklaratës:

35.1 Kontratë huaje nr. *** rep., nr. ** kol., datë 26.01.2023, me palë huadhënës Hatije Daiu dhe huamarrës shoqëria “*****” shpk, për huadhënie në vlerën 60.000 euro, për nevoja të aktivitetit të shoqërisë huamarrëse. Huaja do të bëhet me kalim bankar. Huaja jepet pa interes dhe për një periudhë afat 1 vjeçare, nga data e disbursimit të kësaj huaje. Bashkëlidhur praktika.

35.2 Vendim i asamblesë së ortakëve të shoqërisë “*****” shpk, datë 25.01.2023, (G. P., G. D. dhe M. H.), ku është vendosur të miratohet kërkesa për marrjen e një huaje në vlerën 60.000 euro, për nevojat që ka shoqëria.

35.3 Transferte Swift, datë 27.01.2023 nga OTP Bank, me urdhërues Altin Curri ose Hatije Daiu, përfitues ***** shpk, të vlerës 60.000 euro, me përshkrimin “Dhënie huaje sipas kontratës së huasë nr. *** rep., nr. ** kol., datë 26.01.2023”, me burim, të ardhura nga shitje pasuri e paluajtshme.

35.4 **OTP Bank** me shkresën nr. *** prot., datë 05.05.2023, konfirmon në emër të Altin Curri Ose Hatije Daiu, llogari në euro, ku konstatohet se në datën 27.01.2023, transferohet vlera 60.000 euro në favor të ***** shpk.

35.5 **Konstatohet se: Huaja ndaj shoqërisë ***** shpk, në vlerën 60.000 euro, në vitin 2023, sipas kontratës së sipërcituar, ka si burim shitjen e pasurive të paluajtshme sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.03.2022.**

35.6 Subjekti ka sqaruar se me njërin nga pronarët e shoqërisë ***** shpk, i cili quhet G. D. ka lidhje shoqërore që në shkollën tetë vjeçare, ku kanë qenë në të njëjtën klasë. Gjithashtu bashkëshortet e tyre janë shoqe me njëra tjetrën. Përveç kësaj, gjatë muajve të verës kur jetojnë në Qerret- Kavajë, banojnë pranë njëri-tjetrit. Për sa i përket huas 60.000 euro, G. D. ishte në vështirësi ekonomike të shoqërisë dhe për arsyet që përmendi e pa të arsyeshme t’a ndihmojë.

35.7 Gjithashtu, edhe nëpërmjet e-mailit të datës 07.05.2024, subjekti ka sqaruar se shuma prej 60. 000 eurove që i ka dhënë hua “*****” shpk është pikërisht kjo marrëdhënie që ka me G. D.. Këtë hua ja ka dhënë pa interes dhe gjithashtu afatin e shlyerjes ia ka shtyrë verbalisht deri në fund të muajit Shtator 2024, kohë kjo që përkon me përfundimin e sezonit turistik, ku dhe biznesi i tij ka gjeneruar të ardhura të mjaftueshme.

35.8 Bazuar në dokumentacionin e përcjellë, korrespondencën me subjektin e vlerësimit dhe institucionet përkatëse, rezulton se:

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me përqijqjen e OTP Bank.**
- ✓ **Subjekti ka dhënë shpjegime. lidhur me marrëdhënien e tij me një nga bashkëpronarët e shoqërisë ***** shpk, huamarrës të shumës 60.000 Euro.**
- ✓ **Burimi i krijimit të huadhënies, deklaruar nga kontrata të cilat rrjedhin nga ekzekutimi i akt-marrëveshjeve nr. ***/*** dhe nr. ***/***, datë 19.12.2005 dhe kontratës së**

sipërmarrjes nr. */***. datë 19.12.2005, trajtuar tek të ardhurat e subjektit të vlerësimit dhe të dhënat konfidenciale.**

36. Në Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar, subjekti Altin Curri ka deklaruar adresën e plotë ku është regjistruar në Gjendjen Civile, si dhe adresën e plotë ku banon.

37. Me inventarin e datës 12.07.2023, subjekti ka dhënë sqarime në lidhje me adresën e banimit të deklaruar në rruga “Adil Alushi”, Lagjja nr.**, Kavajë dhe sqaron se është e njëjta banesë prej 148 m², ku banon që nga viti 2017, të cilën e ka ndërtuar vetë dhe për të cilën ka dhënë sqarime më lart.

Trajtuar më sipër.

38. Banka e Shqipërisë, Banka Kombëtare Tregtare, Intesa Sanpaolo Bank, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, ProCredit Bank, Banka e Parë e Investimeve, Union Bank, Raiffeisen Leasing, Porsche Leasing, Albania Leasing, Landelease, RFZ Invest, Credins Invest, Unioni Financiar Tiranë, Institucioni Financiar NOA, Easypay, Fondi BESA, Iutecredit Albania Kredo Financë, 14 Shoqëri Rajonale të UK, Tring, Digicom, konfirmojnë se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk janë klientë të tyre, ç’ka konfirmohet me deklarinimin.

39. Drejtoritë dhe Zyrat Vendore të ASHK-së, dhe konkretisht: Kamëz-Vorë, Mallakastër, Gramsh, Lushnje, Lezhë, Kukës, Përmet, Malësi e Madhe, Tropojë, Mirditë, Tepelenë, Elbasan, Has, Kolonjë, Durrës, Bulqizë, Pukë, Skrapar, Peqin, Krujë, Berat Korçë, Fier, Devoll, Librazhd, Gjirokastrë, Mat, Shkodër, Vlorë, Pogradec, Dibër, Kurbin, Sarandë, Kavajë, Kuçovë, nuk konfirmojnë pasuri të paluajtshme të regjistruara apo në proces legalizimi në emër të subjektit dhe personave të lidhur.

40. Tirana Bank me shkresën nr. ** prot., datë 12.05.2023, konfirmon se shtetasi Altin Curri, ka patur llogari aktive në lekë, për periudhën 2010 — 2013.

41. ABI Bank me shkresën nr. ** prot., datë 08.05.2023, konfirmon në emër të Altin Curri, llogari në euro, ku konstatohet se në datën 01.10.2015 kreditohet vlera 26.523 euro, me përshkrimin “*Kalim nga I. H. (H. H.), tek Altin Curri, për pagesë për blerje apartamenti sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 01.10.2015*”.

41.1 Me inventarin e datës 12.07.2023 subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues dhe sqarime me shkrim, në lidhje me transfertën në vlerën 26.523 euro, në Abi Bank nga shtetasi H.H., si më poshtë:

*Shtetasi B.H., i përfaqësuar nga H.H., bleu nga subjekti, të drejtën e blerjes së një apartamenti të porositur më parë tek F.H.. Konkretisht, me kontratën e porosisë nr. *** rep. dhe *** kol., datë 25.03.2012, subjekti ka porositur tek sipërmarrësi F.H., një apartament 2+1 me sipërfaqe 93 m², kundrejt çmimit total 4.000.000 lekë, nga të cilat kishte likuiduar 3.700.000 lekë. Shtetasi B.H., i ktheu shumën prej 3.700.000 lekë (nëpërmjet Abi Bank 26.523 euro) që kishte paguar dhe marrëdhënien me F.H. për blerjen e apartamentit e vazhdoi ai. E gjitha kjo është*

*pasqyruar në deklaratën noteriale që u bë në atë kohë mes tij, F.H. dhe B. H., me nr. *** rep. dhe *** kol., datë 01.10.2015. Subjekti nuk e bleu këtë apartament, sepse vendosën në familje, që të ndërtonin vetë banesën, ku do të banonin. Ky transaksion është kryer në përputhje me këtë deklaratë noteriale. Bashkëlidhur të gjitha kontratat dhe marrëveshjet që vërtetojnë transaksionin në fjalë. Nuk ekziston një kontrate shitje me nr. rep. ***, nr. kol. ***, datë 01.10.2015, është një gabim i nëpunësës së bankës kur ka plotësuar përshkrimin në faturën e transaksionit të kryer për vlerën 26.523 euro. Konkretisht, kjo faturë është plotësuar për deklaratën noteriale nr. *** rep. dhe *** kol., datë 01.10.2015 dhe nëpunësja e bankës ka gabuar në numrat: 9 e ka bërë 2 dhe numrin 6 e ka bërë 0. Për sa shpjegoi lart ka sqaruar me bankën. Pas kërkesës së tij banka i lëshoi vërtetimin, duke pranuar dhe sqaruar këtë gabim.*

41.1 Me inventarin e datës 12.07.2023, subjekti ka dorëzuar dokumentacion si më poshtë:

- Vërtetim nga Abi Bank, datë 18.02.2020, ku konfirmon se Altin Curri ka patur një llogari bankare, ku në datën 01.10.2015, ka kryer një transaksion bankar me përshkrimin “Kalim nga I. H. (H.H.) tek Altin Curri për pagesë blerje apartamenti, sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 01.10.2015”. Duke qenë se numrat referuar të dokumentit noterial të cituar (nr. rep dhe kol), kanë qenë të shkruara me shkrim dore, kjo mund të ketë quar në një gabim material të leximit të tyre dhe pasqyrimin në përshkrim. *Bashkëlidhur praktika.*
- Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 01.10.2015, me palë Altin Curri, B.H. dhe F.H.. Shoqëria tregtare *** shpk, përfaqësuar nga F.H., i ka shitur shtetasit Altin Curri, një apartament me sipërfaqe 93.04 m², e ndodhur në Kavajë. Për këtë apartament palët kanë përpiluar kontratë porosie nr. ***, datë 25.03.2012, në çmimin 4.000.000 lekë, nga e cila është likuiduar 3.000.000 lekë dhe mbeten 1.000.000 lekë, nga të cilat, po në vitin 2012, Altin Curri ka likuiduar 700.000 lekë dhe mbeten pa likuiduar 300.000 lekë. Blerësi në kontratën e porosisë nr. ***, datë 25.03.2012, është futur në marrëveshje me blerësin e dytë shtetasin B.H., për shitjen e kësaj pasurie, duke marrë për këtë shitblerje edhe pëlqimin e pronarit F.H.. Çmimi është caktuar në vlerën 4.000.000 lekë. Nga kjo shumë B.H. ka likuiduar 3.700.000 lekë, ndërsa 300.000 lekë, do t’ia likujdojë shoqërisë *** shpk. Shumën prej 3.700.000 lekë, B.H. do e kreditojë në favor të Altin Curri, nëpërmjet Bankës Credit Agricole Albania.
- Kontratë porosie nr. *** rep., nr. ** kol., datë 25.03.2012, me palë porositëse Altin Curri dhe sipërmarrës F.H., për apartament me sipërfaqe 93.04 m², drejt përfundimit, nga shoqëria *** shpk, e ndodhur në Kavajë, kundrejt vlerës 4.000.000 lekë. Hera 3.000.000 lekë është paguar nga Altin Curri ditën e sotme, ndërsa vlera e mbetur, pasi të përfundojë procedura e regjistrimit në ZVRPP Kavajë. *Bashkëlidhur praktika.*
- Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.11.2015, me palë shitëse shoqëria *** shpk. dhe blerës Blerim dhe H.H., për apartament me sipërfaqe 85.9 m², me numër pasurie ***, e ndodhur në Kavajë, në vlerën 4.000.000 lekë, nga të cilat 3.700.000 lekë, janë paguar në datën 25.03.2012, sipas kontratës së porosisë, të nënshkruar nga Altin Curri, sipas deklaratë noteriale nr. ***, datë 01.10.2015. Shuma 300.000 lekë do të depozitohet në llogari të noterit. *Bashkëlidhur praktika.*

41.2 Me e-mailin e datës 27.9.2023 subjekti ka dërguar sqarime me shkrim, në lidhje me

burimin e vlerës 3.700.000 lekë, e cila lidhet me kontratën e përpiluar me shtetasin H.H., ku ka sqaruar se burimi i kësaj shume, është përfitimi që ka marrë nga pjesa takuese, kur janë shitur apartamentet e para në Qerret, Kavajë.

41.3 Bazuar në deklarin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar, në mënyrë të përmbledhur rezulton se, në vitin 2012, subjekti ka prenotuar nga shoqëria *** shpk, një apartament me sipërfaqe 93.04 m², dhe ka paguar vlerën 3.700.000 lekë. Në vijim, në vitin 2015, subjekti ka vendosur ta shesë këtë apartament tek shtetasi B.H., në vlerën 26.523 euro, pagesë e cila është kryer me transaksion bankar, në Abi Bank, në datën 01.10.2015, referuar deklaratës nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë 01.10.2015.

- ✓ Subjekti ka sqaruar burimin e vlerës 3.700.000 lekë, nga përfitimi që ka marrë nga pjesa takuese, nga shitja e apartamenteve të para në Qerret, Kavajë.
- ✓ Subjekti ka dhënë sqarime në lidhje me transaksionin në Abi Bank, më datë 01.10.2015, në vlerën 26.523 euro, për shitje pasurie të paluajtshme.

42. Credins Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 30.05.2023, konfirmon në emër të Hatije Daiu, llogari në lekë, ku konstatohet se në datën 11.03.2022, krediton vlerën 1.145.000 lekë, me përshkrimin “Arkëton Hatije Daiu, kursime ndër vite”, dhe në të njëjtën datë transferon vlerën 1.389.630 lekë, për ASHK Kavajë, me përshkrimin “Tax 3% rivl. Pas., kërkesa **** Altin Curri”.

42.1 Me inventarin e datës 12.07.2023, subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues dhe sqarime me shkrim, në lidhje me transaksionin në vlerën 1.389.630 lekë, në bankën Credins, më datë 11.03.2022 dhe sqaroi se rivlerësimi është bërë për pasurinë e shitur në Qerret dhe burimi është nga kursimet ndër vite, nga pagat dhe të ardhurat e tjera të shitjes së apartamenteve të cituara dhe në deklaratën e pasurisë.

42.2 Me inventarin e datës 12.07.2023, subjekti ka dorëzuar dokumentacion, si më poshtë:

- Mandate pagesash nga Credins Bank, të datës 11.03.2022, ku Hatije Daiu, krediton në total 2.374.810 lekë, në favor të ASHK, për rivlerësim pasurish të paluajtshme Kërkesa/aplikime datë 09.03.2022, për rivlerësim të pasurive me nr. ***+1-NI, ***+1-20, ***+1-18, ***+1-13 ***+1-16, ***+1-15, dhe ***+1-14, kërkuesi Altin Curri.
- Kërkesë/aplikim datë 09.03.2022, për rivlerësim të pasurisë nr. ***+1-NI, kërkuesi Altin Curri, vlera e pagesës 1.391.830 lekë.

- ✓ Subjekti ka sqaruar në lidhje me transaksionin në Credins Bank, në datë 11.03.2022 në vlerën 1.389.630 lekë, kryer për rivlerësim pasurie. Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se për rivlerësim të pasurive të paluajtshme në vitin 2022, subjekti ka shpenzuar vlerën totale rreth 2.375.000 lekë.

43. Unioni Financiar Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 09.05.2023, konfirmon në emër të Hatije Daiu një tërheqje në vlerën 250 euro dhe një dërgesë në vlerën 20 euro.

44. QKB, me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, konfirmon të regjistruar shtetasen T. Daiu, si aksioner me (0,022 %), në shoqërinë “Kantina e Pijeve Gjergj Kastrioti Skënderbeu” sha, me NIPT J***M, themeluar në datë 02.08.1995, me status aktiv. Bashkëlidhur praktika.

45. DPT me shkresën nr. v-prot., datë 12.05.2023, konfirmon të regjistruar shtetasen T. Daiu, si aksioner në shoqërinë “Kantina e Pijeve Gjergj Kastrioti Skënderbeu”.

46. ISSH, Drejtoria e Arkivit Qendror, me shkresën nr. V-Prot., datë 17.05.2023, përcjell shkresën e Degës së Arkivit të Rajonit Tiranë, e Cila informon se nga mënyra e administrimit dhe përpunimit të listë pagesave, për periudhën 1994 — 2012, të punonjësve të siguruar në subjektet shtetërore, juridikë apo fizikë, nuk mund të konfirmohet periudhë kontributesh apo paga, mbi të cilën janë siguruar, në qoftë se nuk jepet emërtimi i qendrës së punës, Nipti i subjektit, fotokopje e librezës së punës. Bashkëlidhur: Vërtetim nr. *** prot., datë 12.05.2023, nga Drejtoria e Arkivit Qendror, për subjektin Altin Curri.

47. ISSH, Drejtoria Juridike, me shkresën nr. *** prot., datë 10.05.2023, i dërgon shkresë Drejtorisë së Arkivit Qendror Lundër, për të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortes.

48. Drejtoria e Përgjithshme Detare, me shkresën nr. *** prot., datë 10.05.2023, nuk konfirmon mjet lundrues në pronësi të subjektit apo personave të lidhur.

49. ASHK, Drejtoria Vendore Kavajë, me shkresën nr. *** prot., datë 27.09.2023, konfirmon në emër të Altin Curri, pasurinë me nr. ****, vol. **, fq. ***, zk. **** dhe pasurinë me nr. ****, vol. **, fq. ***, zk. ****, si dhe në emër të Hatije Daiu, pasurinë me nr. **, vol. **, fq. **, zk. ****.

49.1 Bashkëlidhur kartelat e pasurive:

- Kartela e pasurisë me nr. ***, e llojit apartament me sipërfaqe 85.2 m², e ndodhur në Tiranë, vlera 73.000 euro, në emër të Altin Curri, përfutur me kontratë shitje datë 31.03.2023, regjistruar në datë 02.05.2023.

- Kartela e pasurisë me nr. ***, e llojit garazh me sipërfaqe 14.5 m², e ndodhur në Tiranë, vlera 2.000 euro, në emër të Altin Curri, përfutur me kontratë shitje datë 31.03.2023, regjistruar në datë 02.05.2023.

- Kartela e pasurisë me nr. ***, e llojit truall me sipërfaqe 120.3 m² dhe ndërtesë 120.3 m², e ndodhur në Kavajë, në emër të T. Daiu me 5/8 pjesë takuese dhe P. D., Hatije Daiu dhe D. D., me nga 1/8 pjesë takuese secili, regjistruar në datë 15.05.2019.

49.2 Me e-mailin e datës 27.09.2023, subjekti ka bashkëlidhur dokumentacion justifikues, si dhe sqarime me shkrim, në lidhje me pasuritë e mësipërme, ku sqaron se për sa i përket pronës me nr. ***, ku rezulton si pjesëtare edhe bashkëshortja e tij Hatije Daiu, kreu

verifikimet përkatëse, ku bëhet fjalë për shtëpinë e prindërve të bashkëshortes, Kjo shtëpi ka qenë në emër të prindërve të saj F. dhe T. Daiu. Pasi ka ndërruar jetë babai i saj F. Daiu, nëna T. Daiu ka bërë një kërkesë dhe ka paraqitur dëshmi trashëgimie në ASHK, pa vënë në dijeni për këtë fëmijët e saj, P.D, D.D. dhe Hatijen. Pas kësaj kërkesë, ka dalë certifikata e pronësisë, ku ka pjesë takuese bashkëshortja Hatije Daiu. Për këtë fakt u vunë në dijeni tani.

49.3 Në lidhje me pasuritë nr. *** dhe nr. *** zk. ***, sqaron se bëhet fjalë për një apartament dhe garazh, të cilin e ka blerë pasi ka plotësuar formularin e deklaramit të pasurisë. Akti noterial për këtë apartament dhe garazh është i datës 31.03.2023 dhe certifikata e pronësisë për këto pasuri ka dalë më 02.05.2023, ndërsa dorëzimi i formularit të deklaramit të pasurisë është bërë nga ana e tij, më datë 10.03.2023.

49.4 Bashkëlidhur e-mailit dokumentacioni si më poshtë:

- Kontratë shitje pasuri e paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.03.2023, me palë shitëse S. dhe D. V. dhe blerës Altin Curri, për apartament me nr. ****, zk. ***, me sipërfaqe 85.2 m², si dhe garazh me nr. ***, zk. ***, me sipërfaqe 14.5 m², e ndodhur në Tiranë, në vlerën totale 75.000 euro, vlerë e cila do të kryhet me transaksion bankar. Bashkëlidhur praktika.
- Certifikata për regjistrim pronësie, datë 02.05.2023, për pasuritë me nr. ***, dhe nr. ***, në emër të Altin Curri.
- Shkresë nga ASHK, Drejtoria Vendore Tirana Veri, për aplikimin e regjistrimit të kontratës së Shitjes nr. ***, datë 31.03.2023.
- Kartela e pasurisë, për pasurinë e llojit truall, me sipërfaqe 120.3 m² dhe ndërtesë 120.3 m², e ndodhur në Kavajë, ku rezulton se ka qenë e regjistruar në datë 27.11.2016, në emër të F. dhe T. Daiu dhe më pas në datë 15.05.2019 është regjistruar “Bashkëpronarë sipas listës”, me dëshmi trashëgimie. Pasuria ka shënimin “Leje legalizimi datë 28.09.2016, godinë banimi 2 kat, kati përdhe 120.3 m², kati I, 120 m². Bashkim pasurie”.
- Vërtetim nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, datë 10.03.2023, që vërteton se Altin Curri, ka dorëzuar Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar dhe dokumentacionin përkatës.
- Dëshmi trashëgimie ligjore, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 06.05.2019, me kërkues T. Daiu, me Objekt lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin F. Daiu, ku është vendosur lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin F. Daiu, me trashëgimtarë T., P., Hatije dhe D. Daiu.
- Kërkesë për aplikim në ASHK Kavajë, datë 15.05.2019, nga T. Daiu, shënimi “Dorëzoi dsh. Trashëgimie”.
- Kartela e pasurisë, për pasurinë e llojit truall, me sipërfaqe 120.3 m² dhe ndërtesë 120.3 m², e ndodhur në Kavajë, ku rezulton se ka qenë e regjistruar në datë 17.05.2017, në emër të F. D. dhe T. D., dhe më pas në datë 15.05.2019 është regjistruar në emër të T., P., H. dhe D. Daiu, regjistruar me dëshmi trashëgimie.
- Kartela e pasurisë, për pasurinë e llojit truall, me sipërfaqe 120.3 m² dhe ndërtesë 120.3 m², nr. ***, vol. **, fq. **, zk. ***, e ndodhur në Kavajë, regjistruar në datë 15.05.2019, në

emër të T. Daiu me 5/8 pjesë takuese; dhe P. D., Hatije dhe D. Daiu, me nga 1/8 pjesë takuese secili.

49.5 Sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e administruar, rezulton se:

- ✓ Pasuria me nr. *** e llojit apartament me sipërfaqe 85.2 m², dhe nr.***, e llojit garazh me sipërfaqe 14.5 m², në Tiranë, janë përfituar nga subjekti me kontratë shitblerje nr. *** rep. nr. *** kol., datë 31.03.2023, sipas dokumentacionit të dorëzuar dhe përgjigjes së ASHK, datë e cila i përket periudhës pas dorëzimit të Deklaratës së Pasurisë Vetting. Deklarata rezulton të jetë dorëzuar nga subjekti pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, më datë 10.03.2023.
- ✓ Pasuria me nr. 1/736, e llojit truall me sipërfaqe 120.3 m² dhe ndërtesë, e ndodhur në Kavajë, është përfituar nga bashkëshortja në masën 1/8 pjesë takuese, me trashëgimi ligjore, sipas aktit të trashëgimisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 06.05.2019, aplikuar në ASHK, nga nëna e bashkëshortes, T. Daiu, më datë 15.05.2019 e padëklaruar nga bashkëshortja, e cila nuk ka pasur dijeni në lidhje regjistrimin, pasi aplikimi për regjistrimin e dëshmisë së trashëgimisë, është kryer nga nëna e saj T. Daiu, pa vënë në dijeni fëmijët e saj.

NË PËRFUNDIM TË HETIMIT TË KRYER MBI VLERËSIMIN E PASURISË,

50. Trupa e Vlerësimit ka analizuar dhe verifikuar të dhënat e mbledhura nga institucionet e ndryshme në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar dhe në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, bazuar në parimin e kontradiktoritetit, u mbështet edhe në shpjegimet që dha subjekti në seancën dëgjimore, ku arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit:

- ✓ Ka pasaktësi në deklarin, për të cilat ka dhnë sqarime dhe shpjegime duke bashkëlidhur dokumentacionin justifikues, në përputhje me Ligjin, me burimet e ligjshme financiare;
- ✓ Nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- ✓ Nuk është kryer fshehje e pasurisë;
- ✓ Nuk është kryer deklarin i rremë;
- ✓ Subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

B. KONRROLI I FIGURËS

51. Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.

52. Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre elemente:

- (i) Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të Nenit 36, pika 1, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;
- (ii) Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
- (iii) Verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të Nenit 36, pika 3, gërmra (ë), të Ligjit 12/2018, i ndryshuar.

53. Subjekti i vlerësimit, z. Altin Ramazan Curri, në zbatim të Nenit 36, pika 2, të Ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në datën 10.03.2023.

54. Për kontrollin e figurës Trupa e Vlerësimit administroi:

- a. Deklaratën e Kontrollit të Figurës;
- b. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

55. Në përputhje me nenin 42 pika 1, të Ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar, është përcjellë pranë Trupës së Vlerësimit raporti nr. *** Prot., datë 23.08.2023, i përpiluar me përgjigjet e ardhura nga institucionet publike dhe ato ligjzbatuese, verifikuese dhe informuese, ku është konstatuar përshtatshmëria e subjektit të vlerësimit z. Altin Ramazan Curri.

56. Në deklaratën “Kontrolli i Figurës”, subjekti i vlerësimit ka deklaruar si vijon:

- 56.1 Në pjesën e parë të formularit, subjekti ka plotësuar të dhënat identifikuese.
- 56.2 Në pjesën e dytë të formularit, subjekti ka plotësuar të dhënat për vendbanimin.
- 56.3 Në pjesën e tretë të formularit, subjekti ka plotësuar të dhënat për arsimimin dhe kualifikimet.
- 56.4 Në pjesën e katërt të formularit, subjekti ka plotësuar të dhënat për punësimin.
- 56.5 Në pjesën e pestë të formularit, subjekti ka plotësuar të dhënat për sigurinë, si më poshtë vijon:

- 1) Nuk është dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj.
- 2) Nuk ka qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj.
- 3) Nuk ka qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligj zbatuese shqiptare apo të huaja për kryerjen e një vepre penale.
- 4) Ndaj tij nuk është caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi.
- 5) Nuk është lëshuar asnjëherë ndaj tij një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
- 6) Ndaj tij nuk është marrë asnjëherë masë dëbimi nga një shtet i huaj.
- 7) Subjekti ka deklaruar që nuk ka dijeni se ndonjë nga anëtarët e familjes së tij bashkëshortja dhe fëmijët, të jetë përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.

- 8) Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme në formën e takimit, komunikimit elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës së subjektit.
- 9) Subjekti nuk është në dijeni që një nga anëtarët e familjes së tij të kenë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- 10) Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- 11) Nuk ka dijeni se një person i familjes, ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- 12) Nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s gjatë 10 viteve të fundit.
- 13) Nuk ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
- 14) Nuk ka patur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit, sipas neneve të ligjit për garantimin dhe integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
- 15) Nuk ka fshehur apo keq prezantuar, falsifikuar një informacion të një rëndësie të madhe, të një natyre sigurie të veçantë apo të ketë gënjer gjatë plotësimit të formularit të deklarats së kontrollit të figurës.
- 16) Nuk ka kryer shkelje sigurie, apo të ketë nëpërkëmbur në mënyrë të përsëritur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar, apo të ketë tentuar të kryej aktivitet të paautorizuar në sistemet e komunikimit të informacionit të klasifikuar.
- 17) Nuk ka qenë asnjëherë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Ish- Sigurimi i Shtetit para vitit 1991, sipas ligjit nr. 45/2015 “Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish-shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.
- 18) Nuk ka vuajtur nga çrregullime mendore kronike.
- 19) Nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
- 20) Nuk ka pasur asnjëherë varësi ndaj alkoolit apo lojërave të fatit.

57. Po ashtu, subjekti ka nënshkruar edhe dy vetë-deklarimet për vërtetësinë e të dhënave dhe saktësinë e tyre të paraqitura në deklaratën e kontrollit të figurës si dhe deklaratën për dhënien e pëlqimit për mbledhjen e të dhënave, kryerjen e kontrollit të figurës dhe aksesin për njohjen dhe administrimin e të dhënave personale.

58. Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore ka dërguar raportin e hollësishëm të përgatitur, nga ku rezulton se, *“Për subjektin e vlerësimit z. Altin Ramazan Curri, me detyrë Drejtor, Drejtoria e Hetimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore dhe “personave të lidhur”, nuk administrohen të dhëna, fakte apo prova, që punonjësi është i përfshirë ose i dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, apo që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar”.*

HETIMI ADMINISTRATIV

59. Për të vijuar me kontrollin tërësor të figurës dhe saktësinë e deklarimit të subjektit të vlerësimit lidhur me këtë aspekt, në bazë të nenit 36, të Ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin

kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, janë kryer veprimet duke kërkuar të dhëna nga institucionet agjencitë ligj zbatuese, ku ka rezultuar si vijon:

60. **Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile** me shkresën “I Kufizuar”, Nr. *** Prot., datë 25.05.2023, bën me dije se nuk ka ndryshim të gjeneraliteteve të subjektit të vlerësimit z. Altin Ramazan Curri.

61. **Institucion ligjzbatues**, me shkresat “I Kufizuar”, Nr.*** Prot., datë 19.05.2023 dhe datë 03.01.2014; për subjektin e vlerësimit z. Altin Ramazan Curri, bën me dije se nuk rezulton i dënuar.

62. **Institucion ligjzbatues**, me shkresën “I kufizuar” Nr. *** datë., 26.05.2023 dhe me shkresën “E paklasifikuar”, Nr.*** Prot. datë 30.05.2023; për subjektin e vlerësimit z. Altin Curri, si dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, bën me dije se:

- Nuk kanë të dhëna apo indicie për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe të cenimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta;
- Nuk kanë të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, (sipas përcaktimeve të bëra në ligjin Nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”) ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike, etj;
- Nuk kanë të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona (persona të dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të Ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar);
- Nuk kanë të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e një vepre penale;
- Nuk kanë të dhëna në lidhje me lëshimin e ndonjë urdhri ndërkombëtar, për kryerjen e një vepre penale;
- Nuk kanë të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga një shtet i huaj;
- Nuk kanë të dhëna në lidhje nëse gjatë 10 viteve i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATOS;
- Nuk kanë të dhëna nëse nga subjekti është kërkuar azil politik në ndonjë shtet;
- Nuk ka procedim disiplinor apo masë disiplinore.

63. **Institucion ligjzbatues**, me shkresën “Konfidencial”, Nr. *** Prot., datë 31.05.2023; për subjektin e vlerësimit Z. Altin Ramazan Curri, bën me dije se nuk disponon të dhëna.

64. **Institucion ligjzbatues** me shkresat “Sekret” datë 13.06.2023 dhe datë 21.06.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Altin Ramazan Curri dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, bën me dije se:

- Nuk kanë të dhëna për përfshirje në aktivitet të kundërligjshëm;
- Nuk ka procedime penale të referuara;
-

65. **Institucioni ligjzbatues**, me shkresën “I Kufizuar”, Nr. *** Prot., datë 26.05.2023; bën me dije se për subjektin e vlerësimit nuk disponohen ankesa, të dhëna ose informacione që lidhen me objektin e kërkesës.

66. **Institucion ligjzbatues**, me shkresën “I Kufizuar”, Nr.*** Prot., datë 07.07.2023; shkresën datë 27.07.2023 dhe datë 07.02.2024, për subjektin e vlerësimit Z. Altin Ramazan Curri, bën me dije se:

- Nuk është nxjerrë urdhër ndalimi;
- Nuk është kërkuar masë e sigurimit personal;
- Nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale;
- Nuk ka pasur raste të urdhrave ndërkombëtar të ndalimit;
- Nuk rezulton të jetë regjistruar kallëzim.

67. **Institucioni ligjzbatues**, me shkresat “I kufizuar”, Nr. *** Prot., datë 01.06.2023, 27.12.2023 dhe datë 02.05.204; bën me dije se për subjektin e vlerësimit z. Altin Ramazan Curri, nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

68. **Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar**, me shkresën “I Kufizuar”, Nr. *** Prot., datë 19.05.2023; për subjektin e vlerësimit z. Altin Ramazan Curri, bën me dije se:

- 68.1 Është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), në nivelin “Tepër Sekret”, lëshuar më datë 16.10.2018, e vlefshme deri më datë 15.10.2023.
- 68.2 Nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP.
- 68.3 AKSIK nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

69. **Agjencia e Mbikëqyrjes Policore**, me shkresën “Sekret”, Nr. *** prot., datë 19.12.2023, bën me dije se subjekti Altin Curri është pajisur nga AKSIK me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), në nivelin “Tepër Sekret”, lëshuar më datë 09.11.2023, e vlefshme deri më datë 08.11.2028.

70. **Avokati i Popullit** me shkresën “E Paklasifikuar”, Nr. *** Prot., datë 30.05.2023; për subjektin e vlerësimit z. Altin Ramazan Curri, bën me dije se:

- Nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës.
- Nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.

71. **Institucioni ligjzbatues**, me shkresën “I kufizuar”, Nr. *** Prot., datë 08.06.2023; për subjektin e vlerësimit z. Altin Ramazan Curri, bën me dije se nuk ka qenë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri 2 Korrik 1991.

72. **Institucioni ligjzbatues**, me shkresën Nr. *** prot., datë 30.05.2024, për subjektin e vlerësimit z. Altin Ramazan Curri, si dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, bën me dije se: *“Pas verifikimeve të kryera për z. Altin Ramazan Curri, nuk disponon të dhëna të tjera përveç sa ka informuar me shkresën nr. ***, datë 15.11.2021”*.

73. **Institucioni ligjzbatues**, me shkresën Nr. *** Prot., datë 15.11.2021, për z. Curri, disponon të dhëna që rezultojnë në historikun e verifikimeve të kryera ndër vite. Të dhënat në ngarkim të subjektit të vlerësimit janë ndarë me institucionet e tjera ligjzbatuese.

74. Në vlerësim të të dhënave që disponohen për subjektin e vlerësimit rezulton se: Agjencia ligjzbatuese, më datë 03.12.2021 ka hartuar dhe miratuar një Plan-Masash me detyra konkrete për verifikimin e informacioneve të relatuara në ngarkim të subjektit të vlerësimit z. Altin Ramazan Curri, informacione këto të ndara me institucione të tjera përgjegjëse. Rezultoni se, përveç procedurës standarde të korrespondencës me autoritetet verifikuese dhe jo vetëm, janë kryer verifikime të detajuara analitike, verifikime në sisteme e database, intervistime me shkrim dhe audio, si dhe ballafaqime të rezultateve të verifikimeve me shpjegimet e punonjësit.

75. **Testi për përdorim lëndësh narkotike:**

75.1 Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, ka kryer testin mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara testimi për përdorim lëndësh narkotike, konkludohet se:

75.2 Në mostrën e urinës marrë subjektit, **nuk u zbulua** prania e produkteve të metabolizmit të MOP (opiate/heroine), COC (kokaine), MTD (metadon), THC (canabioide/cannabis sativa), BARB (barbiturate), TCA (triciklike anridepresanrë, AMP (amfetaminë), MDMA (ekstazi), LSD (acid lisergjik), BZO (benzodiazepina).

76. Në përfundim të hetimit të kryer, për subjektin e vlerësimit z. Altin Curri dhe personale të lidhur me të, nuk administrohen të dhëna, fakte apo prova, që punonjësi është i përfshirë ose i dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, apo që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar sipas nenit 35, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

77. Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45 dhe 47, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, si dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

78. Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:

78.1 Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar;

78.2 Raportin e përgatitur nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

79. Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, në përputhje me nenin 46 pika 2, të Ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar, ka përcjellë pranë Trupës së Vlerësimit, për subjektin e vlerësimit z. Altin Curri, raportin e vlerësimit të aftësive profesionale me Nr.*** Prot., datë 21.07.2023, të përpiluar në mënyrë të hollësishme dhe të arsyetuar, në të cilin është konstatuar se:

Punonjësi i Policisë Z. Altin Ramazan Curri është i përshtatshëm për pozicionin e tij të punës, ka arsimin dhe trajnimet përkatëse për funksionin që mban, ka vlerësime pozitive pune dhe ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban.

HETIMI ADMINISTRATIV

80. Subjekti i vlerësimit z. Altin Ramazan Curri, në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin e Drejtorit të Drejtorisë së Hetimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

81. Në zbatim të pikës 2 dhe 3 të nenit 44, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ku përcaktohet se periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën/pozicionin që mban, jo më shumë se 5 (pesë) vjet. Subjekti i vlerësimit Altin Curri, nga viti 2018 e deri aktualisht, ka qenë pjesë e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

82. Vlerësimi i aftësive profesionale mbështetet në:

- Të dhënat e administruara në dosjen personale të subjektit;
- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të Nenit 44, pika 1, Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, të mbështetura në dokumentacionin shoqërues të dorëzuara nga vetë subjekti;

Në Formularin e Aftësive Profesionale subjekti deklaron:

I. Të dhëna për Arsimimin

1.1 Subjekti i vlerësimit ka kryer studimet si vijon:

- “Akademia e Rendit Publik”, (me shkëputje nga puna), 1995 - 21.09.1998, me numër amze ***.
- Universiteti i Tiranës, dega “Drejtësi”- titulli “Jurist”, diplomë nr. *** – 02.07.2002.

1.2 Pas verifikimit të diplomës në Regjistrin Shtetëror të Diplomave/IAL-në përkatës, sipas shkresës kthim përgjigje me nr. 1360/1 datë 14.06.2023 rezulton se subjekti i vlerësimit është diplomuar në Akademinë e Sigurisë.

1.3 Sipas të dhënave të administruara në Dosjen Personale të Subjektit, në kuptim të legjislacionit për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore në vite dhe Ligjit nr. 128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”, VKM Nr. 532, datë 29.07.2022 “Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”, rezulton se:

1.4 **Subjekti i vlerësimit për periudhën e përcaktuar në pikat 2 e 3 të nenit 44, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, sipas ecures së tij, ka qenë në përmbushje të kriterit të nivelit arsimor për funksionet që ka ushtruar në vite dhe atë aktual.**

II. Certifikatat e trajnimeve, kualifikimeve dhe medaljet

2.1 Nga verifikimi dosjes së personelit pranë AMP-së si dhe pikës 3, të pjesës 3, të formularit të aftësive profesionale të dorëzuar nga subjekti, rezulton se është pajisur me certifikata për kryerje kursesh, shkollime dhe trajnime brenda dhe jashtë vendit.

2.2 Vërtetim për z. Altin Curri, në shenjë mirënjohjeje për përfundimin e “Advanced Suspect Interviewing Course”, Lëshuar nga Departamenti i Drejtësisë i SHBA-së në partneritet me Komandën Evropiane të Shteteve të Bashkuara (EUCOM).

2.3 29.05.2023 - 07.07.2023 - Certifikatë trajnimi mbi “Programin e formimit të trajnuesve për kursin e hetimit të krimit, Niveli 1”, zhvilluar në fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit, nga Departamenti i Drejtësisë së SI-BA-së, në bashkëpunim me Akademinë e Sigurisë.

2.4 29.05.2023 - 23.06.2023 - Certifikatë trajnimi, “Kursi i hetimit të krimit, Niveli 1”, zhvilluar në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit.

2.5 25.04.2022 - 29.04.2022 - Certifikatë, “Për fitimin e gradës “Drejtues i Parë”, zhvilluar në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit, Akademia e Sigurisë “Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit”.

2.6 Krahas trajnimeve dhe certifikatave të përmendura më sipër, subjekti i vlerësimit ka kryer dhe një sërë trajnimesh/ kursesh të cilat kanë shërbyer në formimin profesional të subjektit.

2.7 Nga verifikimi i të dhënave të administruara, rezulton se:

- ✓ **Deklarimi i subjektit të vlerësimit është i saktë.**
- ✓ **Subjekti ka kryer trajnime/specializime të shumta në përputhje me funksionin që ushtron.**

III. Vlerësimet e punës

3.1 Nga dokumentacioni i dorëzuar pranë trupës së vlerësimit, për periudhën 2018-2022, si dhe bazuar në sistemin e vlerësimit dhe pikëzimit të rezultateve të punës për performancën vjetore, rezulton se subjekti është vlerësuar në të gjitha vitet me vlerësim “Shumë mirë” për punën e kryer, si më poshtë vijon:

Vlerësimi i rezultateve të punës për periudhën 01/01/2018- 31/12/2018	shumë mirë
Vlerësimi i rezultateve të punës për periudhën 01/01/2019 - 31/12/2019	shumë mirë
Vlerësimi i rezultateve të punës për periudhën 01/01/2020 - 31/12/2020	shumë mirë
Vlerësimi i rezultateve të punës për periudhën 01/01/2021 - 31/12/2021	shumë mirë
Vlerësimi i rezultateve të punës për periudhën 01/01/2022 - 31/12/2022	shumë mirë

3.2 Vlerësimi i aftësive individuale të punës sipas standardeve të përcaktuara bëhet nga eprori i drejtpërdrejtë, bazuar në vlerësimin e integritetit, profesionalizmit, komunikimit, qëndrimit konstruktiv, paanshmërisë, punës në grup si dhe planifikimit dhe organizimit të punës.

3.3 Pranë AMP-së, nuk kanë ardhur denoncime/ankesa nga publiku për subjektin për sjellje joprofesionale dhe jo-etike, gjatë ushtrimit të detyrës.

3.4 Bazuar në vlerësimet e mësipërme të administruara nga trupa e vlerësimit, konkludohet:

- ✓ **Deklarimi i subjektit të vlerësimit është i saktë.**
- ✓ **Subjekti ka përmbushur detyrat profesionale, ka respektuar rregullat e etikës, si edhe ka shfaqur performancë të lartë funksionale.**

IV. Masat disiplinore

4.1 Referuar raportit të dërguar nga Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, ku konfirmon se ka verifikuar dokumentacionin në dosjen personale të subjektit, rezulton se gjatë periudhës 5 vjeçare, (2018- 2022) të përcaktuar në pikën 2, të nenit 44, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit:

- ✓ **Nuk është ndëshkuar me masë disiplinore.**
- ✓ **Deklarimi i subjekti është i saktë.**

V. Ecuria në karrierë

5.1 Nga verifikimi i kryer nga trupa e vlerësimit rezulton se gjatë periudhës 5 vjeçare, subjekti Altin Curri, ka ecurinë në karrierë, si vijon:

- 01.09.2022 - Aktualisht - Drejtor, në Drejtorinë e Hetimit, në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore.
- 02.02.2021 - 09.05.2021 – Drejtor në Drejtorinë Rajonale Fier – Berat, në Drejtorinë e Përgjithshme të SHÇBA-së.
- 01.11.2018 - 03/2020 – Drejtor i Drejtorisë së Hetimit të SHÇBA-së. (AMP)
- 09/2018 – 11/2018 – Shef Sektori, AMP
- 05/2018 – 11/2018 - Shef në Sektorin e Sigurimit të Personelit dhe Monitorimit të Brendshëm, pranë Drejtorisë së Analizës së SHÇBA-së. (AMP)
- 21.01.2015 – 05/2018 - Specialist në Sektorin e Drejtimit të Hetimit pranë Drejtorisë së Kërkimit dhe Hetimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të SHÇBA-së. (AMP)

5.2 Në lidhje me përputhshmërinë e gradës me funksionin/pozicionin e punë, subjekti i vlerësimit ka përfituar gradat si me poshtë:

- Me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 482, datë 28.03.2017 ka përfituar Gradën Drejtues i Shërbimit.
- Me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 166, datë 17.06.2022 ka përfituar Gradën Drejtues i Parë i Shërbimit.

5.3 Sipas parashikimeve të ligjit nr. 128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”, punonjësit e AMP-së nuk mbajnë më grada, duke filluar nga muaji Shkurt 2022, pra nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij ligji.

5.4 Në përfundim, në lidhje me ecurinë në karrierë të z. Altin Ramazan Curri, bazuar në deklaratimet e bëra, verifikimet nga dokumentacioni i administruar, trupa e vlerësimit konkludon se:

- ✓ **Funksionet në të cilat është emëruar subjekti dhe gradat e përfituara gjatë karrierës, janë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.**

VI. Pjesëmarrja në konferenca shkencore, workshop-e, seminare, botime brenda dhe jashtë vendit

6.1 Subjekti i vlerësimit, z. Altin Ramazan Curri, për periudhën e përcaktuar në formularin e aftësive profesionale, nuk ka marr pjesë në ndonjë konferencë, workshop, seminar apo botim brenda dhe jashtë vendit.

Në përfundim të hetimit të kryer për vlerësimin e aftësive profesionale;

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi kreu një hetim të thelluar nëpërmjet verifikimit të dosjes personale të subjektit të vlerësimit, verifikimit të nivelit arsimor të subjektit të vlerësimit, vlerësimin e përmbushjes së detyrave funksionale dhe respektimin e rregullave të etikës në ushtrimin e detyrës si punonjës në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, arrin në konkluzionin se, subjekti i vlerësimit Altin Curri:

- ✓ ***Është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;***
- ✓ ***Ka rezultuar i kualifikuar për të ushtruar atë funksion që mban;***
- ✓ ***Ka vlerësime pozitive pune.***

KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të vlerësimit, relacionin e relatores së çështjes, shpjegimet me shkrim të dhëna nga subjekti i vlerësimit gjatë hetimit administrativ, si dhe pasi u njoh me qëndrimin e subjektit të vlerësimit në seancën dëgjimore publike të datës 31.05.2024, ftoi subjektin në seancën e dhënies së vendimit të datës 07.06.2024, arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, z. Altin Ramazan Curri, në përputhje me nenin 60, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- ***Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë;***
- ***Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës;***
- ***Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.***

PËR KËTO ARSYE:

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në bazë të gërmës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar;

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit, z. **Altin Ramazan Curri**, me funksion Drejtor i Drejtorisë së Hetimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.

3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 07.06.2024.

TRUPA E VLERËSIMIT

Erjana PJETRI

Kryesuese

Ersa KARAJ

Relatore

Klevis DHIGOI

Anëtar